

Stavri J. Dajo është doktor i shkencave historike i Universitetit "Aristoteli" të Selanikut, studiues, përkthyes, dhe pedagog i gjuhës shqipe. Ka botuar disa monografi studimore dhe ka shqipëruar me sukses kryeveprën "Jeta e Aleksis Zorba" të Nikos Kazantzakis, e vlerësuar më të drejtë si punë shumë e kujdesshme dhe e zellshme, po edhe për cilësinë e shqipërimit e për pasurinë leksikore të shqipes. Stavri Dajo është tashmë i mirënjohur në përkthimin e veprave letrare nga poetë, prozatorë, shkrimtarë e nobelistë të tjerë grekë dhe qipriotë.

STAVRI DAJO: E ardhmja e përkthimeve dhe krijimi i një diversiteti ndërkulturor është premtuese

Bisedoi Andreas Dushi

SHËNIME MBI LIBRAT

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

ARIAN LEKA: "KONSENSUS DHE POLEMIKË PËR EMRAT DHE MITET E LETËRSISË SHQIPTARE"

Nga Evalda Paci (fq. 5)

Irakli Koçollari, Alipashaida, Onufri

"ALIPASHAIDA", MONUMENT KULTUROR PËR BOTËN SHQIPTARE

Nga Bashkim Kuçuku (fq. 9)

POEZIA E ZEF PLLUMIT

Nga Ndue Ukaj (fq. 10)

"Dialog" me romanin "Kënga e zogut të
parajsës" të I. Haxhillarit

ARIE PËR TRE

Nga Dhimitër Pojanaku (fq. 4)

"GULAGU" I DAVID KEITH E MALCOLM MACDOWELL VS SPAÇIT TË MUNGUAR NË MEMORIEN SHQIPTARE

Nga Faruk Myrtaj (fq. 4)

JORGO PAGINGJI, KY DISHEPULL I URTË I FJALËS SË PRARUAR

Nga Ilir Çumani (fq. 8)



GABRIELA MUJAJ ËSHTË MARTIN CAMAJ ME FUSTAN

Nga Visar Zhiti

Duket që Gabriela ka si ikonë poetin Martin Camaj, e ka nga anët e gjuhës së saj, teksa të dy në kohë të ndryshme kanë zbritur nga malet dhe mallet në metropolet gjermanike, aq sa më pëlqen të them diçka që njihet si thënie, por për herë të parë i drejtohet asaj: Gabriela Mujaj është Martin Camaj me fustan.

(fq. 16)

SHËNIME PËR "KUR SUNDUESIT GRINDEN"

Shtypi kinez për nominimin e Kadaresë për çmimin "The Booker International"

Përktheu Iljaz Spahiu (fq. 19)

Shënime rreth librit "Doke dhe tradita- një histori e
shkurtër e gjakmarrjes ndër Kanunet Shqiptare" të
Dr. Gelanda Shkurtajt

PËRTEJ KEQNJOHJES E KEQKUPTIMIT TË KANUNIT

Nga Frano Kulli (fq. 12)

SI YVES KLEIN NDRYSHOI GJUHËN E ARTIT

By Joe Townend (fq. 23)



BIBLIOTEKË

Odise Kote (fq. 13)

Zogjtë kagaro mbi oqean

Ervin Nezha (fq. 15)

Të vdekurit jetojnë në pasqyrë

Viktor Gjokolaj (fq. 14)

Kristalet e thyera

Ylli Pango (fq. 19)

Kafe "Adulter"

Marita van der Vyver (fq. 21)

Ende gjallë

Përktheu nga origjinali: Sidita Hoxhiq- Dano

Deborah Levy (fq. 22)

Argjend

Përktheu nga origjinali: Aristidh Shqevi

Bllaga Dimitrova (fq. 22)

Mësim nga historia

Përktheu nga origjinali: Agim Vinca

Arben Meksi (fq. 18)

Karikatura e të shtunës

Kur kujtoj artistin fierak Fuat Boçi

Nga Arben Velo (fq. 7)

Daniele Mencarelli-t "Gjithçka kërkon shpëtim" - Toena
NJË "UDHËTIM" NË ERRËSIRËN
E MENDJES NJERËZORE

Nga Edona Marku Huqi (fq. 20)

A. D. Pak ditë më parë, është botuar dhe promovuar *Proza tregimtare greke: botim antologjik dhe bibliografik*, një libër voluminoz ku përfshihen mbi shtatëdhjetë tregimtarë grekë. Antologjitë janë shpeshherë zanafilla debatesh e diskutimesh, kryesisht të nxitura nga metodologjia e përzgjedhjes së autorëve pjesë e saj. Prandaj, më së pari dua t'ju pyes lidhur me këtë proces, nga ideja fillestare për një antologji të tillë, te përzgjedhja e autorëve, përkthimi, redaktimi, botimi e në fund, promovimi. Praktikisht, i gjithë shtegtimi i librit...

S.D. Në krye, dua t'ju falënderoj për hapësirën publike që më jepni kaq bujarisht për të komunikuar me lexuesin.

Antologjia e pranishme e prozës tregimtare bashkëkohore greke është botimi më i plotë deri më sot në shqip i këtij lloji; përmbledh krijimtari të shkrimtarëve grekë të përkthyer në fill të kohërave, botuar në libra me karakter përmbledhës ose në periodikun e kohës, që nga themelimi i shtetit shqiptar e deri në ditët tona si dhe ripërkthime tregimesh të botuara më parë, ose përkthime tregimesh të reja, të pabotuara ndonjëherë.

Hartimi i këtij botimi antologjik zë fill në fund të viteve '80 kur, si bibliograf i ri i sapoemëruar në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë (BKSH), kisha qasje në shtypin shqiptar të paraluftës d.m.th., në shtypin "e ndaluar", në një botë që më tundonte dhe më bënte të ndihesha pak më i lirë, teksa për pjesën tjetër të lexuesit kjo botë ishte herezi dhe ngjallte terror psikologjik. Maksim Gjinaj, bibliograf i vjetër dhe i mirënjohur, më nxiti të shikoja dhe artikujt për Greqinë dhe, në këtë suazë, edhe përkthimet e letërsisë së saj në faqet e periodikut. Dhe unë nisa të regjistroj, krahas punës së përditshme, të dhënat e shtypit (të gazetave dhe revistave) që përbëjnë bazën bibliografike të përmbledhjes. I jam mirënjohës.

Vëllimi i pranishëm përmbledh 78 autorë dhe 92 tregime. Marrin pjesë 38 përkthyes: dy prej të cilëve me inicialet të pidentifikuar, një pseudonim gjithashtu i pidentifikuar dhe 6 anonimë; 34 janë përkthime tregimesh të reja që botohen për herë të parë dhe 27 janë ribotuar të rivështuara: 20 tregime janë vjelë nga botime të ndryshme antologjike ose jo, dhe 40 nga periodiku përgjatë kohërave që nga viti 1923 deri në ditët tona; 16 nga shtypi i paraluftës dhe 24 nga periodiku i pasluftës, kryesisht nga revista *Nëntori* dhe gazeta *Drita*, organe të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë (1945-1991).

Në përmbledhje janë evidentuar 388 zëra bibliografikë që lidhen vetëm me autorët ose përthyesit që janë përmbledhur në vëllim, ndërsa evokohen më shumë se 250 përkthyes (listë joshteruese) të letërsisë greke (prozë dhe poezi) nga gjuha amë ose nga gjuhë të dyta.

Për hartimin e antologjisë janë kontrolluar 122 tituj periodikë të paraluftës dhe 38 të pasluftës, janë konsultuar të gjitha botimet bibliografike të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (1912-2004). Ndihamë e paçmuar në hulumtimin e materialit

STAVRI DAJO:

E ardhmja e përkthimeve dhe krijimi i një diversiteti ndërkulturor është premtuese

Bisedoi Andreas Dushi

qenë botimet bibliografike të BKSH-së dhe libri i Vjollca Hysenbegasit për përkthimin e letërsisë së huaj në botimet shqiptare të pasluftës.

Botimet e kësaj gjedhe, -d.m.th.

botimet antologjike – kanë karakter "lapidar" dhe janë karakteristike e viteve të shkuara dhe sipërmarrje e botuesve skrupulozë dhe tejet të vëmendshëm, pasi dihen vështirësitë shkencore,



teknike, përkthimore etj. Më anë tjetër, target-grupi i lexuesve të këtyre botimeve është etilitar dhe i kufizuar, kësaj nuk pritet ndonjë përfitim tregtar prej tyre. Kurrë nuk mund të jesh absolutisht i sigurt për kriterin e saktë seleksionues (paçka se për hartimin e saj jam konsultuar me dhjetëra botime të tilla në greqisht dhe në gjuhë të tjera, sidomos në frëngjisht), ndaj debatet janë fort të përligjura. Sa i përket nivelit cilësor të shqipërimit shpreh një bindje, shumë afër reales, se me zgjedhjen e përkthimeve më të spikatura përgjatë viteve nga shkrimtarë (Petro Marko, Sterjo Spasse, Dhimitër Falo etj) dhe përkthyes (Enver Fico, Mina Qirici, Alesk Çaçi, Vasil Koçi e deri te më të rinjtë: Romeo Çollaku, Mirela Xheferraj etj.) është arritur një begati e madhe stileshe dhe një nivel cilësor lavdëruar, çka e konfirmon jehona dhe interesimi leximor dhe publicistik që u shpreh me vlerësim për këtë vëllim antologjik.

A. D. Kjo nuk është përvoja juaj e parë në përgatitjen e një antologjie. Aty nga vitet 2000, nëse nuk gaboj, keni botuar Antologjinë e Poezisë Qipriote. Letërsia qipriote, ndryshe prej asaj greke, nuk duket sikur zë një hapësirë domethënëse në letërsinë evropiane, apo e kam gabim? Është kjo antologji një sprovë për të vërtetuar të kundërtën e kësaj përshtypjeje të përgjithshme? Dhe në vijim, atëherë kur u botua, si u prit nga lexuesi shqiptar, duke mbajtur përherë parasysh se më parë, letërsia e Qipros ishte thujse krejt e papranishme?

S.D. Konstatimi juaj është i saktë. Kam qenë përgatitës (por edhe pjesërisht përkthyes) i një *Antologjie të poezisë qipriote* (Tiranë: Albin, 2000) dhe pak më vonë i *Antologjisë së prozës së shkurtër qipriote* (Tiranë: Albin, 2003) vëllime që janë përgatitur në bashkëpunim me universitetin e Qipros dhe universitetin Aristotel të Selanikut. Por letërsia qipriote – pjesë e letërsisë mbarëgreke dhe e vlerave të saj shpirtërore – nuk ka qenë e panjohur. Në Shqipëri është botuar një vëllim poetik i poetit qipriot Theodosios Pieridis, *Simfonia qipriote: pjesë nga poema dhe vjersha të tjera* (Tiranë: Shtëpia Botuese Naim Frashëri, 1981), ndërsa emra shkrimtarësh qipriotë ndeshen në botime prestigjioze në Paris, Londër dhe Nju Jork. Antologjia



e pranishme nuk është dëshmi për të vërtetuar të kundërtën. Letërsia greke dhe ajo qipriote kanë një amë: letërsinë dhe gjuhën e lashtë greke. P.sh. shkrimtari Nikos Nikolaidis (1884-1956) lindi në Qipro, por jetoi në Kajro dhe përmbledhet në të gjitha botimet antologjike të prozës së shkurtër greke dhe qipriote (është përfshirë dhe në botimet e mia respektive antologjike).

Shtoj këtu se jam redaktor dhe i një botimi antologjik në gjuhën greke – dhe pjesërisht përkthyes i tij– (Selanik: Literatus, 2022) i *Prozës tregimtare të Ballkanit* ku përshihen 68 shkrimtarë të njohur nga 12 vende (tashmë) të gadishullit, me 70 tregime, ndërsa marrin pjesë 34 përkthyes të njohur grekë. Në këtë vëllim, ku dalin në pah disa vlera estetike bashkëgadishullore, janë përfshirë dhe 15 shkrimtarë shqiptarë nga i gjithë areali shqipfolës i Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut) dhe dy shkrimtarë me origjinë shqiptare, por që kanë jetuar e krijuar në vende të tjera të Ballkanit, në gjuhën e vendit pritës. Vëllimi është pritur me ngrohtësi dhe, si nënshënim, studiohet si lëndë didaktike në disa katedra të gjuhëve ballkanike në universitetet greke.

A. D. Sipas jush, cila është mënyra më e mirë për ta bërë të njohur letërsinë e një vendi: Përkthimi dhe botimi i një antologjie apo përkthimi dhe botimi i shkrimtarit a shkrimtarëve më të njohur të atij vendi?

S.D. Mënyra më e mirë për të njohur vlerat ideo-estetike të letërsisë së një vendi të huaj është përkthimi i saj cilësor, dhe në Shqipëri kemi një traditë të vyer në fushë të përkthimit (më i saktë do të ishte termi “shqipërim” kur flitet për përkthim të letërsisë artistike) dhe kriteri i rreptë seleksionues i shkrimtarëve, vlerësuar nga kritika dhe opinioni i lexuesve. Përkthyesit shqiptarë kanë krijuar një shkollë të konsoliduar përkthimi letrar; nuk do të ishte guxim i tepruar po të thosha se Dhimitër Pasko, Sotir Caci, Vedat Kokona, Misto Treska, Robert Shvarc, Aurel Plasari, Mira Meksi e më të rinj Elda Gjana e shumë të tjerë kanë kontribuar po aq (në mos më shumë) në pasurimin e fondit të leksikut të shqipes, sikundërse Ismail Kadere, Dritëro Agolli, Jakov Xoxa, Ali Abdihojha, Shefqet Musaraj, etj. Këta përkthyes kanë qenë dhe mbeten kultivues begatorë të shqipes dhe meritojnë vëmendje të posaçme nga gjuhëtarët. Botimet antologjike dhe botimet e shkrimtarëve të veçantë janë gjedhe të ndryshme botimi, të dyja të domosdoshme.

A. D. Para disa vitesh, një bisede të botuar po në “ExLibris” me një kolegun tim nga Kosova, i zgjodhëm si titull “Kultura është ura e cila lidh, atë çka politika kërkon të ndajë”. Mendoni se kjo fjali vlen edhe në kontekstin e situatës mes Shqipërisë dhe Greqisë? Kontribuon Antologjia, po edhe libra të tjerë të ardhur si nga greqishtja në shqip, ashtu dhe nga shqipja në greqisht, për ta përmirësuar situatën jashtëletrare të raporteve mes dy vendeve?

S.D. Pajtohem tërësisht me kolegun tuaj kosovar. Në arealin



mbarëgadishullor –mbushur me shamatarë, grindaveçë e sherrxhinj, kinse bartës idesh origjinale e radikale, me gjykime të anshme dhe trajtime keqprirëse, predikues shterpë të arketipit të tyre kombëtar dhe cilësues të të tjerëve si kopjacë të pasurisë shpirtërore të të tjerëve (nyjtuar shpesh me stil agresiv e me ide të përçudnuara), letërsia është ajo fushë e ndërëgjegjes shoqërore e infektuar më pak nga pasionet nacionaliste, shoviniste, irredentiste dhe raciste. Ajo, historikisht, ka predikuar më shumë dashuri dhe më pak urrejtje. Atje ku politika dhe diplomacia zihen ngërç dhe nuk kanë zgjidhje, shkrimtarët e letërsisë gjejnë gjithmonë një kumt tolerance dhe mirëkuptimi. Po ju sjell dy raste nga dy vendet tona: Në vitet '30 lëvizja mbarëballkanike për kualifikimin e shkrimtarit grek Kostis Palamas për të fituar çmimin Nobel, nxiti Palamas-in e Shqipërisë, Gjergj Fishtën të niset nga Shkodra dhe të mbërrijë enkas në Athinë në mbështetje të kandidaturës greke. Respektivisht, në vitin 1980 kur në Shqipëri nuk guxonte kush të ngrinte zërin për kandidaturën e Ismail Kadaresë për këtë çmim, një shkrimtar i mirënjohur grek, Kristoforos Milionis, iu drejtua solemnisht dhe me guxim intelektual autoriteteve evropiane dhe argumentoi që Ismail Kadare nuk është më inferior se Ivo Andriç-i dhe se shkrimtari shqiptar e meriton plotësisht çmimin Nobel. Gjej rastin të lëvdoj kolanën e veprës së tij botuar nga Onufri, përkujdesur në mënyrë të veçantë.

Përkthimi i letërsisë së këtyre shkrimtarëve është një mjet për të sjellë popujt më afër.

A. D. Përgjatë viteve, diskutimi publik është pasuruar shpeshherë me mendimin tuaj në fusha nga më të ndryshmet, prej atyre letrareve e gjuhësore, tek ato sociale apo politike. Gjatë periudhës së artë të gazetave, kur dilnin dhjetëra të tilla në ditë, emri juaj shfaqej herë pas here. Fakti që në

Kosovë nuk botohet asnjë gazetë dhe në Shqipëri, numri i tyre është reduktuar ndjeshëm dhe gjithë përmabjtja e dikurshme e gazetave kufizohet dhe mbyllet në profile rrjetesh sociale, mendoni se ndikon në varfërimin e seriozitetit të mendimeve, opinionëve apo diskutimeve?

S.D. Ky konstatim vlen jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjitha vendet kudo në botë. Mjetet e rrjetëzimit social dhe gjithfarë platformash të çdo lloji kanë shpallur “demokracinë e tribunës”, duke krijuar “gazetarinë popullore” ose thënë ndryshe “vulg-gazetarinë”. Paralelisht është krijuar “vulg-gjuhësia”, “vulg-historia” (dhe në këtë lëmë të dijes debati është fort i acaruar dhe shpesh armiqësor ndaj kolegëve). Dhe kjo –në respekt të analogjive– nuk është, detyrimisht, e keqe. Çdokush duhet të ketë zë publik, të drejtën për të thënë solemnisht fjalën dhe bindjet e veta. Por, si pasojë e këtij vërshimi të pakontrolluar, të papërmbytur dhe shpesh agresiv, janë mbyllur shumë mjete të informacionit masiv (media). Por, sipas gjasave, gazetaria tradicionale (respektivisht, dhe shkenca e historisë, e gjuhësisë, etj.) do të bashkëjetojë me këto forma të shprehuri; ky është një realitet i pakthyeshëm tashmë dhe një evoluim i paprapësueshëm. Në shumë vende, në kryeherë, u tha se shkenca e mirëfilltë dhe gazetaria profesionale duhet të injorojë “specialistët diletantë” të facebook-ut, por me kalimin e kohës u pa se kjo ishte e pamundur. Pala tjetër krijonte “shkollën” e vet, duke sajuar mite të reja, të cilat duheshin shpërbërë si të pavërteta ose të pabazuara shkencërisht se fitonin audiencë, (“audiencën e turmës”) që nuk kishte dijen e duhur të konfirmonte vërtetësinë e informacionit të servitur. Pas kësaj u joshën dhe shumë gazeta, duke përshkallëzuar rrezikshëm publicistikën e verdhë dhe populizmin. Gazetaria e ka më të vështirë, ngase çdokush me një telefon celular që di shkrim e këndim mund të hiqet si

gazetar, paçka se nuk njeh shkencën dhe teknikën e profesionit dhe nuk respekton kodin e tij moral. Por unë jam i bindur, se mjetet e informacionit me integritet profesional, sikundërse gazeta juaj, dhe bartësit e informacionit real (dhe jo e fake-news-ve) do të mbijetojnë, dhe lexuesi që rreket të mësojë të vërtetën do të grumbullohet rreth shtypit të përditshëm dhe periodik serioz dhe jo sensacional që del e ikën si flaka e kashës.

Këto ditë një gazetar i *Financial Times-it*, Tony Barber, mbështetës fanatik i shtypit të printuar, u shpreh tejet pesimist për të ardhmen e tij dhe theksoi se në një horizont afatgjatë, media e printuar do të tkurret vazhdimisht ndërsa do të fitojë terren media elektronike. Por kjo është një bindje e shprehur në panik. Kështu u tha dhe për librin elektronik (ebook) para shumë vjetësh, por këtu e disa dhjetëvjeçarë ai nuk tejkalon 5% të tregut, madje është në tërheqje.

A. D. Në rekordet bibliografike të Bibliotekës Kombëtare, shoh se emri juaj, para viteve '90, del si redaktor në shtëpinë botuese “Naim Frashëri”. Si e kujtoni atë periudhë? Cila ishte fryma e përgjithshme, qasjet e redaksisë ndaj veprave, natyra e punës...? Praktikisht, a ndiheshit mirë me punën dhe me ambientin ku punonit?

S.D. Jam emëruar në shtëpinë botuese “Naim Frashëri” (ent që botonte vetëm letërsi artistike, në kundërvënje me shtëpinë botuese “8 Nëntori” që botonte literaturë politiko-shkencore) në shtator të vitit 1982 (deri më 1989), sapo kisha mbaruar studimet për gjuhë-letërsi shqipe në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, ku pata fatin të mësoj nga emra të nderuar të gjuhësisë shqiptare, të tillë si Shaban Demiraj, Mahir Domi, Rami Memushaj, Ethem Likaj, Thoma Rrushu e më së pari nga Eqrem Çabej që ishte ndarë nga jeta në vitin 1980, dhe u bashkova në redaksinë e poezisë, të dramës dhe kritikës letrare –në vëmendjen time ishte dhe një seksion i gjuhës greke për botime letrare të shkrimtarëve të minoritetit etnik grek– redaksia më delikate për shkak të natyrës së letërsisë që botonte. Ndihehin ende vibracionet e plenumit të katërt famëkeq, disa vjet më parë ishte “zbuluar” atje një “grup armiqësor” dhe ishin dënuar redaktorë të zotë për agjitacion dhe propagandë me vite të rënda burgimi. Administrata e institucionit na tërhoqte përditë vëmendjen që të mprenim “vigjilencën ideologjike”. Për këtë, më vonë, institucioni –si të gjitha institucionet e agjitacionit dhe të propagandës – u thirr, dhe jo pa të drejtë, dhe “institucion i policisë ideologjike”. Nga librat e redaksisë ku isha emëruar, pak kohë më parë (viti 1979), ishte “hedhur në karton” vëllimi poetik *Zgimi i thellësive* i poetit tim të dashur Xhevahir Spahiu, akuzuar për ekuivokë ndaj Enver Hoxhës dhe redaktori i tij, i ndieri Perikli Jorgoni, rrinte si në gjemba në pritje të dënimit (për shkak të uljes së ndjenjës së “vigjilencës ideologjike”). Në redaksi qarkullonte fjala e Dhimitër Fullanit (një redaktor i vjetër dhe emblemantik) se të gjithë ishim viktima

potenciale të mërisë së shefave noproanë të Komitetit Qendror dhe jetonim në një “zonë të minuar”. Po kështu, redaksia e tregimit dhe e novelës, drejtuar nga Sami Çabej, për shkak të qëndrimit të butë dhe jokritik ndaj një dorëshkrimi të Ismail Kadaresë, u gjend në objektivat e drejtuesve të lartë. Sundonte, si kudo, një regjim terrori psikologjik dhe shantazhi të pashpallur. Kështu që ngazëllimi fillestar u shua dhe u shndërrua në frikë; punonim në një mjedis skepticizmi dhe heshtjeje në atë “zonë të minuar”.

Si i ri, mua m'u besuan kryesisht vëllimet poetike të talenteve të reja atëherë: Ilirian Zhupa, Besnik Mustafaj, Mimoza Ahmeti etj. me të cilët pata një bashkëpunim pjellor dhe konstruktiv. Ata u afirmuan shumë shpejt, dhe me të drejtë, falë talentit të tyre. Përndryshe, për shkak të njohjes së gjuhëve të huaja, më lidhte puna dhe me redaksinë e botimit të letërsisë së huaj që e drejtonte Donika Omari. Ky komunikim ishte për mua një shkollë e madhe dhe përvojë e paçmuar; bashkekzistenca me emra të tillë si Petro Zheji (kur përkthente tregimet hershme të Gorkit kishte mësuar përmendesh eposin e kreshnikëve se, thoshte, ishte i vetmi leksik që i përshtatej natyrës dhe stilit të veprës), Bujar Doko (i dënuar në vitet e para të pasçlirimit si “armik i popullit” që punonte i tërëvetmuar), Klio Evangjeli, Afrim Koçi, Shpëtim Çuçka, Piro Misha, por edhe Brikena Çabej, e cila mbulonte letërsinë e huaj për fëmijë, më pasuroi dijen dhe urtësinë e profesionit. Këta punëtorë të palodhur të gjuhës kishin vetëm një laps dhe një gomë (dhe shumë pak fjalorë ose bazë të dhënash), por i dhanë letërsisë vepra madhore nga fondi i letërsisë botërore me një shqipe të pasur dhe tejet të

kultivuar. Ndiej nderim të veçantë për ta.

A.D. Thuhet rëndom për përkthyesit, ndonjëherë edhe në mënyrë abuzive, se janë ambasadorët më të mirë të një vendi. Ky përshkrim, juve ju rri më së miri pasi jeni folës dhe përkthyes i të dyja gjuhëve, nga shqipja në greqisht dhe anasjelltas. Kështu, s'e shmang dot pyetjen, a ju duket e mirëpërfaqësuar letërsia shqipe në Greqi e po ashtu, ajo greke në Shqipëri?

S.D. Përkthyesit që në kohë të *Gilgameshit* (në s'gabohem monumenti i parë i letërsisë së përkthyer botërisht) kanë qenë heronj anonimë, krijues të një letërsie paralele me origjinalin. Ndiheja e tyre në fushë të letrave asnjëherë nuk u vlerësua aq sa duhet. Në historinë e përkthimit të botërore p.sh., përkthimet e August Wilhelm Schlegel evidentohen si të barabarta me ato të Shekspirit për nga kënaqësia estetike që i japin lexuesit, por në Gjermani, në fakultetet e filologjisë, pak e ruajnë në kujtesë emrin e tij. Dhimitër Falo (vlarë barbarisht nga komunistët në vitin 1944) ka përkthyer 20 libra artistikë nga shumë gjuhë të botës me një cilësi të lartë gjuhësore dhe mjeteshtilistike, –guxoj të them shumë më të lartë se përkthimet shpesh të pakujdesshme të Fan Nolit– dhe me një begati njësisht frazeologjike dhe sinonimike lavdëruese, por pak e njohin atë. Historiografia shqiptare dhe vëmendja akademike është deficitare ndaj këtij personaliteti fisnik të letrave shqipe. E pra, këtë rol në komunikimin ndërkulturor mes popujve nuk kanë mundur ende ta luajnë teknokratët e diplomacisë apo burokratët e politikës.

Që prej vjetit 1998 bashkë me ish-ministren e Kulturës së Greqisë, Mirsini

Zorba (qoftë i lehtë dheu që e mbulon) e deri para pak kohe kemi skeduar dhe katalogizuar rregullisht përkthimet nga letërsitë e ndërsjella dhe tash ekziston një rezervuar i përplotë informacioni bibliografik për studiuesit dhe përkthyesit e ardhshëm. Sipas kësaj pasqyre (jo absolutisht të saktë dhe të plotë) në Greqi janë botuar rreth 110 autorë shqiptarë (jo përherë zgjedhur me kritere të mirëfillta estetike, por dhe me qoka, për fat të keq), të botuar nga 86 shtëpi botuese. Ndër më kryesoret: Eikostos protos: 21vepra, (kryesisht të Ismail Kadaresë), Roes 5 vepra, Kastanjotis 5, Plithora 5, 24 grammata 4, Metaihmio 4, etj. Ndër autorët, kryet e vendit e zë Ismail Kadare, me 28 vepra (dhe shumë më tepër botime), Besnik Mustafaj 4, Fatos Kongoli 3, Dritëro Agolli 2, Ben Blushi 1, Elena Kadare 1, Virion Graci 1, Nasho Jorgaqi 1, Neshat Tozaj 1 etj. Mund të ketë dhe përkthime të tjera të cilat nuk janë regjistruar në bazën e të dhënave p.sh.: të tillë si Daut Gumeni me 3 vepra etj. Për letërsinë greke në shqip ka të dhëna të plota bibliografike në botimin tim antologjik sipas botimeve të katalogëve të BKS-së dhe sektorit të bibliografisë, i cili ka bërë një punë madhore përgjatë viteve me botime, saktësi dhe profesionalizëm që nuk e gjen në asnjë vend tjetër të Ballkanit. Për këtë meriton të lëvdohet ish-shefi i këtij sektori Maksim Gjinaj. Ky përfaqësim i letërsisë shqipe në Greqi nuk ka të krahasuar në statistikat numerike me përkthimet në letërsitë e vendeve të tjera të Ballkanit dhe kjo falë, më së pari, sinkretizmit shpirtëror të dy popujve, por dhe të rezervuarit të ri të përkthyesve të rinj të krijuar nga emigrantë shqiptarë të brezit të dytë, diplomuar në institucione të larta universitare greke, të cilët kanë për detyrë të rrisin nivelin e tyre profesional dhe disiplinor.

A.D. Dhe në mbyllje, diçka lidhur me Departamentin e Gjuhëve të Huaja të Institutit të Studimeve Ballkanologjike ku ju jepni gjuhën shqipe. Si dikush tejet i interesuar për njohjen e gjuhës shqipes qoftë edhe për të siguruar vijimësinë e përkthimeve nga kjo gjuhë, s'rrri dot pa ju pyetur për interesin, jo vetëm te katedra në fjalë por në përgjithësi: Ekziston interesi i studentëve grekë për gjuhën shqipe? Mendoni se e ardhmja do të jetë bujare dhe do të ofrojë përkthyes të rinj, të talentuar nga shqipja në greqisht?

S.D. Instituti i Studimeve Ballkanologjike (IMXA) –i vetmi i këtij lloji në Ballkan, me një bazë të pasur bibliotekare dhe arkivore, feston sivejt 60-vjetorin e themelimit. Po kaq vjet ka edhe shqipja e cila mësohet vijueshmërisht nga studentë, nxënës e civilë grekë. Unë jap mësim që në vitin 1997. Janë disa kategori studentësh të interesuar për të mësuar shqipen: kategoria e parë: për nevoja shkencore (studentë pasuniversitarë ose për temë doktorature); kategoria e dytë: për nevoja utilitare (biznesi), kategoria e tretë: sepse shqipja është gjuha e dytë e folur në Greqi pas greqishtes (komuniteti i emigrantëve i cili i kalon 500.000), kategoria e katërt: bashkëshortë ose bashkëshorte të martesave mikse, kategoria e pestë: për nevoja certifikimi sikundërse dhe gjuhë të tjera (anglisht, frëngjisht, gjermanisht etj.), kategoria e gjashtë: punonjës të administratës publike për transferime ose emërimë në vende pune ku lypset njohja e shqipes, kategoria e shtatë: brezi i dytë i emigrantëve shqiptarë në Greqi që e mësojnë shqipen si gjuhë të huaj etj. Nga viti 2019 Greqia është i vetmi vend i BE-së që e certifikon shqipen në IMXA për të gjitha nivelet e referencës (A1-C2), pas provimeve me gojë dhe me shkrim dhe kreditohet me po atë shkallë vlerësimi si dhe gjuhë tjetra të BE-së. Lënda ekzaminuese hartohet dhe organizohet sipas standardeve të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave (CEFR) dhe parashikimeve ligjore të BE-së. Për këtë kemi hartuar së bashku me kolegen time dhe pedagogen e përkushtuar të shqipes Xhensila Kodra dhe një tekst mësimdhënies *Shqipja për greqishtfolësit* (në tre vëllime: i 1-rë A1-A2, i 2-të B1-B2, i 3-të C1-C2, Selanik: Literatus, 2022-2024). Si bazë shkencore dhe bibliografike e tekstit janë shfrytëzuar arritjet më të fundit të shkencës gjuhësore shqiptare, botimet e Universitetit të Tiranës dhe të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për studimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe me ndryshimet që i dikton koha, veçanërisht sa i përket njësisve të reja të leksikut dhe huazimeve, ndërsa për dukuri dhe kategori gramatikore për të cilat nuk ka ende njësi mendimi, kemi mbrojtur bindjet tona shkencore. Natyrisht ky tekst, vatërzon më shumë në veçanësitë që paraqesin greqishtfolësit në të nxënë të shqipes, në prodhimin e gjuhës së folur dhe të shkruar. Si evidencë statistikore, nga viti 2021 deri më sot kanë certifikuar shqipen 234 studentë grekë dhe shqiptarë të brezit të dytë të emigrantëve (shumica e tyre me dyshtetësi) për të gjitha nivelet e referencës (A1-A2).

Optimistë prej natyre, unë besoj se e ardhmja e përkthimeve dhe krijimi i një diversiteti ndërkulturor është premtuese.



Studiuesi Arian Leka përmbylli para dy vitesh një libër të plotë studimor e që paraqitet para nesh në një dimension kompleks, nëse kemi parasysh qasjet e karakterit diakronik, të diktuar nga punimet më të fundit të tij, ashtu dhe nga vetë projekti i tij për të bërë bashkë një sërë reflektimesh të iniciuara në periudha të caktuara të kërkimeve të tij në fushë të studimeve letrare. I prirur të ruajë një ekuilibër mes vështrimeve diakronike në çështje të interesave të tij studimore, por dhe me kujdesin që po në pikëpamje të një rendi të arsyetuar të reflektohen dhe kontributet më të fundit të tij në lidhje me autorë të bashkëkohësive sonë, autori ka gjetur një medium për të përkthyer në krerë e kapituj të mëdhenj qasjet më të rëndësishme në kërkimet e tij të dekadave të fundit. Do pasqyrohet një gjë e tillë në një ndarje të shënuar me emërtime kyçe që orienton më së pari në leximin e pjesëve që e ndërtojnë veprën (mitologji; klasikë; realizëm socialist; bashkëkohësi), por dhe që faktin prerje të dallueshme në vështrimin e sociologut të letërsisë, historianit të letërsisë, analistit të fakteve që kanë të bëjnë me rryma e dukuri letrare në areale të tjera që kanë qenë vatër e lindjes dhe e konsolidimit të disa prej tyre. Një domethënie të mirëfilltë i jep inicimit të kësaj pune vërtet të bukur, por dhe komplekse vetë parathënia e thukët nga autori, i cili shpjegon dhe orienton në të njëjtën kohë mbi përzgjedhjet e mundshme të lexuesit, i cili falë kësaj strukture të arsyetuar mund të orientohet ndaj krerëve që ofrohen për lexim e reflektim.

Në një vështrim të përgjithshëm do të cekim disa nga qasjet autoriale që gjinden të reflektuara bindshëm në vëllimin me titull “Konsensus e polemikë për emrat dhe mitet e letërsisë shqiptare”, duke vënë theksin dhe në portretizimin e personaliteteve të letrave shqipe që kanë qenë reflektues prirjesh të veçanta të shpjegueshme me formimin e marrë në kontekste tipike të kulturës evropiane (rasti i E.Haxhiademit), por dhe me bindjet për ndikimin e frymës filozofike në krijimtari (rasti i H.Gjylbegajt).

Mitologjia dhe mitet ndërkohë rivijnë në një sprovë hyrëse që bën të mundur të rikalojmë në kujtesë dhe reflektime një sërë autorësh që zbërthen elemente të rrëfenjave më në zë të një tërësie konceptesh me të cilat mund të rindërtohet sot e kësaj dite një filozofi e botës mitologjike, e konkretizuar në trashëgiminë e çmuar të botës antike greke.¹

Duke dashur të kontekstualizojë vështrimet mbi mitin, mitet dhe toposet në tradita letrare studimore (është fjala për “Figura të mitologjisë në epikën shqiptare-propozim për një rrugë alternative të mbërritjes së tyre në Epos”), autori ka vënë në fokus si sprovat e natyrës teorike që i kanë shërbyer për t’u introduktuar në të tjera punime tematike me shtysë dhe nga antikiteti grek, ashtu dhe qukrime konkrete në gjurmime të fushës së antropologjisë kulturore (Çabej, Gurashi, Palaj, Ashta) e të vetë qëmtimeve që reflektohen në autorë të dekadave të para të shekullit të kaluar.² Një pyetje

¹ Shih në veçanti *Hyrje (f.11-15)*, në *Figura të mitologjisë në epikën shqiptare dhe propozim për një rrugë alternative të mbërritjes së tyre në Epos*, në A.Leka, *Konsensus dhe polemikë për emrat dhe mitet e letërsisë shqiptare*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2022, f.11-41, botuar më parë në revistën *Antropologji (ASA, IAKSA)*, V.2 Nr. 1, 2019, f. 119-148.

² Pikërisht vështrimi diakronik që merr në konsideratë observimet e Hahn-it, Nopça-s mbi figura të veçanta në botën e mitologjisë, por dhe vjeljet e Eqrem Çabejt, apo më vonë të Bernardin Palajt O.F.M. e Rrok Gurashit O.F.M. përbën një medium të rëndësishëm në orientimin e autorit për të specifikuar sa të

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2022

Arian Leka: “Konsensus dhe polemikë për emrat dhe mitet e letërsisë shqiptare”

Nga Evalda Paci

me vend që shtrohet mbi konceptin e mitologjisë në studime të orientuara në lamije të antropologjisë kulturore e që ka gjetur reflektim në rapsodë shëtitës, por dhe në autorë që kultivojnë letërsi, shtrohet me të drejtë në një prej krerëve hyrës të vëllimit, duke hapur rrugë dhe për të tjera reflektime, përfshirë letërsinë popullore dhe forma të tjera shkrimore e letrare. Gjithashtu, edhe *Mitologji e krishterë në krijimtarinë e Gjergj Fishtës* paraqitet si një sprovë e përpunuar në hollësi e nënçështje, në të cilat kënaqshëm do të mund të shtjellohet një parahistori e konsiderimit të miteve dhe e reflektimit të tyre në religjionet, për më tepër dhe një parathënie mbi botimin e krijimeve që më tej do të bëjnë të mundur të lidhet drejtpërdrejt emri i Atë Gjergj Fishtës O.F.M. me krijimtarinë lirike.³

Njohja e imët e letërsisë së viteve '30, e materializuar dhe në vëllime antologjike e në periodikë kulturore e

pranishme ishin elemente analogjike të konkretizuara në personazhe mitike, me gjasë të afërta me ato të bëra pjesë prej kohësh në letërsinë antike botërore.

³ A.Leka, *Mitologji e krishterë në krijimtarinë e Gjergj Fishtës*, në *Konsensus dhe polemikë për emrat dhe mitet e letërsisë shqiptare*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2022, f.43-56.

letrarë të së njëjtës periudhë, i ka dhënë dorë kolegut Arian Leka që të dallojë në prirje e shkrimtari, por dhe në qasje ndaj gjinijsh të veçanta më tepër se një autor të kësaj periudhe, ndërkohë që dëmtimi i kujtesës (e quajtura *damnatio memoriae*) mbi veprat e tyre është një tjetër preokupim që ai e ka vënë në dukje dhe njëkohësisht e ka kthyer në vendin e merituar në një prej krerëve të kësaj veprë. Trajtimi i parathënieve e i parateksteve si medium propedeutik në qasje ndaj vetë vepërave apo shqipërimeve të Etëhem Haxhiademit përbën një prej kapitujve më të kujdesuar prej Arian Lekës, fakt që përforcohet dhe nga referimet në vijimësi ndaj ribotimeve më të fundit në format anastatik të tragjeditive e të krijimeve të tjera në vargje në bashkëpunim me pasardhësit e këtij autori.

Analizimi i teksteve të Hamit Gjylbegajt, një prej autorëve të trajtuar më gjerësisht, por dhe përfshirja e modelit të polemikës së kohës mes intelektualëve që përfaqësojnë shkolla, bindje dhe orientime jo të njëjta, mbetet një linjë e trajtuar në vendin e kohës e duhur nëse bëhet fjalë të konsiderojmë shkallën e




përafritit të vetë studiuesit me këtë autor, i denjë për t’u përfshirë dhe në historinë e letërsisë së shkruar shqipe, bashkë me specifikimin për përkatësinë në një prozë të natyrës filozofike, me nota mistike në të njëjtën kohë. Personaliteti i Gjylbegajt tërheq vëmendjen në sajë të përveçimeve që rezultojnë në gjuhën e tij shkencore, fakt që dëshmon dhe një tjetër rrethanë mjaft të rëndësishme për studiuesit e kontekstit kulturor të jetës qytetare të kohës: emërtime të përveçme që kanë të bëjnë thellësisht me vetë argumentet komplekse të cilat ka marrë përsipër dhe t’i lëvrojë nga pikëpamjet e tij ndeshen dhe në shtesimet e bashkëkohësve të vet, gjë që na bën të kërkojmë mbi jetëgjatësinë e tyre, mënyrën e ngulitjes në psiken e kulturës së përdorimit, duke qenë se për paracaktimin përkatës flasin vetë tekstet në të cilat këto të fundit kanë gjetur hapësirë shtrirjeje.

Në të vërtetë, në rasë të autorëve që pikërisht në këtë vështrim janë mënjeluar kohe më parë nga manuale e tekste të një formati të paracaktuar institucional për arsye që janë trajtuar dhe në vëllimin studimor mbi autorë e vepra të patrajtuara në letërsinë shqipe (L.Smaqi, E.Paci, A.Leka, T.Plangerica, V.Graci, Tiranë, 2022), të autorëve që dallohen për veçanësi në elemente të krijimtarisë së tyre, më saktë të ndikimeve nga rryma të zhvillimeve letrare në vise të tjera të Evropës, rehabilitimi i kujtesës përkatëse mbetet detyrë e historianit të letërsisë e e studiuesve që përpiqen për të rikthyer në hartën gjegjëse shkrimtarë e kritikë të kësaj letërsie, fakt që provohet dhe më herët në sprovat studimore të kolegut Arian Leka.

Një syth të rëndësishëm të këtij vëllimi studimor do ta përbëjë trajtesa mbi fabulat e Santorit, në të cilën do të spikasë qartë një vëmendje kritike ndaj shkallës së njohjes së shkrimtarisë së këtij autori arbëresh në traditën e studimeve tona letrare, në vështrim konsiderues ndërkohë dhe të ndërmendjes së tij në gjurmimet e K.Kamsit, Z.Kodrës, K.Kodrës, më tej të koleges sonë Merita Sauku-Bruçi, përpiluese dhe përgatitëse serioze e botimeve filologjike e kritike të veprave të tij.⁴ Orientimi i vëmendjes ndaj një modeli gjinor të veçantë siç paraqitet fabula bën të mundur që jo vetëm të kryhen vëzhgime tekstore mbi variantet e Santorit, por dhe të gjurmohen tekste të mëhershme që shpien në mënyrë të pashmangshme si në autorët që tradita botërore i njeht si themelues të vetë zhanrit, ashtu dhe në vështrime kritike mbi çka Santori sjell prej modeleve paraardhëse, duke spikatur dhe vetë për elemente originaliteti.

Vepra me titull “Konsensus e polemikë për emrat dhe mitet e letërsisë shqiptare” u iniciua si e tillë në qershor të vitit 2022,

⁴ Shih gjithashtu A.Leka, *Përrallëzat e Santorit: përkthim, krijimtari, përshtatje -motive dhe burime*, në *Studime filologjike*, n.3-4, 2019, f.47-63.





“Dialog” me romanin “Kënga e zogut të parajsës” të I. Haxhillarit

ARIE PËR TRE

Nga Dhimitër Pojanaku

Si të erdhi ndërmend ky titull?!

Ja, më zbriti nga lart siç të vjen ty prej qielli hyjnishëm poezia.

Nuk është koha për mua tani po më thuaj, të jetë ky zog ajo çafka e bardhë që me këmbkat e brishta zgjon e shtie nga ngasje gurët buzë liqenit apo zogu peh-livan mbi trupin pe të kallamishteve...

Ndoshta...

Ndoshta nuk është përgjigje ndaj po vazhdoj,

E kuptoj që nuk jemi para parajsës në kuptimin e mistikës fetare, pra jo në qiell, por një vend në toke, i bukur, i begatë, vend ku lulëzojnë kopshtet e Versajës, ku lumturia nuk ka haberin nga bien ose nga jetojnë bregat...

E shohin të gjithë atë zog?!

U pendova për këtë pyetje kaq naïve por ish tepër vonë për ta shuar.

Ai mohon. Vetëm të dashuruarit thotë pas çaste meditimesh.

S`mund t`i thojë që e dija se vetë e kërkova.

Ku e ngre folene ky zog? Tek krahërorët e tyre fle e zgjohet dhe kërcen mbi fijet e holla të ndjenjës?

Sa pyetje paske sot!

Bëra sikur nuk dëgjova dhe eca më tej,

E kam dëgjuar këngën e këtij zogu sa here kur dashuria i zbukuron dhe marros ata të dy se ju u jepni ngjyra si pen-det e palloit, ku ohhhhh-et dhe ahhhh-et përkundin shpirtin si koralet nga trazimet e detit...

Por kur njëri nga të dashurit është plagosur diku, kënga e zogut a bëhet trishtuese? Nëse po, çfarë timbri i merr zëri?

Ai më sheh i çuditur.

Po kjo pyetje nga doli?!

Nuk di i thashë, ka kohë që më tndon. Kam pyetur fotografët e discover canal, që jetojnë në botën e zogjve, po ende nuk kam marrë përgjigje. Vetëm dje me shkroi njeri që vëzhgon zogjtë buzë Rinit. Më rrëfente se kurrë nuk kish dëgjuar një këngë vaji nga pothuaj të gjithë llojet e zogjve. Ose, më shkruante, janë tepër të zotë të fshehin pikëllimin nën ca arie të pakrijuara ende nga ne njerëzit...ose nuk e di...

Mjaft heshte duket sikur po dailogoj me veten...

Po e riperserit pyetjen që më rri si ankth: kur dashuria që e lind këtë zog tronditet nga jashtë si nje lule që çel pa erdhur pranvera e dimri xheloz hakërrohet, zogu ku shkon, si rron dhe a mund të rrojë dot pas kësaj pa tingëllimin e

takave të Asaj në bulevard, pas mbarimit të dridhjeve të zemrave në takime si kriveci që cimbis liqenin, pas humbjeve të shpirtave tek njeri tjetri, pas renies nga qielli i shtatë?!

A rron vallë?!

Po e zëmë se ata dy të tutë kuptosën portën e kështjelles, ata e dinë se e kanë vetë në dore fatin e tyre, po me fatin i zogut që ata e kanë mbi pëllëmbët çdo bëhët si do i shkojë filli?

Se ju të tre duhet të më përgjigjeni.

Çdo të thuash me të tre?!

Po a nuk i lindte ti të dashuruarit gjer në dalldi?!

Ata pastaj, nga tharm i dashurisë, a u nuk lindën zogun e parajsës?!

Fundja ata të dy le të bëjnë ç`të duan le të vuajnë bluarjen nga kujtimet po deshën, unë nuk dua që ai zog të mos bjerë nga parajsja, është aq i mitur, i brishtë, do i therin krahët, do i meket zëri, do i shuhet...

...dua të jetojë ky zog më dëgjon?! E dua të gjallë se nuk është prej mishi e kockash por është krijuar nga fluska prej drite, nga regëtimi i damareve kur vërshon gjaku i ekstatës...

Ai nuk ka pendë por krahë pa fund fluturash të ylberta, ka prushërimin e valës mbi valë, dritën e hënës kur është plot pesëmbëdhjetë...

Mos e lër të vdesë atë zog, hyr në zjarin e shuar përcëllo duart mblidh xixat dhe rilinde më dëgjon?!

Në vend të më përgjigjej tha,

Seç kam një trokitje të pazakontë në tëmtha.

Doja t`i thojë se ti që ke miq për kokë ata të dy, zëre se ke kyçet e farmacisë në dorë dhe gjen çdo ilaç por atypëraty, ndërrova mendje. Nganjëherë një shaka që mendon se do sjellë alegri, mbjell mërzi njësoj si humori i hidhur.

Çou i thashë, një shëtitje mbase t`i largon trokitjet...

Unë po rri edhe pak, ti e di, “vetmine kam lluks”.

Vuri në buzë një buzëqeshje të lehtë si të thosh mirëutakofshim dhe iku.

Më dukej sikur hapat e ngadaltë dhe të rëndë ja diktonin mendimet.

Ish një diell prilli përvëlues...mbi tela dy zogj po humbnin mbi krahët e njëri – tjetrit, të bukur jeni u thashë, dashurohuni por unë po kërkoj zogun e parajsës?

Ku mund të jetë tani?!

Ku rron?!

“GULAGU” i David Keith e Malcolm MacDowell vs Spaçit të Munguar në Memorien Shqiptare

Nga Faruk Myrtaj

Një film i ndjekur me vonesë, si prej të shumtëve të shqiptarëve mbase, pas një ftese të Nhapur, publike nga Muçi Xhepa, mësues, ish-diplomat dhe autor me banim në USA. Njohës bio i Lindjes së Kuqe, të Shqipërisë së Mbyllur edhe prej Lindjes, në ekstremin e saj ballkanik, si realitete të vështruara prej qëkuri me syrin e një “perëndimori të lindur” në shije përballë anti-njeriut të imponuar si kulturë jete por edhe në vet letërsinë e ati gjysme-shekulli, Muçi Xhepa, i njëjti person që rekomandonte pak kohë më parë edhe “Kolyma Tales” të Varlam Shalamov, në përkthimin nga rusishtja të John Glad, të “Penguin Books”.

Edhe në të shkruarat, provohet pikerisht kjo shije, kjo njohje dhe qëndrim ndaj vijës që ndan dy botët, të dënuara në bashkëjetesë jo gjithnjë humane.

Fati i Heroit në film është në fund të fundit fati i individit që nuk e lenë të bëj jetën e vet: krejt befas, gjendet i futur në kurthet më të pa-menduara, prej atij vet dhe ndjekësve, shikuesve të vetë:

Thjesht një Firmë, I kërkojnë në të vërtetë. Vetëm kaq! Një firmë që të provosh se meriton të jetosh në Lindje! Hidhe një firmë dhe vazhdo jetën e mëparshme! Individit i Dosjuar është njësia më e përfolur, më e populluara në Lindje.

Tërë pushtetet, mbi dosje firmash ngrihen, me to mbeten në pushtet me to rrëzohen. Individët që e hodhën atë firmë, sado në rrethana në justifikuar në dhembshuri njerëzore, zor se e marrin veten më: të shantazhuar nga pushtetarët e radhës, janë të detyruar të heshtin dhe të shërbejnë edhe kundër dëshirës së vet...

Lindja shkoi edhe më tej: kërkon të marrë firmën edhe të individëve perëndimorë. Dhe, nuk është fjala thjesht si ajo qethja në Rinas që e përmendin deri tani vonë, të vet-rrëfyerit e vonuar, që nuk i provuan vet këto privime...

Naiv për shkak të pastërtisë së vet, “David Keith” në film reziston, e vonon sa mund hedhjen e firmës, që nëpunësit e pa-ndjesi njerëzore ia kërkojnë më nge. Shko e qetësohu e mendoje dhe një herë në qeli. Vijnë e të shfaqet tërë jeta e bërë në atë beton të përmbyllur lagështire e lotësh dhe si mund te mbetesh ai që do të mbetesh përballë këtyre bishave?! Është fjala për film me Gulag Rus, por sovjetikët janë kudo njëlloj, shqiptarët e dinë këtë.


Skenat e përsëritshme për t`ia diktuar marrjen e firmës, me kthime te hera-hershme ne qelinë e hetuesisë, janë ngjethëse. Shqiptaret e të gjithë formacioneve, jo vetëm Vronët e kthyer në Atdheun e çliruar, më në fund edhe ata që edhe vet e kishin ushtruar këtë zeje kriminale artizanale e provojnë në shpinë të tyre, u ndodhi t`i provojnë këto kurthe.

Krime të njëjta mbase por që në rastin shqiptar nuk arrijnë te shfaqen dot as te “Shtëpia me Gjethe”, dhe me asnjë lloj gjetheje nuk mbulohen dot, në versionet e tjera të pluhurosjes së memories.

Në vend te kthehen ne art, ngjarje të tilla, ende mbrohen dhe lëvdohen autorët dhe filmat pa njeri të “Kinostudios Shqipëria Sot”. Është e pa-kollajtë, të jesh I vërtetë dhe I sinqertë, në dëshirë të mirë të mirëkuptohemi, së paku pas kaq dekadash, për atë që ndodhi me Jetët dhe më Filmat për jetët tona reale.

Kujtesa vërtet artistike, e artistëve të përgjegjshëm dhe të vetëdijshëm për misionin e arteve, duhet ta bëjë të vetën Memorien reale Historike. Vetëm kështu, vuajtja dhe privimet, vetëm kështu vitet e mbylljes dhe izolimit, të internimeve, hetuesive dhe burgjeve mund te fillojnë te kthehen në kulture të Njeriut.

Vetëm kur do arrij të mirë-pranohet si realitet artistik, si kulturë, prej të shumtëve prej nesh, vetëm pas kësaj mund të mos përsëritet më.





KUR KUJTOJ ARTISTIN FIERAK FUAT BOÇI.

Nga Arben Velo

Edhe pse ka ikur nga kjo jetë, më duket sikur ende vijon çdo ditë të krijoj humor...me të gjithë. E sidomos me ata që rrijnë, e kalojnë ditët në pritje...duke prodhuar vetëm .. thashetheme..!

Ndërsa rri e vras mendjen se çfarë emri ka kjo erë jugmurlan myzeqar, ajo më godet në brinjë, duke u shkëputur nga brinja ime e lindur një metamorfozë. Nën privilegjin e kësaj metamorfoze përipiqem të gjej pse engjëlli i vdekjes përzgjedh të marrë fizikisht një artist, ndërsa përballë këtij engjëlli qindra personazhe të lindura prej tij nuk i merr kurrë në dorëzim vdekja, por jetojnë dhe nuk pyesin për kosën e saj. Ndryshe nga hadithet profetike ku engjëjt frymëzojnë e besojnë njeriun, në këtë rast ata besojnë e frymëzojnë jetën e personazheve të krijuara nga njeriu. Kështu ka ngjarë edhe me artistin Fuat Boçi. Një artist si Fuat Boçi më ngjan me ujkonjën e lashtë romake. Ai edhe pse ngutet të përballojë gjithë vështirësitë në jetën e tij fizike, të shkurtër sa kjo erë, nuk harron t'iu japë nga shpirti i vet sherbetin e pavdekësisë. Artist si ai kanë vuajtur, janë lodhur, por sërish kanë lindur personazhe nga brinjët e vetëvuajtjes, që duke i çuar për t'iu rritur e burruar te spektatori, iu kanë dhënë lirinë për të jetuar sa të duan. Nuk janë pak, por 600 brinjë të dala dhe shkëputura nga trupi i tij i hajthëm. I shkëputi, i krijoi, i vuri emër dhe dinjitet si personazhe dhe i dërgoi të jetojnë përjetësisht, për të mos u plakur kurrë te spektatori. Përpara se të meket era, nën shtroherë më vjen një truhmë erëdhredhëshash. I keni parë besoj se si rrotullohen erëdhredhëzat nëpër fusha dhe kripore Myzeqeje, mes zhukave, xanave dhe ilqeve, si hinka natyrore të stërmëdha, ku buzët e plasaritura të dherave iu fryjnë duke i drejtuar drejt qiejve, për të trembur e nisur zhegun drejt deteve? Ashtu më duket edhe zëri i personazheve të Fuatit, si erëdhredhëzat të mbështetura në buzët e tij. Ai iu jep forcë dhe frymë, i kthen në kite të grunja zërash e karakteresh, "Oooooeej! Ku jeee o eeej!" Tani si duket po më thërrasin mua këta zëra Fuat. Përpara se t'iu përgjigjem, ore të kam pyetur dikur unë, në një nga bisedat tona gati të më thoje të drejtën ishe më shumë Voshtinas apo fierak? Sepse atë ditë korriku me pak erë, kur ti ike përgjithmonë nga Fieri, (gjithmonë kur uleshim dhe takoheshim thoje se nuk do të ikje kurrë nga Fieri, atë ditë pra, që unë nuk erdha në shtëpinë ku jetoje, (atje në katin e dytë ishte parajsja jote dhe ne na ndau flama dhe virusi), ti ike dhe unë nuk e mora dot përgjigjen.

Më ndodh të kaloj shpesh përballë shtëpisë tënde dhe dëgjoj zëra. "Ooooo, po ku je o Arben. Kam ngecur. Nuk po gjej dot çelësin e derës së parajsës të vj". Në fakt unë nuk dëgjoj vetëm këtë nga ty. Të dëgjoj të shumëfishuar në zëra që e kanë mbushur plot shtëpinë tënde. E ke dhënë shtëpinë këtu në tokë me qera? Kujt ia

kë dhënë? Dikujt që ngjan me ty? Me kujtimin e bashkëshortes së ikur prej dhjetëra vjetësh nga kjo botë dhe me dhimbjen e ikjes së parakohshme edhe të djalit të vetëm? Apo te personazhet e tu? I madh je. I vërtetë. Qibar pa ikur nga kjo botë dhe qibar ke ngelur vallahi dhe në atë botë. I ke përzgjedhur personazhet aq bukur dhe me finesë e ngjyrim myzeqar, sa që iu ke dhënë edhe strehë për të mos vdekur. Iu ke dhënë madje edhe shtëpinë me qera. Njëherë kur kalova pashë se luajti një perde dritareje. Ishte Gjergua. Po po Gjergua, ai mo, personazhi i cili e ka parathënë prej kohësh që do të vinte një kohë që nuk do të kishte më miq. Nuk e kishte fjalën për ty. Jooo! E kishte fjalën për mua!

"Koopeenëë, ku e kam koopeenëë" bëret një zë tjetër. Dhe del në ballkon e sheh nga kopshti dhe lulishtja e ngritur e re përballë pallatit tënd. E shoh këtë personazh myzeqar, tipik tangërllik që kërkon ende të nderoj miqtë dhe shokët e vet duke therur gjithë kopenë e deleve. Ai sorollatej nëpër ballkon dhe dikush tjetër nga brenda i kujtonte ujkun. "Ujkuuuu", ulërinte ai, me kapelën e myzeqarit hedhur mënjanë ballit. Dhe qeshte. Po po qeshte. "Ndiheni më tepër personazhe myzeqar apo Fuat myzeqar", i pyes personazhet e tu unë. Ata heshtin dhe nuk përgjigjen. Është e njëjta pyetje që të bëra dikur Fuat Boçi "Ndiheni më tepër voshtinas, apo myzeqar"? Ishte një ditë korriku me një puhizë erë, ku në ajër kulloste pak shpresë njeriu për shi. Ti u mendove dhe u mendove për t'iu përgjigjur. Sytë e tu depërtues, njësoj si zëri i veçantë, u mjegulluan, Por tu kthjellua zëri. "Myzeqeja është ushqimi im i përditshëm. I kam rënë bregut të Semanit, Gjanicës Vjosës në këmbë. Këtu kam zhvilluar hobet e mia, identitetin tim", ma nise rrëfimin. Më ndodh të çlodhem udhëve dhe kur dëgjoj: "Llazi, o Llazi! Dil më kë anë reeee, jo matë anë" ... "Më thërrasin njerëz që as i njoh. Më vjen mirë, është e folura myzeqare që aq shumë e dua. Më trishton që gjuha safi myzeqare po humbet", më the dhe u mbushe thellë me frymë sikur të mbushesh për të qenë i pazbratur kurrë, me aromën e veçantë që ruan për të katër stinët Myzeqeja e bukur. Kur në vitin 1937 babi yt, Ibrahim, vendosi që Fieri do të ishte streha e re për familjen, nuk e kishte menduar se ti atëherë vetën gjashtë vjeç, do ta doje kaq shumë këtë trevë dhe shumë më shumë këtë qytet. "Këtu kemi qenë dhe këtu do të jemi deri sa nata e madhe të na i mbylli sytë dhe të mos i shohim më hallet tona", më thotë personazhi i skalitur nga shkrimtari dhe regjisori Andrea Prifti në filmin "Lamtumirë Mik". Dhe sapo ai hesht si për të marrë frymë e pritur radhën për të folur në filmin "Lamtumirë Fuat", (film që nuk besoj se do të xhirohet kurrë), mua më kalon nxitimthi ideja se vështirë të xhirohet një film për ty Fuat, pa shtirje e uri për para e lavdi.

(Vijon nga faqja 5)

ndërkohë që pak muaj më vonë ishte tashmë një tërësi kontributesh që gjetën natyrshëm simbiozë prej dorës së vetë autorit, duke reflektuar njëkohësisht oroenat e recensentëve, të cilët janë ndër po aq natyrshëm pjesë e proceseve të rileximit e të reflektimeve të autorit Leka.⁵

I prirur të hulumtojë dhe në pasurinë arkivore që ruhet në pronësinë intelektuale të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë e që hedh dritë mbi çështje të historisë së letërsisë së shkruar shqipe e në veçanti mbi realizmin socialist në vendin tonë, Arian Leka solli të ripërpunuar dhe disa sprova që përmbajnë trajtesa mbi gjenezën e realizmit në vise të caktuara, për të vijuar më tej me prirje më të dallueshme në disa autorë të letërsisë sonë, për të cilët ka gjithashtu vend dhe për analiza më të hollësishme. Në trajtesën me titull *Midis detyrës dhe përgjegjësisë për ndryshime estetike (Poezia shqiptare-nga viti 1945, drejt viteve '70)*, botuar së pari në *Studime filologjike*, n.3-4, 2017, do të mund të gjejmë më tepër hollësi në lidhje me kontekstin tonë, duke filluar nga vitet '40, më saktë, pas çlirimit të vendit. Është një periudhë në lidhje me të cilën studiet tanë nuk kanë ndarë përherë të njëjtat mendime, por që gjithashtu dhe për t'u ndriçuar në pikëpamje dokumentare, më tej në atë të mendimit shkencor të pavarur, është paraqitur deri vonë me kushtëzime të kuptueshme. Në trajtesën e Arian Lekës çdo detaj që lidhet si me kontekste paralele, aq dhe me rrethanat që shpjegojnë dhe orientimet e shkrimtarëve të letërsisë shqipe pas viteve '45 vijnë në një vijimësi sa logjike, aq dhe konform çdo zhvillimi që më tej do të zërthehet në skema tipike për "një realizëm të vendit tonë", më shumë se të një realizmi të mirëfilltë. Zhvillime më të segmentuara që shënojnë ndarje në mendime, prirje të veçanta në krijimtari dhe qëndrime ndaj ndryshimeve të sforcuara që po përjetonte vendi ynë gjejnë vend natyrshëm në një trajtesë të tillë, duke pasur mbështetje një pasuri burimesh referenciale, jo vetëm literatura studimore zhvillimet letrare në vendet e Lindjes në Evropë, por dhe periodikët shqiptarë që patën pjesë të kujtesës së tyre vetë autorët që u bënë më tej aktorë të kësaj panorame.

Në leximin e reflektimet mbi një punë të tillë, që në të vërtetë është një ndërthurje sprovash dhe reflektimesh, kemi pasur një interes të veçantë në lidhje me qasjet e autorit ndaj veprave të Gj.Fishtës, E.Haxhiademit, H.Gjylbegajt, të përafuara në pikëpamje krerësh e kapitujsh brenda vëllimit të sipërcituar. Pjesë e përmbledhjes së sipërcituar janë bërë dhe dy sprova të plota e të punuara thellësisht mbi figura të letërsisë së shkruar shqipe, ndër të cilët dhe Luan Starova (1941-2022), veprimtarinë e të cilit Arian Leka e ka njohur gjatë e gjerësisht dhe për arsye të përfshirjes në procese përgatitore vëllimesh për botim.⁶ Paraqitet në vështrimin tonë më se e gjetur kjo përfshirje, e pasuar nga një trajtesë mbi çështje të modelit të krijimit mbi poetin Xhevahir Spahiu, shkrimtarinë e të cilit autori i punimit e ndjek dhe e hulumton nga afër prej kohësh.⁷ Në veçanti ky argument i fundit, i paraprirë dhe nga një historik i domosdoshëm mbi përpilimet letrare epigramatike në historinë e letërsisë sonë të shkruar, i shtrirë dhe në gjurmime gjeokulturore tipike, paraqitet i kujdesuar në çdo dimension e prirje, në përputhje me qasjen tematike që kërkon vetë ideja në fjalë.

Leximin tonë dhe konsultimet eventuale i ka ndihmuar së tepërmi dhe aparati i pasur bibliografik me të cilin autori ka shoqëruar të tilla trajtesa, pa lënë jashtë vëmendjes dhe shënimit e kujdesuara që nisen nga burime të posaçme referimi. Përmbledhja studimore me titull *"Konsensus dhe polemikë për emrat dhe mitet e letërsisë shqiptare"*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2022, me autor Arian Lekën ka pasuruar ndjeshëm kolanën e botimeve tona albanologjike, duke sjellë dhe një konceptim tematik me interes dhe të veçantë për nga kompleksiteti i zgjedhjeve të vetë autorit.

⁵ Pjesë e këtij procesi me konsideratat e tij të vjera është dhe prof.dr.Ardian Kycyku, Bukuresht, Rumani, njëherësh njohës dhe i krijimtarisë letrare të Arian Lekës.

⁶ Shih në veçanti kreun e katërt të përmbledhjes së sipërcituar kushtuar bashkëkohësisë, *po aty, botim i cituar*, f.331-392.

⁷ Bëhet fjalë për sprovën me titull *Poezia-miniaturë në gjuhën shqipe dhe Shkurtimat e Xhevahir Spahiu*, cituar sipas renditjes në materialin e përpiluar nga autori Arian Leka (*po aty, botim i cituar*, f.357-392), botuar në një variant të plotë në *Studime filologjike*, n.3-4, 2021, f.81-111.



Duket se në fëmijërinë e largët, fati nuk ka qenë edhe aq bujar me Jorgo Papingjin, sepse në rrethana aspak të zakonshme ai mbeti një i mitur jetim. Ishte vetëm 8 muajsh kur në vitin 1943, babai i tij u arrestua së bashku me 308 burra të Vlorës, në periudhën kur Gjermania naziste kishte pushtuar jo vetëm Shqipërinë, por një pjesë të rëndësishme të Evropës. Atëkohë, ai u deportua dhe u internua në njërin prej kampeve më famëkeqe të përqendrimit dhe të shfarosjes masive në Mat'hauzen të Austrisë, i ngritur enkas gjatë Luftës së Dytë Botërore. Vetëm në vitin 1945, përmes Kryqit të Kuq u mor vesh lajmi se ai nuk mundi të dalë më i gjallë prej andej.

Mungesa fizike e figurës qëndrore të babait në familjen Papingji e bënë Jorgon një fëmijë të rritur para kohe. Jeta e përballi me sakrificë të mëdha, i mbështetur edhe nga një nënë e dhembshur dhe e përkushtuar. Por, nga ana tjetër, kjo e bëri edhe më të fortë në karakter, me ambicie të mëdha për jetën, për të ardhmen, duke studiuar dhe punuar shumë për t'u bërë ai që sot e njohim të gjithë, një prej emrave më të spikatur të artit dhe kulturës sonë kombëtare.

Ndoshta kjo rrethanë, ishte një arsye më shumë që u bë shtysë tek unë për ta përjetuar me ndjesi të pashpjegueshme përgjegjësinë e realizimit të botimit të këtij libri të veçantë. Është një përmbledhje me poezi të muzikuara dhe të përzgjedhura nga i gjithë korpusi i krijimtarisë së tij, si njëri prej autorëve më të zëshëm dhe mjaft domethënës në historinë e Festivaleve të Këngës në RTSH dhe jo vetëm, mjeshtërit të fjalës dhe teksteve të muzikuara, Jorgo Papingji.

Ideja për të vijuar nisimën e botimit me këtë autor, pas botimit dhe publikimit të krijimtarisë së poetes të mirënjohur Zhuliana Jorganxhi, e ka ravijëzuar edhe më tej mendimin dhe bindjen time se, përpjekje të tilla nuk janë thjesht dhe vetëm një tek dhe shije personale e një individi apo grup individësh, as edhe një ngasje apo kënaqësi e çastit që të jep dëshira për t'u marrë me një proces të tillë pune që ka të bëjë me hulumtimin, përzgjedhjen dhe publikimin e tyre.

Asesi jo! Kjo sipërmarrje s'ka të bëjë gjithashtu as edhe me ndonjë sprovë, e ndërkohë, vlen më shumë se kaq: ngase nisma si këto vijin natyrshëm si një përpjekje dhe nevojë e ngutshme që lidhen domosdoshmërisht me identitetin tonë kulturor, me të shkuarën, me të tashmen dhe të ardhmen e muzikës shqiptare.

Ka të bëjë me rrugëtimin dhe sfidat që ndërthuren me ruajtjen e përvojës më të mirë, që natyrshëm synojnë të përcjellin nga njëri brez tek tjetri mushtin e traditës, kulturës dhe zakoneve aq të vyer, jo vetëm të artit muzikor shqiptar në tërësi, por veçmas edhe të një nënllaji degëzimi të këtij arti, i panjohur më parë, i munguar nga çdo studim e literaturë bashkëkohore, siç është edhe poezia e muzikuara...

Sepse kënga në vetvete, ndryshe nga të gjitha llojet e nënllajet e artit në përgjithësi, ka një ndikim të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë me shijet estetike dhe edukimin e publikut të gjerë. Ajo lidhet me mesazhet dhe emocionet, ndërvepron organikisht në marrëdhëniet dhe sjelljen e njeriut në jetën e përditshme.

Përmes tingujve dhe ndjesive që përcjell metrika e fjalës e harmonizuar brenda vijës melodike, kënga përçon një emocion të shumëfishtë. Ajo inspiron, frymëzon dhe të bën të meditoth për më ideale, për atë që është më e paprekshme dhe e shenjtë, që është njerëzore, e bukur, qiellore dhe hyjnore...

Kënga, më së shumti të bën të meditoth dhe të reflektosh për të gjitha gëzimet dhe vrundujt që të sjell jeta në përballje me sfidat e saj, në mbrojtje të dashurive të mëdha e të pastra, por njëherësh, të bën të mendosh edhe për luftën e përhershme që duhet të bësh për të shpëtuar jetën, dashuritë e humbura, mbase edhe të pakthyeshme, të sotmen dhe të ardhmen.

Është po kaq e vërtetë që kënga ndikon fuqishëm në ringjalljen dhe ripërtëritjen e ëndrrave të vrara, përmes përpjekjeve më sublimë që bën njeriu çdo ditë dhe çdo çast për të rilindur shpresat e mëdha, me qëllimin final: arritjen e triumfit dhe të lavdisë në të gjitha betejat me të keqen, kundër dhimbjes, kundër urrejtjes, kundër gjithçkaje që na duket e pamundur dhe e paarrtshme...

Një këngë kur pëlqehet, e dëgjon dhe e

JORGO PAGINGJI, KY DISHEPULL I URTË I FJALËS SË PRARUAR

Nga Ilir Çumani

Drejtor i Përgjithshëm i Institutit Kombëtar i Integritimit të Jetimëve Shqiptarë

Në "Ditën e Poezisë", një poet zgjodhi të shkruajë elegjinë e fundit hokatore të ikjes së tij fizike, si për të na kujtuar se asgjë në këtë botë nuk duhet marrë seriozisht, përfshirë edhe vdekjen... Ndaj, të gjithëve ne, bashkëkohësve të poetit që e jetuam prej dekadash mesazhin dhe kumtin e fjalës së tij, na takon t'i themi "Jo" largimit të Jorgo Papingjit nga bota e të gjallëve...

Të më falësh Mik, por zemra nuk më bindet të nxjerr nga goja fjalën: Lamtumirë! Të paktën vetëm sonte le të themi: "Jo...! Kështu e thua edhe ti në një nga vargjet e tua, poet...!"



pranon ashtu siç është. Pa e kuptuar e bën pjesë të jetës tënde, sepse kur muzika dhe teksti trupëzohen harmonikisht kthehen në "ushqim" shpirtëror të pashmangshëm, ajo ngjizet që herën e parë kur e dëgjon, ngase të miklon dhe të mbetet në buzë duke e kënduar përgjithmonë... . Kjo është magjia që ka muzika...

Kënga, si nënllaj i artit muzikor ngjan si një krijimtari e vogël, por njëherësh është edhe një transmetues i shpejtë dhe i drejtpërdrejtë i kumteve dhe mesazheve humane, emocioneve, ndjesive dhe përjetimeve që natyrshëm përcillen tek njeriu. Si të thuash, është një mjet i pazëvendësueshëm i komunikimit shpirtëror, i ndërveprimit emocional nga më të konsumuarit.

Muzika, në të gjithë kulturat e kombeve dhe popujve të tyre, përgjatë gjithë historisë së njerëzimit nuk ka njohur dhe nuk njeh kufij gjeografik, e padyshim, mjeshtërit e kësaj "zeje" artistike me origjinë mijërvjeçare, kanë patur dhe kanë pjesën më të madhe të barrës për të realizuar krijime sa më të bukura e të qëndrueshme, për t'i dhënë sa më shumë oksigjen, shpirt, frymë dhe jetë këngës së vërtetë....

Që ajo të jetoj sa më gjatë, duke na shpërfaqur në të përditshmen tonë të gjitha dimensionet reale të marrëdhënieve njerëzore, zakonet dhe traditat më të mira të mënyrës së jetës që kanë bërë paraardhësit tanë, por edhe për vazhdimësinë e jetës që përcillet në ditët e sotme. Me gjasa kështu do të ndodhë edhe me brezat e ardhshëm.

Një prej "zejtarëve" profesionistë i kësaj "zeje" aristokratësh, padyshim është edhe Jorgo Papingji. Me krijimtarinë e tij të begatë, ishte dhe mbetet një mjeshtër elegant i metrikës së vargëzuar, një tekstshkrues mjaft inteligjent dhe i përkorë i mijëra teksteve të muzikuara të këngës së lehtë shqiptare dhe atyre tradicionale e popullore.

Jorgo Papingji, në të njëjtin rrugëtim me sivëllezërit e gjeneratës së tij si, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Zhuliana Jorganxhi, Xhevahir Spahiu, Bardhyl Londo, Fatos Arapi, Betim Muço, Agim Isaku, Gjok Beci, Agim Isaku, Arben Duka, Koçi Petriti, Agim Doçi etj, sollën së bashku një frymë novatore në muzikën e këngës së lehtë shqiptare, duke ruajtur një kadencë të thjeshtë, qartësisht të kuptueshme, ata vendosën standardet më të epërme të këngës bashkëkohore dhe asaj moderne me plotë shije, estetike dhe elegancë.

I shfaqur me një talent mjaft befasues e mbresëlënës në mesin e viteve '70-të, ai mund të konsiderohet padyshim po aq i suksesshëm dhe ngjashëm si dy pika uji me tekstshkruesin

e famshëm italian, Giulio Rapetti, i njohur me pseudonimin artistik "Mogoli", i cili, atëkohë i dha shpirt këngës bashkëkohore dhe asaj moderne italiane, duke e dominuar mjaftueshëm skenën e Festivaleve të "Sanremos" me tekste mjaft të bukura e të pavdekshme, të kënduara nga këngëtarët e famshëm italianë si Lucio Battisti, Adriano Celentano, Domenico Modugno, Toto Cutugno, Massimo Ranieri, Lucio Dalla, Gianni Morandi, etj.

Formimi akademik i Jorgo Papingjit në shkencat ekzakte, fizikë - matematikë, në pamje të parë duket sikur nuk ka asnjë lidhje me fushën ku lëvroi për afro gjysmë shekulli të gjithë talentin e tij të praruar e të begatë. Përkundrazi...!

Ndoshta ky fakt e ndihmoi të ishte mjaftueshëm i vetëpërbajtur e racional, shpeshherë edhe i kursyer në atë që dinte të bënte më mirë, duke qëndruar larg tipologjive të njohura të krijimeve propagandistike, të dallueshme nga kllishetë skematike e shtampat e përgjithshme indoktrinuese të një arti të rekomanduar dhe të kontrolluar.

Si një "sizmograf" i ndjeshëm, Papingji si pak prej të ngjashmëve të tij, pati aftësinë për të kuptuar të gjitha forcat dhe kahjet e dinamikave që po merrnin zhvillimet socio-politike të vendit. Që në krye të herës, ai u kthye në një pelegrin dhe lajmëtar të shpresës për ringjalljen kombëtare përmes fjalës dhe muzikës...

Kjo e shpjegon edhe më qartë arsyen se përse krijimtaria e tij ishte kaq ndikuese, kaq përfaqësuese, e përqasur me nevojat shpirtërore dhe shijet e publikut të gjerë. Poezia e tij është e vërtetë, e sinqertë, e thjeshtë, e pastër, e kuptueshme dhe komunikuese e drejtpërdrejtë...

I spikatur jo vetëm si një lirik që shkroi kaq shumë për dashurinë, Papingji ishte edhe një mjeshtër i baladave sociale, ngase ishte një vëzhgues mjaft i vëmendshëm i fenomeneve dhe problemeve të shumta të jetës së përditshme që kalonte dhe i përjetonte me dhimbje shoqëria.

Periudha tejet e zgjatur e tranzicionit shqiptar që dukej se nuk do të kishte fund, shkaktoi mjaft konflikte sociale dhe politike, ato sollën për pasojë shumë drama dhe plagë të rënda e të dhimbshme për gjithë shoqërinë.

I shqetësuar për fatet e saj dhe të vendit, poeti qëmtonte detaje dhe ndërtonte fabula të fuqishme, mbi të cilat krijonte vargje që përcillnin kumte tronditëse, ato të magjepsnin, jo vetëm për thjeshtësinë dhe vërtetësinë e tyre, por edhe për mesazhet e qarta të cilat mbetet gjithmonë aktuale.

Kjo e shpjegon edhe faktin se krijimtaria e tij arriti kulminacione të reja duke qenë nga

më prodhimtarët, i pranishëm në shumicën e ngjarjeve të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, tekstet e tij ishin të preferuara për t'u muzikuar nga shumë kompozitorë dhe interpretë të këngës.

Metrika e vargëzimit në tekstet e tij ka brenda shpirtin e lirë të një bohemi avangardë, të poetit të përvuajtur e të pagjumë, mendimin e shqetësuar të intelektualit dhe edukatorit zemërdhembshur. Brenda qenies së tij qëndron gjithmonë e struktur klithma e pazhurmë e Njeriut të shqetësuar për Njeriun... Atje vibron se brendshmi në gjithë qenien e tij ofshama e një dhimbjeje të pamatë prej mungesës së dashurisë, gëzimit dhe lumturisë të një fëmijë të vetmuar, pa ngrohtësi dhe pa një vatër familjare...

"Ti që ditë për ditë, E ëndërrore fëmijërinë, Fëmijërinë s'e preke kurrë, Ti që fale moshën, Për të mbajtur gjithë shtëpinë, Ti u bërë foshnjë-burrë..."

Kush më mirë se Jorgo Papingji mund ta ndjej këtë dhimbje, këtë dramë të madhe sociale që mbajnë sot mbi shpatullat e njoma këta fëmijë të pafajshëm....?!

Sa tronditëse aq edhe demaskuese vijnë këto vargje tek lexuesi. Ato akuzojnë haptazi një realitet shoqëror që mban të fshehur brenda vetes një fenomen që ende vjen në kohët e sotme si reminiscencë e së kaluarës, që lidhet me flohtësinë, vrazhdësinë, indiferencën, përjashtimin social...

"Dashurinë nuk e kam njohur, / Dashurinë te njerëzit e kërkoh, / Kërkoj një dorë që ta shtrëngoj, / Një dorë që t'i besoj... / Unë mëshirën nuk e dua, / Dhe nga njerëzit, jo nuk e kërkoh, / Kërkoj një dritë të më ndihmojë, / Dhe rrugën time ta ndriçoj..."

Poeti nuk lë jashtë kësaj tabloje të shëmtuar një sistem të tërë, të cilit i mungojnë rregullat dhe shtyllat kryesore të kohezionit social për të marrë në mbrojtje fëmijët, ata që janë më të ekspozuar dhe më të pambrojtur nga dramat dhe plagët e reja sociale.

Ndaj edhe apeloni për më shumë dashuri e dinjtet për jetën. Ai e përbuz mëshirën si një prej shkaqeve që nuk e zgjidh problemin, ngase mëshira nuk i shëron plagët, por veçse i mban gjithmonë të hapura kur ato nuk mjekohen siç duhet.

Teksa merresha me procesin e strukturimit të librit, në pjesën e përmbledhjes së kujtimeve për Jorgon nga shumë miq e koleg dhe dashamirës të tij, kuptova se sa shumë gjurmë të thella paska lënë ky magjistari i fjalës së këngëzuar në jetën e gjithsecilit prej nesh, sa shumë dashuri dhe gazmend ka në këto gjurmë...

Padyshim, janë breza e breza të tërë që e kanë përjetuar mrekullisht talentin dhe befasinë që përcillte fjala e tij përmes këngës, veçanërisht në një kohë aq të zyrtë ku të gjithëve na mungonte shumëçka, por jo gjithçka... Sepse ja u ishin ata murgjërit e heshtur dhe të mençur të fjalës, që mbanin të ndezur dritën e pishtarit të shpresave të mëdha, që na i mjekonin dita ditës vragat e zbrazëtirave shpirtërore të atyre viteve, duke na i mbushur zemrat tona me aq shumë dashuri, ngrohtësi e shpresë...

Prallëkush si Papingji me të ngjashmit e tij kanë ndikuar aq ndjeshëm dhe kaq shumë në shijet estetike të së bukurës dhe të së mirës tek pjesa më e madhe e njerëzve të zakonshëm, duke e humanizuar dhe e pasuruar shoqërinë me ideale të pastra, me aspiratat dhe dashurinë e madhe për jetën, për të ardhmen, për familjen, Atdheun, tokën ku u lindëm, u rritëm dhe ku atje do të prehem...

Është një jetë e tërë që përmes fjalës së tyre të këngëzuar është shkruar dhe arkivuar një pjesë e rëndësishme e historisë së popullit, e një kombi sa vital, aq edhe energjik, që në ashtin dhe kurmin e vet kanë mbetur të gdhendura si dëshmi të kohës që jetuam të gjitha përpjekjet, sfidat e mbijetesës dhe të ekzistencës për të qenë gjithmonë të lirë, të pavarësuar dhe të prosperuar, të begatuar dhe po aq krenar sa ç'janë të gjitha kombet e zhvilluara dhe të qytëtuara kudo në botë...

Papingji me krijimtarinë e tij kaq të pasur me metaforat dhe simbolikat e fuqishme ishte dhe do të mbetet një poet i pakohë... Ai u rrit jetim pa baba, por u bë Ati më i dashur dhe më shembullor i FJALËS së këngëzuar... Eh, çfarë pasurie të madhe le pas Poet...!

SHQIPJA E SOTME E POEZISË
PËRBALLË GREQISHTES ARKAIKE

Poema *Alipashaida*, tanimë, ka dy autorë: poetin Haxhi Shehreti, që e ka shkruar, në vitet 1790-1822, në greqisht, dhe gjurmuesin, studiuesin dhe përkthyesin në shqip, Irakli Koçollari, të cilët i ndan një kohë dyshkullore. Për kulturën shqiptare dhe për shqiptarët, madje edhe për shqiptarët e Jugut, poema ishte e paqenë, ndonëse, në të këndohen historia dhe bëmat e tyre. Disa pak intelektualë të brezave të viteve 1960-1980, të interesuar për letërsinë, kanë pasë dëgjuar prej të moshuarve emrin e Haxhi Shehretit. Të moshuarit, nëse dëgjonin në radio, ose, lexonin në gazetë emrin e ndonjë poeti bashkëkohës, kundërviheshin me shprehjen «poet ka qenë Haxhi Shehreti!» Vetëm kaq. Më shumë se emri, dhe, se ishte poet, që i kishte kënduar Ali Pashait të Janinës, as ata nuk dinin.

Kam pasur rast, në vitet 1980, të mësoj diçka dhe të dëgjoj vargje të përkthyer nga greqishtja prej mikut, poetit dhe përkthyesit Llambro Ruci. Ishim fqinj, në të njëjtën ndërtesë të rruga «Aleksandër Moisiu», Nr. 32, afër Kinostudios. Herë-herë vinte me libra në greqisht, që shkruanin për heronj shqiptarë në Greqi, sidomos për Sulin, suljotët dhe Marko Boçarin. Libri me vargje të Shehretit ngjan të ketë qenë i ndonjë historiani grek, sepse kishte dhe shënime sqaruese. Kur doli *Alipashaida* në shqip, i kërkova Llambros, dhe ai shkroi për revistën *Universi Shqiptar* i Librit një recension vlerësues.

Në padijen e shurdhët e memeece, dalja e *Alipashaidës*, më 1997, ishte një befasi e ndjeshme letrare, kulturore e shkencore. Irakli Koçollari nga një emër Haxhi Shehreti, me punë jo të zakonshme, dhunti të shquara studiuese, talentin e përkthyesit, të ushqyer nga një pasion e përkushtim i rrallë atdhetar, na solli, në shqip, një monument kulturor të botës shqiptare dhe historisë së saj, në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX.

Para rindërtimit të sotëm *Alipashaida*, në dorëshkrim, ishte e copëzuar dhe e shpërndarë në disa biblioteka, në disa botime të pjesshme, edhe ato të copëzuara e të shpërndara në studime historike, në greqisht dhe anglisht. Irakli Koçollari i kërkoi ato, për vite të tëra, i gjeti në arkiva dhe biblioteka, nga Greqia në Britani, dhe e rindërtoi në sistemin e vet poetik origjinal, të vijueshëm e qartësisht të rrjedhshëm.

Edhe thjesht përkthimi, prej greqishtes në shqip, e bën Irakli Koçollarin, autor të dytë të saj. Çdo përkthyes është bashkautor, më saktë, autori i dytë. Për më tepër, duke e nxjerrë nga errësira e dorëshkrimeve dhe e botimeve të shekullit XIX, ai e përkaloi nga funksioni potencial në funksion të njëmendtë, real, i dha mundësinë e receptimit, madje, i dha funksionin në gjuhën shqipe, në një horizont pritjeje tjetër, që poeti nuk ia pati dhënë, dhe as nuk e kishte në projektin e vet. Kuptohet, vëstitësi më vete ka qenë greqishtja arkaike, e kohëve të shkuara, që kërkonte njohje të atij motërzimi, që ka pasë përdorur Shehreti. Për ta përkthyer nuk mjaftonte shqipja standarde. Janë qindra fjalë, që përdoren në kohën e Ali Pashait, ndërsa, sot janë në leksikon pasiv të saj: historizma nga leksiku fetar, administrativ, perandorak dhe i pashallëkut, i hierarkive shtetërore, i ushtrisë, i llojeve të armëve e të veshjeve, i mirësjelljes e i nderimit të prijësve dhe të sundimtarëve, i titujve, shpërblimeve, dhe, nëpër to, mjaft barbarizma nga gjuhë të ndryshme, shoqëruar vazhdimisht me gjegjësen e tyre në shqip, ose, me shpjegimin përkatës. Është shqipja e një kohe tjetër, e domosdoshme për të sjellë të gjallë historinë dhe bëmat njerëzore. Përkthimi i ka riaktivizuar. Lexuesi i merr ato në trajta aktive, nëpërmjet tyre përjeton të shkuarën e të parëve të vet.

Më e vështirë se gjetja e trajtave dhe shprehjeve të shqipes, gjegjëse të trajtave dhe shprehjeve të greqishtes, është përkthimi në vargje, i cili është një rikrijim poetik, ose, një lloj krijimi më vete. Përkthimi i mijëra

Irakli Koçollari, *Alipashaida*, Onufri, Tiranë, 2023"ALIPASHAIDA",
MONUMENT KULTUROR
PËR BOTËN SHQIPTARE

Nga Bashkim Kuçuku



vargjeve, me metrikë të rregullt dhe të rimuar, sikurse është *Alipashaida* në shqip, në kohët moderne dhe në bashkëkohësi, praktikisht, është, gati, e papërballueshme. Prandaj, edhe teoria e përkthimit, në një nga mundësitë, pranon shmangjen e rigozitetit metrik, zbatuar edhe në praktikën e gjuhëve të tjera. Irakli Koçollari ka ndjekur rrugën e stërmundimshme të përkthimit klasik, të cilit ia ka dalë mbanë me një shqipe popullore mirëligjëruese e bukurtingëlluese. Frazologjizmat e shqipes, bie fjala, të përdorura mjeshtërisht, veç zhdërvjelltësisë dhe shprehësisë së theksuar, përftojnë edhe dendësi emocionale. Me mendësitë dhe përfytyrimet figurativë shqiptare, e intimizojnë lexuesin me ato që recepton përmes vargjeve.

Një problem i historiografisë së letërsisë *Alipashaida* është shkruar në greqisht. Shqiptarët po e receptojnë përmes përkthimit. Shqipja është gjuha e përdorur nga përkthyesi. A mund të jetë një vepër e tillë, e shkruar në origjinal greqisht, monument kulture për botën shqiptare, sikurse kemi guxuar ta themi, në fillim të kësaj kumtese? Të shkruarit e letërsive në një gjuhë tjetër, jo në gjuhën amtare, është dukuri e njohur, sidomos në letërsinë, që, për shkak të rrethanave historike dhe kulturore, janë zhvilluar më vonë, se simotrat në

gjuhë të tjera, të lëvruara më parë. Naim Frashëri ka shkruar poezi në persisht dhe në greqisht. Sami Frashëri ka shkruar në osmanisht romanin *Dashuria e Talatit me Fitneten* (botuar në Stamboll, 1872). Pashko Vasa ka shkruar dhe botuar në frëngjisht romanin *Bardha e Temalit* (Paris, 1890). Këto vepra prej vitesh janë përkthyer e botuar në shqip, dhe prej atëherë janë pjesë përbërëse e letërsisë shqipe. Kjo dukuri ka qenë e shfaqur në *Rilindjen* shqiptare, 70-80 vjet pas *Alipashaidës*.

Për Shehretin nuk ka qenë vetëm mungesa e alfabetit të shqipes, që poema është shkruar në greqisht. Edhe nëse do të kishte shqipja e shkruar një alfabet të njohur e pak a shumë të qëndrueshëm, do të ishte e vështirë, në mos e pamundur, të shkruhej në shqip. Përmasat e saj mijëra vargjesh, që nënkuptojnë një fjalor mjaft të pasur shkrimi, nuk i ushqente dot shqipja e atëherëshme. Mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, në këtë rast të shqipes, ka një ndryshim të madh. Alfabeti nuk është zgjidhja e parë dhe e fundit, sepse, ai është vetëm mjeti. Kalimi te gjuha e shkruar është kalim i ndryshim i madh mendësie, botëkuptimi, mënyre kuptimi e përdorimi të saj, marrdhënie e re e shkrimtarit me atë gjuhë, njëherësh, marrdhënie e re me gjuhën amtare edhe e lexuesit, të cilit i drejtohet. Bota shqiptare,

shkrimtari dhe lexuesi i mundshëm nuk kishin arritur në këtë fazë. Pastaj vjen gjetja e mjetit, - alfabetit me të cilën do të shkruhet. Një lloj alfabeti, disa vjet me vonë, sajoi Muhamet Kuçuku, Çami, për t'i shkruar në shqip poemat e tij.


Të shkruarit në një gjuhë tjetër, të kultivuar, përfohet edhe nga formimi i poetit. Gjithashtu, nga mundësia e receptuesve më të shumtë, sikurse do t'i gjente dhe i gjeti në atë kohë, edhe *Alipashida* në greqisht. Shkrimtarët prirën edhe nga egoja, dëshira e tyre për lavdi, d. m. th. . dëshirë për t'u lexuar sa më gjerësisht.

Mirëpo, përveç mungesës së gjuhës amtare, që nga autori me psikologji, botëkuptim e mendësi, përgjithësisht, heronjtë veprues, mjediset e jetesës dhe të natyrës janë shqiptare e të botës shqiptare, në përmasa, si në asnjë poemë tjetër epike në shqip, dhe, në një periudhë tepër domethënëse, mes sundimit dhe errësirës mesjetare osmane dhe pragut të zgjimit të vetëdijes kombëtare. Në këtë këndvështrim, *Alipashaida* është lajmëruese e poemave epike të njohura *Istori e Skënderbeut* (1898), *Qerbelaja* (1898) të Naim Frashërit, dhe *Lahuta e Malësisë* (1937) e Gjergj Fishtës, ndonëse, ato janë shkruar tetëdhjetë dhe njëqind e njëzet vjet më vonë.

TIPARE ANTROPOLOGJIKE TË
NJËMENDTA/REALE

Alipashaida është vlerësuar prej studiuesve dhe historianëve të huaj, sidomos për vërtetësinë e këngëtimit të ngjarjeve, fakteve dhe bëmat njerëzore, e cila mbetet cilësi e shquar e saj. Ndoshta, më të rëndësishme, janë përvijimet e tipareve antropologjike, etnografike a etnologjike të shqiptarit. Rrëfimi i ngjarjeve, për betejat dhe lëvizjet këmbëhet shpesh me përshkrimin e gjendjeve psikologjike të shëmbëlltyrave njerëzore, duke e shndërruar atë në poemë psikologjike, veçanërisht të figurës së Ali Pashait. Të dhënat dhe tiparet antropologjike, ndryshe nga përshkrimi i ngrirë i etnologut, apo, etnografit, në vargjet e saj, janë të gjalla, shprehëse të drejtpërdrejta të botës së brendshme të shqiptarit në rrethana të caktuara historike dhe gjendje mendimore e emocionale, zakonisht, dramatike. Prej tyre përvijohen botëkuptimet, bindjet fetare, mendësitë shoqërore e morale, normat e sjelljes e të nderimit, të urrejtjes e të përbuzjes, qëllimet dhe interesat e ndërlukuara jetësore, të dhëna të karakterit e të temperamentit, larmia njerëzore shqiptare, në një kohë pak të njohur prej nesh. Ndërthuren dy perceptime e qëndrime morale. Morali i përgjithshëm shqiptar i shëmbëlltyrave të figurav historike popullore, kryesisht, pozitive, të dinjitetshëm e të drejtë në mbrojtjen e vetes dhe të lirisë së tyre, që është dytësor. Dhe perceptimi e qëndrimi i Shehretit. Në perceptimin e poetit, e mira dhe drejtësia, e drejta dhe morali i epërm është forca luftarake, ngadhënjimi i qëllimit të pashait, pavarësisht barbarive e gjëmave njerëzore, një mendësi mesjetare osmane, që është zotëruese. Me një mendësi dhe masë të tillë, edhe pabesitë e Ali Pashait janë të drejta dhe të mira, sepse ngadhënjën pushteti absolut i dhunës së tij. Të dhëna të tilla të njëmendta, përbëjnë vlerë dokumentimi, ndërsa, në gjykimin e përgjithshëm njerëzor, nga këndvështrimi i sotëm, janë antihumane dhe negative. Vlera

(Vijon në faqen 11)



I

Lexuesit shqiptarë, Zef Pllumin e njohin si autor të veprave, “Rrno vetëm për me tregue”, “Histori kurrë e shkrueme”, “Françeskanët e mëdhaj”, “Saga e fëmijnisë”, etj., ku ka sintetizuar vuajtjet e tmerret nëpër burgje, dhe ka shkruar për çështje të kulturës e historisë, për ngjarje e personalitete të spikatura, duke krijuar kështu në historinë e kulturës shqiptare profilin e një shkrimtari, dëshmitari dhe mendimtari të madh.

Libri monumental, “Rrno vetëm për me tregue” është historia e kujtimeve personale të autorit, por esencialisht dhe objektivist, është edhe historia e komunizmit shqiptar, me të gjitha tipologjitë e ngjarjet që e karakterizuan atë, me fytyrën reale të shëmtisë e të egërsisë, me të cilën regjimi brutal shtypte lirinë e vërtetë njerëzore. Në këtë mënyrë, rrëfimet e tij personale, objektivist, mbeten referenca të përhershme historike, për të kuptuar të vërtetën e dimrit të egër komunist në Shqipëri.¹

Pikërisht këtë dimër të tmerrshëm komunist, autori e transmeton te lexuesi, edhe në poezi.

Poezitë e Pllumit janë botuar në librin “Antipoezi për shekullin njëzetë (Poema antiepikë)”, me pseudonimin Lis Mali, 2001, të redaktuara me emrin e tij të vërtetë, Zef Pllumi. Po ashtu, ai ka lënë në dorëshkrim “Poezi dhe antipoezi 1950-1960”, të cilat janë përmbledhë dhe botuar me titullin “Poezi”² nën kujdesin e Botimeve Françeskane dhe me një parathënie të studiuesit Kujtim Shala.

Është vetë Pllumi që jep të dhëna shpjeguese, kthjelluese dhe orientuese rreth natyrës ontologjike të poezisë së tij; temave dhe ideve që transmeton ajo. Edhe në poezi, përpara lexuesit, rrjedhimisht gjyqit të historisë, ai është dëshmitar - dëshmon se poezitë e tij kanë dalë jashtë burgut me ndihmën e disa shokëve; dëshmon se janë shkruar përgjatë një dimni barbar, me lot, me gjak e me vnerë. Në “Prolog” rrëfhet dhe kërkon prej lexuesit që të bëhet bashkudhëtar i fantazive të tij krijuese:

“Vargjet e mia
kanë lindun gjatë netve të një dimni
barbar;
t’nji dimni shqiptar,
kur, jo, s’kishte lule, gjethë e as bar;
kur zdashun e zdashun, krejt rraskapitun
veç me buk t’mjukun mbetsha i uritun;
ndër prangat e randa kambë e duer lidhun
përdhuni zvarritej jeta ma i hidhun.
Nuk pata ngjyrë shkrimi
po i shkrova ngalerë
me lot, me gjak e me vnerë.”³

Kjo dëshmi kaq tronditëse, që i paraprinë librit me poezi është jeta e vërtetë e shkrimtarit dhe fratit, memoaret e të cilit, e kanë shpalosë atë me tërë përmasën e dhimbjes e tragjedisë, që rëndoi mbi të, sivëllezërit e tij dhe kombin shqiptar. Në poezi, për dallim, kjo jetë shpaloset përmes ëndrrës për të vërtetën e mundshme - të cilën e dëshiron poezia e arti.

Poezitë e Pllumit, në esencë, janë mendime, ide e imazhe, ku ai shpreh botëkuptimet, bindjet dhe besimin e tij. Vargjet bëhen shprehje e emocioneve, shpresës, dëshirave, ëndrrave dhe poeti i lejon vetes të pushtohet nga fantazia e imagjinata, ndryshe prej formave tjera të shkrimit, kur teksti tregon ndodhi e situata të vërteta apo analizon ngjarje, personalitete dhe fenomene reale, pra të dokumentuara e të njohura historikisht.

Dhe çka fantazon e ëndërron poeti?

Carl Gusav Jung te libri “Letërsia, mitet dhe simbolet” thotë se “një vepër e madhe letrare është si një ëndërr, e cila me gjithë



POEZIA E ZEF PLLUMIT

Nga Ndue Ukaj

qartësinë nuk interpreton dhe nuk është krejt e paqartë. Asnjë ëndërr nuk thotë ndonjëherë. “Ti duhet”...ose “kjo është e vërteta.” Ajo tregon një fotografi dhe si natyra lejon që një bimë të rritet jashtë oborrit dhe na mbetet ne që të nxjerrim përfundime.⁴

Poezitë e Pllumit i përkasin një realiteti psikik dhe janë pasqyrim i gjendjes emocionale të autorit të izoluar; janë shpërthime dramatike në momente të njeriut të burgosur që ëndërron lirinë e njeriun e vërtetë.

Këtë dimension e shpreh më qartësisht se kudo te poezia “Andra ime” ku poeti shpaloset përpara lexuesit dhe i dëfton ëndrrën e madhe - që lidhet me krye ëndrrën - njerëzit të përmbysin kultin e dhunës:

“Sasht fjala për andrrat që shofim na
ngjëmë:

Prandaj un e due at andrrën e mirë:
që njerzit dikur, me hir o pa hir,
do rrxojnë e përmbysin kultin e dhunës,
instinktet shtasore t’mënisë e furtunës,
dhe n’vendin e tyne do t’vehet
Mirsia,

Mendja njerzore,
Zemra e Dashunija!⁵

Kjo krye ëndërr është dëshirë e dëlirë e njeriut me botë të fortë etike e estetike, e njeriut që përjeton tmerre pafund dhe mbeti deri në fund - Njeri.

Në një perspektivë poetike më universale, teksta lexoj këto vargje më vjen në mend poeti amerikan Walt Whitman - i cili kërkon prej nesh si lexues e poetë, të mos pushojmë kurrë së besuari se fjalët e poezisë mund ta ndryshojnë vërtet botën; sepse ëndrrat na shpijnë kah një botë më e mirë dhe më e vërtetë.⁶

A mund të ketë njeriu në burgje, i rrahur e uritur, ëndrra të tilla?

Jeta dhe poezie Pllumit tregojnë e provojnë një Po të madhe; se njeriu i mëshirshëm nuk shtazifikohet asnjëherë përkundrejt dhunës e terrorit shtazor që përjeton.

Poezia e Pllumit shfaqet krejt e qartë, e zhveshur nga abstraksionet dhe flet drejtpërdrejt, e fton lexuesin e secilës kohë të ëndërrtojë dhe të guxojë të përmbysë kultin e dhunës.

E këtu, si lexues e krijues, më vjen në mend mësimi aristotelian për katharsisin, një mësim të cilit letërsia i ka qëndruar besnike ndër shekuj.

Pllumi ishte prift dhe i besonte konceptit të mëshirës e faljes, përmes aktit të rrëfimit e të pendimit. Në letërsi, mëshira e katharsisi arrihen përmes reflektimit të thellë dhe

mësimeve nga tragjeditë e të tjerëve. Në këtë aspekt, poezia e tij merr funksion të dyfishtë: ajo ngjan në një altar ku predikohet e udhëzohet mëshira dhe një rrefyestore katharsisi.

Pllumi si frat e si shkrimtar kishte besim se kultura ishte arma më e duhur ose e vetmja që mund të gjallëronte kombin e tij të dërmuar moralisht dhe ta shpinte kah përparimi. Në këtë drejtim, ngjashëm me sivëllezërit françeskanë, ai kishte një admirim për artin e poezinë.

Për të përligjë këtë, duhet kujtuar faktin se Pllumi u formua në shkollën françeskane dhe pikëpamjet e tij shpirtërore, kulturore, etike e estetike, janë të lidhura me Bibliotekën Françeskane, shkollën “Illyricum”, Kuvendin dhe Gjergj Fishtën si prijës më i shquar i tyre. Këto elemente fermentuan identitetin dhe profilin krijues që reflektohet edhe në fantazitë poetike. Kjo shkollë, në rrafshin universal strumbullar ka moton e Shën Françeskut “Pax et Bonum” (Paqe e mirësi), të cilën Pllumi e ndjek me devocion, kurse në rrafshin kombëtar, ka formulën tjetër autentike, të njohur e të pranuar - vulë e identitetit kombëtar, Atme e Fe.

Pllumi hyri në Kuvend në moshë të re, pastaj kaloi nëpër burgje komuniste 25 vjet. Përpara se të burgosej, ai ishte rrethuar me personalitete të spikatura e me ndikim në fushën e kulturës e artit shqiptar, në krye të së cilës ishte heroi kulturor i kohës, At Gjergj Fishta, të cilin e admironte dhe qysh i vogël i pëlqente ta lexonte “atë “Lahutë Malciet” edhe e kam pasë xanë permendsh” - thotë ai.⁷

Ai u burgos për shkak të bindjeve fetare dhe kulturore; kaloi vite të rënda në burg me akuza false, u torturua dhe përjetoi shtazifikimin e njeriut, dhe kur doli, në prologun programatik të librit monumental “Rrno vetëm për me tregue” sintetizoi tronditjet shpirtërore, duke shtruar përpara lexuesit dilema të përhershme:

“Thuhet se bota ecë! Së paku kështu thonë të gjithë të rritë, që mund të jenë edhe pleq. Shumkush, për mos me thanë “gjithkush”, mendon se i jep një dishka të re botës, njerzimit! Kurrja e re nën këtë diell! Ndërsa ujet rrjedh, bota po aty. Kur po lexoj Biblën, o kur po kundroj piramidat atje në shkretët, pyes: si asht e mundun që njeriu i shek. XX, në kulm të qytetnimit matrial, të jetë po aq barbar sa ai i 40 shekujve përpara?”⁸

Autori i shkruan lexuesit dhe nënkupton lexuesin e devotshëm e të përqendruar, që i blatohet të vërtetës të shkrimit kërkon të vërtetën - tempullin e katharsisi - dhe me dashamirësi e këshillon të reflektojë e të kërkojë shkaku e vërtetë - përse ndodhën

ato ngjarje e tragjedi mbi popullin shqiptar? E kjo pyetje në njëfarë mënyrë bëhet një lloj filozofi goditëse e krejt veprës e tij që në poezi merr trajtë më të qartë, etike e estetike. Autori kudo i shpjegon arsyet e kësaj tragjedie njerëzore, por asnjëherë s’e bjerrë dashurinë për njeriun, madje as për armiqët, të cilët ka dëshirë t’i sheh të penduar, të dënuar moralisht e të ndërgjegjësuar për krimet që kanë bërë, por jo duke vuajtë në burgje dhe thotë se “burgu asht institucioni ma i poshtër që ka sajue njerëzimi. Un jam kundër çdo lloj burgu dhe as anmikun nuk due me pa aty.”⁹ Duke u nisë nga ky parim kaq human e kaq etik, autori pasi doli prej burgu dhe pasi Shqipëria fitoi liri fizike, me tërë qenien u angazhua që lexuesve t’iu dëshmojë ferrin komunist, jo për t’u hakmarrë, por për t’i kthjelluar në proceset e transformave drejt lirisë së njëmend, përpara së cilës blatohej e të cilën e mëkonte me dashuri pafund.

Ky standard kaq i lartë etik është edhe standard i poezisë, ku ai rrëfhet dhe kërkon që lexuesi të rrëfhet bashkë me të për të arritë mëshirën e plotë drejt rrëzimit të kultit të dhunës.

Pllumi jetoi dhe u sakrifiku për këto ide e ideale sublime. Ai pranoi burgun, por s’i bjerrti idetë e idealet dhe ato i mishëroi në shkrime e biseda, duke shprehë kurdoherë dashuri pafund për Njeriun e për Lirinë, sipas parimeve e mësimeve të Shën Françeskut dhe shkollës françeskane shqiptare, mësimet këto që ishin shujtë e përditshme e jetës dhe punës së tij dhe krye motive të poezisë e tij.

II

Duke e lexuar poezinë e Zef Pllumit më përforcohet bindja e thënë shpesh, se poetët e çdo kombi zotërojnë një forcë magjepsë për të hyjnizuar natyrën e dyfishtë të së vërtetës përmes një gjuhë të pakrahasueshme e të paharrueshme. Pllumi në poezinë e tij flet për raportet midis lirisë e tiranisë, dashurisë dhe urretjes, drejtësisë dhe padrejtësisë, gëzimit dhe pikëllimit, fitores dhe humbjes, fuqisë dhe pafuqisë, virtyt dhe vesit, flet për natyrën, tokën, peizazhet magjepsë, shokun, motrën, ylberin malsinë, dimnin, gardhet, perçet, gërmadhat, kohën, deshmorin, Neronin, politikën, satelitët artificial, etj. Nëpër këto trajektore lëvizin vargjet e tij dhe dëftojnë ëndrrën për shekullin e tij, dëshirën zhuritëse për vendin e për lirinë si vlera më supreme njerëzore.

Në momente kataklizmash, arti e poezia janë shprehje e shpresës, aspiratave dhe identitetit njerëzor, thotë diku poeti i madh Czeslaw Milosz.¹⁰

Pllumi i shkruan poezitë në momente kataklizmash, në burg dhe, siç përmendëm më sipër, me ndihmën e disa shokëve, ato dalin jashtë. Kjo aventurë poetike është një lloj arratisje e dyfishtë, një lojë letrare, meqë poezitë arratisen prej burgut, institucionet më famëkeq ku torturohej njeriu e poeti, për të dalë në dritë, si forca rrëzëlluese. Kjo ishte dëshira e poetit të lirisë që besonte se poezitë e lirisë ishe shtizë goditëse në zemrën e tiranit dhe tiranisë.

Në poezinë e Pllumit ndihet aroma e lirisë, e burgut, e tmerrit të njeriut të përbuzur, e mallit për njerëz, e dashurisë për atdheun, por lexuesi sheh lartë, sepse poeti e orienton andej, kah drita, sheh një shkallë të epërme të humanizmit që ndonjëherë vështirë kuptohet kur i mendon rrethanat si u krijuan vargje dhe si ia dolën të dilnin jashtë.

Poeti bëhet dëshmitar e këngëtar i këtyre vuajtjeve, por duke shprehë dëshira, emocione, dhimbje, mendime. Ai përsiat për tema themelore të etikës e të estetikës, të historisë e të besimit dhe ato i lidh nyje me virtytet, - dhe e shpall veten luftëtar, por jo me armë - për të rrëzuar mendësinë e tiranisë dhe kultin e dhunës.

¹ Ndue Ukaj, *At Zef Pllumi: mendimtar i lirë dhe Shqipëria e burgosur*, në *Hylli i Dritës*, Nr. II. 2017, fq. 35.

² At Zef Pllumi, *Poezi*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2020.

³ At Zef Pllumi, *Poezi*, fq. 39.

⁴ C G Jung, *Litteratur, myter och symboler*, Nature och kultur, Stockholm, 1976, fq. 91.

⁵ At Zef Pllumi, *Poezi*, fq. 40-42.

⁶ Ndue Ukaj, *Introduction, NYC from inside*, Collected and edited by George Wallace. Blue Light Press, San Francisco, 2022, fq. XVII

⁷ *Kështu foli At Zef Pllumi me gazetaret*, Onufri, 2008, fq. 130.

⁸ At Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, Botimet Françeskane, 2015, fq. 15.

⁹ *Kështu foli At Zef Pllumi me gazetaret*, fq. 49.

¹⁰ A interview with Czeslaw Milosz, <https://www.nybooks.com/articles/1986/02/27/an-interview-with-czeslaw-milosz/>

Pra, njeriu dhe Liria janë tema themelore të poezisë tij.

I mishëruar me këto dy tema boshte, idetë themelore të poezisë së tij janë liria kundrejt tiranisë dhe dashuria kundrejt dhunës, drita kundrejt errësirës, tema të përhershme të ndërgjegjes njerëzore, mendon Pllumi. Dhe vëzhgimet poetike të poetit për këto tema janë të mbrehta e të thella. Si frat, në poezi ai predikon e mëson, rrëfen e vetërrëfëhet, pra bëhet subjekt e objekt kërkimi e vëzhgimi poetik. Në këtë aspekt, "Pllumi është autor etik, i shkollës dhe trashëgimisë etike shqiptare, i kulturës diskurseve françeskane, i dëshmisë dhe ndjeshmërisë personale"¹¹ - shkruan Kujtim Shala, studiues i veprës së tij.

Poezitë, shkruante T. S. Eliot, nuk janë shprehje e personalitetit, por një arratisje nga personaliteti. Frati poet, në terrin e burgut, te poezia gjen dritën e munguar, gjen lirinë e dhunuar, mënyrën e arratisjes në kohë e realitete tjera, herë shpirtërore e herë letrare. Dhe të shkruarit është një lloj detyre e një dritë hyjnore, një mënyrë për t'i shprehë shqetësimet e vëzhgimet për kohën e trazuar kur njeriu kishte humbë cilësitë e të qenit njeri.

Për më tepër, poeti te poezia gjen formën për të shprehë personalitetin e tij dhe njëkohësisht për t'u arratisë në nga ai, sikur kur tregon për ëndrrat, po ashtu kur shpreh gjendjen reale të tij, kur kthehet në kohë tjera, te Abeli, "një themel i mbuluem i paqes nrruzull..."¹²

Poezitë e Pllumit tregojnë botën e madhe të autorit ëndërrimtar i madh që lufton me tërë qenien, ndonëse "ndër prangat e randa kambë e duer i lidhun" për t'i ngritë një monument të madh të dashurisë. Kjo është dashuri sublimë, e veçantë, gati e pakrahueshme.

Kështu, poezia e tij e jep edhe një të dhënë ose më e përforcon: ai ishte i izoluar, në burg, por nuk i ka mungua lira shpirtërore dhe kjo e fundit e përshkon poezinë si një thirrje e përhershme në ndërgjegjen njerëzore, si një thirrje buçitëse për ndërgjegjësim e angazhim për vepra të mira.

Poeti lëshohet në krahët e imagjinatës dhe ëndërron një botë më të mirë. Me një fantazi të dëlirë, ai e rrëmben lexuesin në krahët e imagjinatës dhe e shpie në kohë e realitete tjera dhe përherë i dëfton kohën e tij, kohën e përhershme në të cilën duhet bërë luftëtar për t'i ndërtuar një monument dashurisë dhe për të rrëzuar kultin e dhunës.

Tipar themelor i poezisë së Pllumit është poezia e mendimit; domethënia e tekstit poetik është e drejtpërdrejt. Poeti nuk fshihet prapa kodeve e rrëfimeve abstrakte poetike, mendimin e lejon të rrjedhë lirisht në magjinë e fjalës dhe e bën të dukshëm e të qartë për lexuesin. Lexuesi e lexon kuptimin dhe qëllimin e autorit, sepse Pllumi në poezi - është shpalues i ideologjisë së tij ose më pëlqen të them, shkollës së tij për njeriun që rrënjët i ka te trashëgimia françeskane dhe ajo biblike. Dhe Pllumi e realizon atë që thotë shkrimtari i ditur Jorge Luis Borges, - na bën të besojmë te autori i shkrimit dhe lexuesi e ndjen se emocionet e tij janë të vërteta. Sepse, "shkrimtari punon si metafora. Metaforave s'ka nevojë t'u besojmë. Kryesorja është që ne të mendojmë se ato i përkasin-korrespondojnë me emocionet e shkrimtarit. Them lirisht se kjo është e mjaftueshme."¹³

Dhe kjo lidhet më së shumti me poezinë e thjeshtë dhe elaburuese

Shumica e poezive të Pllumit janë të thjeshta dhe elaburuese, me vargje qarta, ku ndihet gjallëria e poetit që shpreh emocione, tregon dëshirat dhe fantazon. Te poezia "Lufta ime" autori i rrëfëhet lexuesit, i tregon se për çfarë lufte e ka fjalën. Ajo luftë nuk është me armë e ushtri, me mbretër e perandori, por një luftë që vazhdon përherë për arsye, mirësi, liri, paqe e dashuri dhe kjo luftë zhvillohet në zemrën e njeriut.

Kurse te poezia "Liria" poeti jep një konstatim dridhmues:

"Kurr s'e kam njoftun
At trup aqë t'largët e të ndritun qiellor.
Ajo: Liria,
me një trup vezullues, shkëlqimtar,
dhe un fikaraja
gjithmonë një kërkues andrrimtar
që t'ishem me te për jetë bashkshortor."¹⁴

Pra, shohim qartë, raporti i poetit me lirinë fizike është i trishtë, ndoshta një utopi, por si kërkues e krijues, ai ka një raport tjetër me ëndrrën për liri e me lirinë e brendshme. Ai rend pas saj, i kërkon mikut, lexuesit, që të luftojë përherë për këtë të drejtë njerëzore. Dhe vargjet e fundit të vjershës janë dramatike:

Ani, le t'digjem tym dhe flakë,
Por t'bahem pishtar i kësaj bote plakë,
Le t'bahem feniks i vërtetë
Që digjet e digjet
Por n'hinin e vet ai ngjallet për jetë.
Ani, le të digjem për të drejtat njerëzore
Por t'jem një dëshmor pa përmendore:
luftar i përhershëm
kundra çdo tiranije mizore."¹⁵

Pra, Pllumi në esencë është shkrimtar me një talent të spikatur, poet e prozator që zotëron aftësi të jashtëzakonshme të shkruarit, ku pasqyrohet formimi i mbarsur në kulturën biblike, filozofi dhe histori të artit.

III

Vepra e Zef Pllumit - ajo e memoareve dhe reflektimeve - si dhe kjo e poezisë, e fton lexuesin të reflektojë për çdo detaj së tij.

Si frat i ditur e shkrimtar mendjehollë, në biseda të shumta me gazetarët shqiptarë, Pllumi me devocion flet për kulturën shqiptare dhe i blatohet dashurisë për atdheun. Në një bisedë që zhvillon me gazetarin Ilirian Agollin teksa flet për Gjergj Fishtën, ndër të tjera thotë:

"Në shekullin e kaluem (XIX) Zoti i ka pasë falë dhanti Shqipnisë një grup kësi njerëzish: ata që ne sot i quajmë "rilindas". Ishin të gjithë njerëz të mëdha, të cilët rrallë i kishte edhe Europa. Në daç për kulturë, në daç për nga mendja e tynë e zgjuet dhe aftësia e tynë e veprimt. Unë besoj se kulmi i gjithë këtyne njerëzve arriti me Fishtën."¹⁶

Në vazhden e këtyre idealeve, Pllumi pasi shumë vjetëve në burg e rifillon revistën "Hylli i Dritës", si zgjatim i idealit

¹⁴ At Zef Pllumi, *Poezi*, fq. 49.

¹⁵ At Zef Pllumi, *Poezi*, fq. 51.

¹⁶ *Kështu foli At Zef Pllumi me gazetarët*, fq. 63

kulturor e estetik të lavdisë së dikurshme. Kjo domethënë se ai vazhdimësinë e lidh me të kaluarën. Ai pohan se kjo revistë që lindi në ag të qytetërimit është ma e vjetra revistë e kulturës shqiptare, themeluar nga Fishta dhe ka shërbyer si "busulla në të cilën shënohet vetëm një drejtim: Europë."

Këtij ideali Pllumi s'iu shqit asnjëherë dhe për të foli e shkroi deri kur kaloi në amshim.

Pra, Pllumi, jetoi e punoi me bindjen e palëkundur se "për mue, për ne klerin e vjetër, ky popull bahet popull vetëm me anë të kulturës, nuk bahet me punë tjera"¹⁷ dhe këto ide e mësimi i ktheu në vepër, në memoare, dukë folë me gazetarë, në prozë e në poezi.

Raporti i françeskaneve shqiptarë me artin e kulturën ishte një raport që kishte gati trajtë devocioni. Me një gjuhë gati religjioze, françekanët iu përkushtuan e blatuan artin e kulturës, duke besuar se ajo ishte forca më goditëse që ndihmonte transformimet pozitive e përparimet shpirtërore e shoqërore.

Dhe ky devocion i lartë bëri që përbrenda atij oborri kulturor të krijoheshin vepra e kryevepra letrare, të shkruara me dashuri e kujdes të jashtëzakonshëm për gjuhën e artin shqiptar.

Dhe Pllumi - përfaqësues i rëndësishëm i kësaj shkolle, ndonëse i burgosur, kurrë s'e bjerri lirinë shpirtërore e as nuk lejoi të pushtohej prej urrejtjes, dhe, siç dëfton në rrëfimet e tij - ai në burg e nën pranga, mbeti mendimtar i lirë, duke besuar te madhështia e lirisë së ndërgjegjes, besimit e artit, të cilat vlera e virtyte, kur ngjizen në një zemër, nuk ka forcë që mund t'i largojë.

Dhe poezia e Pllumit, ashtu sikurse vetë jeta e tij e provojnë një të vërtetë të tillë. Poezia e tij, e ndihmon lexuesin të besojë se arti e letërsia mund të hapin gjithmonë horizonte të reja, për një botë më humane, më të drejtë dhe më të bukur.

LITERATURA:

At Zef Pllumi, *Poezi*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2020.

At Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, Botimet Françeskane, 2015.

Kështu foli At Zef Pllumi me gazetarët, Onufri, 2008.

Kujtim Shala, *Parathënie*, në At Zef Pllumi, *Poezi*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2020.

Ndue Ukaj, *At Zef Pllumi: mendimtar i lirë dhe Shqipëria e burgosur*, në *Hylli i Dritës*, Nr. II, 2017.

Ndue Ukaj, *Introduction NYC from inside*, Collected and edited by George Wallace. Blue Light Press, San Francisco, 2022.

Jorge Luis Borges, *Kjo mjeshteri e poezisë*, Përktheu nga anglishtja Arsim Canolli, Coneus, 2008.

C G Jung, *Litteratur, myter och symboler*, Nature och kultur, Stockholm, 1976.

A interview with Czeslaw Milosz, <https://www.nybooks.com/articles/1986/02/27/an-interview-with-czeslaw-milosz/>

¹⁷ Po aty, fq. 148

(Vijon nga faqja 9)

antropologjike e poemës, si dhe merita e Shehretit, qëndron, pikërisht, se të dy moralet janë mishëruar me vërtetësi arti.

QENDRA E POEMËS, QENDRA E VEPRIMEVE HISTORIKE

Alipashaida ka një shtrirje hapësinore gjeografike tepër të madhe, prej Janinës e Tepelenës, Çamërisë e Beratit, Ohrit, Labërisë e Zagorisë, Gjirokastrës, Vlorës, Delvinës, në atë që quhej Rumeli, dhe në tërë Ballkanin, deri në Stamboll, Beograd e Danub. Qendra hapësinore e poemës nuk është Tepelena, vendlindja e Aliut, as Janina, kryeqendra e Pashallëkut, ku ishin dhe sarajet e tij, por Çamëria me Sulin, Artën e Prevezën, Pargën e Filatin. Arsyja e kësaj qëndrëndosjeje ka qenë rëndësia e Çamërisë dhe roli i çamëve në zvogëlimin, ose, zgjerimin e Pashallëkut dhe daljen në det, e jo qëllimi i tij poetik. Në dhjetra e dhjetra faqe dhe në mijëra vargje ngjarjet e betejat zhvillohen në Çamëri, me rolin e figurave të historisë së saj. Nuk ka libër tjetër letrar e historik, që na sjell parasysh Çamërinë dhe çamët të gjallë e në veprim, me tiparet dhe bëmat karakteristike dalluese. Ka figura historike popullore më shumë se prej çdo krahine tjetër: Plaku Pronjo, Hasan Çapari, Mahmut Dajlani, Islam Pronjo, Abdyl Çami, Foto Xhavela, Kiço Boçari, prifti Jani/Papajani, prijës fisesh, familjesh e zonash. Përkruhet harta gjeografike e jetësore e Çamërisë, me fshatara e qytete, herë-herë me relievin natyror, veprimet dhe betejat e zhvilluara, emërvende ngjarjesh: Suli/Kakosuli, emrat e fshatrave në rrëpirat e Sulit, kështjella në to, kisha, ku i luten Shën Mërisë, Preveza, Parga, Filati, Konispoli, Vagalati.

Poemë epike, histori e vargëzuar, roman historik në vargje?

Poema i është kushtuar portretit të prijësit sundimtar Ali Pasha Tepelenës dhe bëmave të tij luftarake, lindja, rritja, vitet e betejave me fitore dhe disa humbje. Ngjarjet, betejat, veprimet e bëmat janë të njëmendëta, krahasuar edhe me faktet historike. Shëmbëlltërat letrare vepruese, që janë disa dhjetra, janë figura historike. Rrëfimi i ngjarjeve, përshkrimi i lëvizjeve të shëmbëlltëtrave njerëzore, i rrethanave dhe i mjedisit shoqëror e natyror, shoqërohet shpesh me portretizimin psiko-mendor e moral të shëmbëlltëtrave njerëzore nëpërmjet të folurës, shprehjeve dalluese. Edhe Shehreti, që ishte mik e këshilltar i afërt i Aliut, që e ka ndjekur në beteja e kuvendime, nuk mund të riprodhonte besnikërisht gjithçka nga ato, që shqiptonte pashai i tij. Edhe psikologu po të ishte i pranishëm, nuk mund të zbulonte mëdyshjet e tij, zhbirimet psikologjike, që u bënte miqve dhe kundërshtarëve, sikurse i këndon Shehreti. Portretet dhe analizat psikologjike e morale të figurës së Aliut, si dhe të shëmbëlltëtrave të tjera letrare janë krijime të Shehretit. Psikologjia, mendësitë, botëkuptimet, qëllimet, mënyrat e të folurit, që janë të botës së brendshme njerëzore, janë krijim poetik, prandaj, *Alipashaida*, ka doza të mjaftueshme poezie të mirëfilltë për të qenë poemë, pavarësisht përbërësve të vargëzimit të historisë, apo, të karakterit rapsodik.

Objekti i këndimit, konkretisht, bëmat e një figure qëndrore, dhe të një vargu figurash të tjera, në bashkëvajtje mes tyre, gjithashtu, dhe përmasat e gjera e të shtrira në shumë vite, ngjarje e mjedise, i japin edhe cilësitë e poemës epike. Për të njëjtat cilësi, vizatimin e figurave historike përmes ngjarjeve e bëmave të njëmendta, në kohë dhe hapësirështrirje të madhe, ka edhe tipare të romanit historik të betejave, të atij lloji, që, në letërsinë shqipe jo rastësisht do të shfaqej si lloji i parë i romanit shqiptar, një shekull më vonë, në fillimet e shekullit XX, me romanet e Ndoc Nikajt.

Tiranë, mars 2024



¹¹ Kujtim Shala, *Parathënie* në At Zef Pllumi, *Poezi*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2020, fq. 33.

¹² Zef Pllumi, *Poezi*, fq. 126.

¹³ Jorge Luis Borges, *Kjo mjeshteri e poezisë*, Coneus, 2008. Përktheu nga anglishtja Arsim Canolli, fq. 94.

Qysh në fillës të tekstit të saj, kur nënvizon se: Leka nuk është krijuesi i kanunit e se emërtimi vjen si influencë e fortë e princit në Lekët (krahinë në Malësinë e Madhe), autorja e librit “Doke dhe tradita- një histori e shkurtër e gjakmarrjes ndër kanunet shqiptare”, dr. Gelanda Shkurta na bën me dije një konstatim serioz për ta orientuar lexuesin e dëshiruar drejt kuptimit të saktë të thelbit të tij.

Kanuni, i Lek Dukagjinit është përmbledhja e normave zakonore, që ka rregulluar jetën e jetesën e popullit të maleve atje ku ka funksionuar. Me siguri, normat zakonore kanë ekzistuar edhe përpara se “princi i përfolur” Lekë Dukagjini [perifrazim sipas titullit të monografisë së T. Ç.] të kishte arrit në atë stad të emrit të tij sa ti mveshje atij Kanuni i një krahine të të gjërë e të rëndësishme dhe administrimit të jetesës së banorëve arbër të atyre trojeve. Kurse etnografi e antropologu At Shtjefen Gjeçovi e përjetësoi si një vepër konstituive, me kodifikimin që i bëri. I botuar, pastaj në vitin 1933, 4 vjet mbasi ai kishte ndërruar jetë, nga bashkëvëllezërit e provincës françeskane shqiptare, nën përkujdesjen e mikut të afërt fort, Poetit Kombëtar Gjergj Fishta, ka përshtuar rrugën e diskutit publik me kuptime e moskuptime, a me keqkuptime e me anatema gjithashtu, çka e ka thirrë kurdoherë në nevojë hulumtimin e interpretimin e tij. Sidomos përreth dilemës: **kanuni-normë zakonore apo normë ligjore. Apo të dyja bashkë.** Dhe këtu futemi në thelbin e trajtesës që autorja Shkurta e ka si lajtmotivin e veprës së saj. Ndryshe prej studiuesve e hulumtuesve pararendës, të cilët qëndruan në rrafshin e sipërm, konstatues e pohues pa hyrë në interpretime të normave e nyjeve të Kanunit. Edhe vëzhgues seriozë të antropologjisë së shqiptarëve si Franc Nopça, Edith Durham, Giuseppe Valentini apo Ernesto Cozzi nuk u ndalën në interpretime juridike të nyjeve të Kanunit. Ata mblodhën të dhëna, i publikuan e i lanë ndër libra si dëshmitë studimore më të besueshme antropologjike, po nuk i interpretuan juridikisht ato. Ndërsa autorja Shkurta, shfaqet mjaft e interesuar në njohjen e thellë të këtyre normave të kanunit të Lekë Dukagjinit, në radhë të parë, po edhe të 6 kanuneve të tjera më pak, si ai i Skënderbeut, Pukës, Dibrës, Lumës, Bendës (Malësisë së Tiranës) dhe i Labërisë pak më tepër. Tek ky i fundit sidomos, ajo kërkon të gjejë modelin e qasjes në sipërmarrjen e vet studimore tek studiuesi i shquar, prof. Ismet Elezi, i cili, siç shprehet autorja: “jep një panoramë të përgjithëshme në lidhje me të drejtën penale të shqiptarëve, duke e vendosur Kanunin në dimensionin e një korpusi normash, të cilat kanë vlerë nga konteksti i një të drejte pozitive...si një grup normash juridike që kanë përbërë në njëfarë mënyre kushtetutën dhe përmbledhjen e të gjitha kodeve të malësorëve. Dhe qasja është interpretimi jo vetëm doksor, antropologjik, po, për më tepër juridik, çka i shkon më për shtat edhe formimit parësor të Dr. Shkurtajt dhe këtu ajo vendos piketat e studimit të saj. Autorja përdor konceptin e legjislatorit (popullit) për kanunin. E kjo është edhe risia e plotpërputhëshme me këndvështrimin që ajo zgjedh për trajtimin e çështjeve që parashtron. Gjithnjë në kërkim të zgjidhjes së dilemës, **normë zakonore apo normë ligjore**, duke iu referuar për këtë edhe prurjeve më të spikatura të teorive e shkollave europiane të antropologjisë e sociologjisë me përfaqësues si Max Ëeber apo Émile Durkheim e të tjerë.

Në këtë rrafsh logjik e shkencor ajo operon duke sjellë gjithnjë krahasime me korpuset ligjore e kushtetuese të vendeve të zhvilluara. Njëri nga shembujt e shumtë krahasues, është ai i shpikjes e përdorimit të gjiotinës në Francën e fundshekullit 18, për ekzekutimin e dënimit me vdekje. Ajo erdhi si shpikje mbasi forcat kundërshtuese shfaqën ankesën se me vdekjen e menjëherëshme, që aplikohet deri atëherë, i dënuari nuk e vuante meritueshëm atë që duhej të vuante për krimin që kishte bërë. Dhe kështu u shpik makina ekzekutuese e vrasjes - gjiotina që të dënuarit ia sillte vdekjen disi më të ngadaltë e për pasojë vuajtjen më të madhe. Kurse në Kanun një formë dënimi e gjakmarrjes, është **ngujimi**. Një formë krejt e ndryshme por mjaft e përvuajtshme.

Sikundërse një veçori përbën respekti për kufomën e vrasës për këtë shkak (gjakmarrjes). Pas vrasjes, kufomën duhet ta kthesh me fytyrë nga qielli dhe në rast se dorasi (vrasësi) nuk e bën këtë për rrethana të rastit, të parit njeri, që takon në rrugë ia kërkon këtë gjë, si detyrim i tij, pra i vrasësit, në respekt të kufomës. Një rregull ky i pandeshur në raste e vende të tjera. Që bashkë me të tjerë rregulla të korpusit të gjakmarrjes synojnë pezullimin e parandalimin e fenomenit e jo cjtjen e përsëritjen e pandalesë të tij. Ose si “**rregullator i shoqërisë fisnore**”, siç e konsideron Max Ëeber, i cituar në këtë libër.

Shënime rreth librit “Doke dhe tradita- një histori e shkurtër e gjakmarrjes ndër Kanunet Shqiptare” të dr. Gelanda Shkurtajt

PËRTEJ KEQNJOHJES E KEQKUPITIMIT TË KANUNIT

Nga Frano Kulli

Ndërmjet kuptimit dhe keqkuptimit (termi i huazuar nga titulli i librit të Nd. Dedajt) rëndësinë më të madhe përgjatë kohëve e ka pasë zënë dhe e zë roli i gruas, sidomos në trajtesën e fenomenit të gjakmarrjes. Pikëndalesë ngërç është **Nyja njëzet e nandë** e cila titullohet “Grueja asht **shakull** per me bajtë” dhe teksti i nyjës vijon: “Grueja njëzet si **calikë** per me bajtë sa të jetë në derë të burrit, se prindja s’hjekin dore prej sojet, e ndalin per vedi e mbi vedi të përgjegjmen per té, por edhe me lypë arsye, me ba me e gjetë gjá”

Në libër ajo merret në mbrojtje duke e kundërshtuar qëndrimin abuziv që i është bërë e i bëhet ende sot si reminiscencë e së shkuarës, (sidomos në kohën revolucionare të luftës kundër zakoneve prapanike e paragjytimeve fetare) trajtimin të gruas nga kanuni si një qenie pak mbi shtazën, se ajo nuk vлека më shumë, përveç se me bajtë. Ose, interpretimi edhe në kohët e reja e ende sot, si një mall në duart e mashkullit. Dhe këtu zë fill edhe kumti që autorja e ndesh si “shuplakë” diku në zyrat policore të Italisë europiane, kur shërbente si konsulente ligjore në ato zyra: “**vajzat shqiptare na kanë thënë se shfrytëzimi i tyre në rrugët e Italisë bëhet, pasi, sipas Kanunit tuaj, femra është një mall në duart e mashkullit dhe ai mund të bëjë çfarë të dojë me të, ta shesë, ta blejë dhe ta vërë edhe si një mall në rrugë...**” Dhe ky kumt, sa i pavërtetë aq edhe poshtnues, nuk ka mbërritje vetvetëshme atje. Atje e këtu e kemi përcjellë vetë ne shqiptarët, me keqkuptimin e madh e të paprerë që kemi shfaq e shfaqim për kanunin.

Shpesh, në mënyrë banale është barazuar **bajta** me **mbartjen** e një barre dru në mal a një barre dushk për bagëtitë. Pa njohur aspak jo kuptimin e figurshëm, jo e jo, po as kuptimin e drejtpërdrejt të fjalëve të përdorurë në këtë **nye** të Kanunit. Unë besoj se keqkuptimi i paragjykuar zë fill të mos njohja e kuptimit të këtyre dy fjalëve-emra sinonim: **shakull**, që në fjalorët e shqipes shpjegohet-lëkurë sqapi a dhie e punuar si thes, për të vënë brenda bulmet (djathë, gjalpë, gjizë) dhe **calikë**-kacek, rrëshek, rrëshiq, lëkurë dhie që përdoret për të mbajtur vaj, verë,



gjalpë. Madje, e gjejmë të shpjeguar edhe në “Fjalorin e “Bashkimit”- (Fialuer i rii i Sheyapes- Perbâam prei Shochniët t’ Bashhkimit, 1908).

Siç shihet, edhe në kuptimin e parë emrat e përdorur në këtë nyje të kanunit, janë mjete që mbartin gjallësi, mbartin ushqimet bazë që mbarështojnë jetën e vijimësinë e saj. Pra, grueja, në derë të burrit është “shakulli” a “caliku” që mbart jetën (fëmijën), ripërtëritjen e saj e ndaj për këtë ajo është e paprekëshme prej gjakmarrjes. “**Me e gjetë gjá gruen, per faj të burrit, prindja e kësaj lypin arsye me kanun**”, dhe duke nënvizuar këtë nye nga Kanuni, dr. Shkurta, argumenton se: *Fakti i dhënies llogari përpara familjes së gruas, parashikuar në kanun, edhe në rastin e mardhënies adultere* (kurorëprishjes apo tradhëtisë bashkëshortore), *që gjithsesi konsiderohej një turp i madh është tregues i interesit dhe rolit që ajo kishte në shoqëri*. Pra “Grueja s’bjen në gjak” - “Grueja l’shon në gjak prinden”, na fton të kuptojmë përkrahshmerinë e gruas. E në saje të kësaj përkrahshmerie gati hyjnore, në rastin e gjakmarrjes, kur burrit i duhej me u ngujue, pra mos me mujtë me dalë jashtë shtëpie, atëherë gruas i binte kjo barra e rëndë e **barrëve**, e e të bajtunës. Unë, mendoj se më shumë se shenjë inferioritetit është sanksion preventivues, parandalues i vrasjes së gruas; më shumë se nënçmim është vlerësim që ligjëron me të gjitha mënyrat doksore mbrojtjen e gruas, të femrës, në përgjithësi. Jemi në lëmin e vlerësimit të **gjakmarrjes jo si luftë, por si një mënyrë dhënie drejtësie**, siç e çmon antropologu Nebi Bardhoshi i sjellë shpesh si referencë në libër. Në këtë qasje, mendoj vijon edhe sanksionet që ka Kanuni në gjakmarrje kur në ndërmendje është grua.

Libri shtjellon, shpesh deri edhe në imtësi, elemente të Kanunit të Lek Dukagjinit, duke rrokur edhe plot trajtesa të të tjera fushave që janë objekt i tij, gjithnjë me ndalesë preferenciale te qasja juridike e nyjeve të tij, e ballafaqimi me të drejtën shtetnore ose “ecja në dy binarë paralelë” me të. Ballafaqjet (krahasimet) merren që nga koha e Turqisë apo më vonë me *vendetta*-n [hakmarrjen, gjakmarrjen] italiane dhe deduksionet që përftohen lënë gjurmë besimplote në shijen e lexuesit për rrokje e trajtimin me mjaft kompetencë të korpusit delikat të dokeve e traditave tona....

Theks e vëmendje në libër merr gjithashtu edhe ecuria vetëreformuese e tij. Si p.sh momenti që cilësohet edhe këtu se: në kanunin e vjetër, gjakmarrja mbyllet me vrasjen e dorasit “*gjaku për gisht*”, shënohet në Kanun dhe jo sikurse del më pas në variantin më të ri që çështja mbetet e pambyllur, se bishton në derivate të tjera. Imzot Ernesto Cozzi e ka një shpjegim për këtë ndryshim: “Dispozitat e herëshme të kanunit të maleve, *shkruan ai në “Studime etnologjike të Shqipërisë së epërme*” janë të ndikueme prej fesë e prej të përpjekimit me qytetin shumë ma tepër në Malësinë e Madhe se sa në të Voglen, [Dukagjini, Pulti, Shoshi; Shllaku] ku kanuni e rrejti me lehtësi formen e vet të herëshme, ndonëse edhe këtu paraqet shumë motërzime, që kanë ardhë me kalimin e kohës.” Ndaj edhe në ndihmë të tij (kanunit) vijon edhe forma e mënyra të tjera, të mbinatyreshme si *Beja*, p.sh një institut juridik, siç e konsideron autorja që gjindet në të shtatë kanunet. Ose *shkuesia* e *dorzanía* një tjetër institut juridik i gjakmarrjes (nye 134 e 136 i Kanunit të L.D), të cilat erdhën në nevojë atëherë kur mbyllja e gjakmarrjes e tejkaloj vrasjen e dorasit.

Në përfundim të këtyre radhëve po ritheksoj se libri është, sa një kontribut serioz në ndërmendjen e Kanunit të Lekë Dukagjinit, po aq edhe një ftesë e hapur për albanologë e juristë për t’u thelluar në të ardhmen në një aset kaq të çmuar të trashëgimisë sonë.

MOS E HARRO DIELLIN ÇAMAROK ...

... udhëtar, që vjen nga dhera të largët,
si e ngatërrove udhën?

Këtu është po i njëjti diell çamarrok
që rrokulliset prej Nemërçkës,
dhe ia bën me sy malit të Gjerë,
duke i larë me dritë mëkatet e natës.

A nuk dëgjon zhurmën e rrotave të qerres,
që shpie ëndrrat shekullore dhe pendimet
të ruhen në kështjellë?

Është po e njëjta luginë e Drinos, kur në prill
vijne lejkë shtegëtarë, që çiftëzohen
dhe u japin fshehtas letrat e dashnorëve,
murgeshave në Manastirin e Ravenës.

Zotat ende bredhin me sandale në zaje lumi,
ku merr frymë nga tundimet e pasosura,
kori i dëshirave dinake dhe ngasjet.

Cilës ditë udhëtar ia paske ngulur sytë,
e pret të të thotë: ta tregoj pas vdekjes!

Fundi i luginës ti e di,
të shpie në anën tjetër të detit,
ndaj ti mos harro diellin çamarrok
që rrokulliset prej Nemërçkës ...

PRILL

As e kishe menduar se prilli
do të futej në damaret e tu
me qumeshtin e gjelber,
si bisku i pemës kur çan lëvoren.

Retë e zeza me nxitim po largohen,
nga hijet e kaltra të maleve,
era e fortë vjen nga kodrinat,
dhe i përze tutje,
për ta derdhur rrebeshin diku tjetër.

Ikin retë e zeza e sikur bëjnë lutje virgjëreshash,
plot vajtime të trazuara me shpresa,
qe prilli të vijë i plotë tek ty!

Derisa trupi të të bëhet harpë e melodi ...

GJËRAT E VOGLA, TË THELBIT

Më pëlqen e kuqërremta e gjetheve nëpër pemë,
Po limfa e njëlmët që ushqen, më pëlqen më tepër.
Dallgët kur shkërmoqen mbi brigje e shkëmbenj
më pëlqen më shumë gjeratore - fuqia e erës.

Më shtang ortek - llahtaria që gremiset thep më thep,
Kur rrafshon guva, pyje, me shpejtësi të vetëtimtë.
E bardha mister që këput e shkatërron si presë,
Topthin nistor të dëborës, e qortoj pafundësisht.

Sa i dua përrënjtë që kërcejnë shkrep mbi shkrep si
sorkadhet!
Dhe futen prehërit të lumenjve në rrymën e thellë.
Shndërrohen pastaj në kuaj të hazdisur për dete - oqeanet.
Ndërsa unë rikthehem të dua burimin e heshtur, sekret.

Më djeg kureshtia tek provë e shkretimit, kuqalashë si
gaca.
Dëshmues jam tek e vërteta e rrezikshme, si zjarri.
Krim e ndëshkim, ligësinë e përvëlloftë pa mëshirë flaka,
Sa i dua shkëndijëzat e fërkimit nga dy copëza stralli.

I dua gjërat e thelbit, ato të voglat, hakngrëna.
Sa shumë ... në emër të historive të pathëna ...

ZOGJTË KAGARO MBI OQEAN

poezi

nga Odise Kote

**VAJZA PRET NJË DJALË NË BREG ...**

Në mbarim të muzgjeve dhe agimeve,
një anije në mes të detit fanitur.
Eh, eh, e...e, po ku ka mbërritur?

Sirenat që vijne çdo herë prej larg,
veshur me tinguj të butë harrese,
sjellin vetëdijen të mbytur në thellësi.

Sikur pritja të mos qe kaq e gjatë,
të kishte të paktën një cak, dhe ...
të ndrej gjithë ai mallkim e shpagë,
oii, oii.

Ç'është në horizont ai pelikan vetmitar,
metaforë apo lajmëtar?

Dallgët shkalafyten baticë - zbaticë,
shpresë vdekur, ikje - moskthim ...
eh, e...ehu, dallgë që thërmon shkëmbinj.
Oii, oii.
Në mbarim të agimeve e muzgjeve ...

E KUQE OKËR ...

Kush je ti?
Një jetim.

Mos u frikëso!

The, të ka dërguar e gjora nëna jote?
Ke nevojë të prekësh diçka të ngrohtë,
ndoshta përbërjen e kadifenjtë
nga lëkura e vajzës së re.

Drita ia depërton lëkurën,
E verdhë - kanarinë,
E kuqe - okër.
Strukturën nuk e bëjnë konturet,
por ngjyrat.

Ti qënke piktor?
profesion që me duart e tua bën diçka
dhe njeriut i mbetet në kujtesë?

Nuk e spjegon asnjëherë,
e ndjen pluskuese, gjallëruese, të çiltër,
se dhimbja kalon dhe bukuria mbetet!

Nga diku, midis pemëve të kedrit dhe lisave,
midis kërkundit e lamtumirës,
mos ishte zëri yt?

Është e lehtë të vdesësh,
zakonisht vdekja vjen në kohë.

Po gjinjtë e saj bënë të gjunjëzoheshë,
të rrumbullakët e të fortë,
tërbimin që të rridhte në deje,
ajo e qetësoi ...

E verdhë - kanarinë,
e kuqe - okër ...

DRITA E FJALËS ...

Kur askund të mos më shohin, të mos jem,
poezia ime do të jetë,
ajo drita e ndezur në farin anës detit.

E gjuajtur me gurë,
tradhëtuar, keqkuptuar,
ama mike marinarësh,
peng i të vdekurit.

Udhëtarët që erdhën kësaj ane të botës,
të gjithë të rinj,
ngjarje të trazuara dallgësh,
baticë - zbaticë
shënjuan në kujtesë.

Le t'ia heqin kabanës gjuhën,
t'i presin krahët fjalës,
Atje ku ka frymë,
ka edhe një shpresë.

Dritën nuk e shuan dot,
me sirenë lamtumire,
barka të mbytura,
as forma e zbrazur e bregut
lindje - vdekje.
Fillestare në agim,
zhgënjyer në perëndim.
Thelb historie,
ku mbin fara e një tjetre ...

Kur askund të mos më shohin,
e të mos jem,,
poezia ime do të jetë!,
fe ekzistence.

Dritë e ndezur, mënyrë se si
mban në heshtje
atë shkëlqim ...
që paralajmëron se kam mbjellë stuhitë ...

ZOGJTË KAGARO MBI OQEAN ...

Këndojnë zogjtë Kagaro mbi oqean,
qiell' i natës vajtimin dërgon larg,
brigjeve matanë.

Paqësori sonte qenka llahtaruar.
Egërshan, zemërak, dallgë,
gjëmon kabanë,
sikur diçka të pistë, të vjetër
po e mbyt natës ngadalë.

Këndojnë a ngashërehen
zogjtë Kagaro mbi oqean?

Ngashërehen zogjtë Kagaro
mbi oqean,
drit' e parë e agut kontinental
nxjerr kryet fshikëzës së çarë...

Zogjtë Kagaro mbi oqean ...

PROMETEU IM

U trand muri
Që e ngrita me shpirt ndër dhëmbë,
Me ferra nëpër këmbë,
Me mund pa fund;
E ngrita çdo çast atë mur,
Mur i durimit,
Prometeu im!

U trand dhe sot
E, një gur u pik prej majës së tij;
Me rropamë ra
Në fund të qenies sime.

Prej andej, prej së thelli, K
thjelltas jehona më ngushëllon:
"Mjaft e ngrite atë mur, or burrë!
Gjithçka e ka një cak."
I gjegjem jehonës:
"Furça nuk paska caqe
Të lyen e përlyen,
Të sajdis me shumë faqe
Me bojëra çdofarëshe..."

Lart e ngrita atë mur,
Ballë heshtave të cmirës,
Honeve të shpirtit të lig,
Humnerave të fatit,
Ballë dimrit të stepave.

Tani nuk mundem ma të vendos edhe një gur,
As flashkëza, as harlikë
Le të mbetet gjithmonë kështu
Duke ju lutur:
Mos e sulmoni më Se do shembet,
Por, poshtë do t'ju zerë Ju!"

PLAGA

Kulloi pa prà
Plagë e Lisit të Gjakut
Hapur prej dimrit
Kontinental...

Rrëkaja u ba lumë
E rrodhi i zi
Drejt lumit të bardhë...

Nga gjoksi i Fisit Doli një ofshamë
E, Pikëllima u ba mal!...

Oi, Oi!...

FATI IM

Të kërkova në diell;
Ti, nën do rreze të rreme,
Dridheshe,
Si gjethja e shullanit në erë.

Desha të sajoj për ty një ombrellë
(Pa pyetur për çmimin e saj.)
Por shiu të kalbte gjer thellë
Dhe kolliteshe pa shpresë
E qaje pa faj.

Trimërova.
Kërkova erë tropiku.
Përtonte.
Harrohej në shkëmbenjtë
E ngrirë të pritjes.
Mëkatet përgjumur vareshin

**KRISTALET
E THYERA**

Nga Viktor Gjokolaj

Nëpër degë dafinash...

Në udhëkryqe provinciale u lage
Dhe u tere në ikje-kthim,
Një poçe dheu e pjekur në shi
Ti,
Fati im.

POÇETHYER

Verën e pinë orgjive
Ata që vozën e bajtën
Përplot
Me rrena e bujë...

Unë,
Mbi sup vozën me verë,
Por buza m'u tha Për një lot ujë...

Fati im - nyje
Unë - një poçethyer...

NËN QIELLIN E ZYMTË TË FATIT

E shoh lëndinën e kositun
Nga kostarë të çartun e katilë,
Do kuaj të vjetër, të braktisun,
Që dhëmbërënë, më kot kërkojnë jeshil.

Me brengën e vjetër në supet e brishtë,
Vetmitar eci lëndinës luletharë;
Në buzë më vjen një melos i trishtë,
Që kam vërshëllyer vite më parë.

I ri kur kam qenë, e prapë sot,
Brenga pa mëshirë më ban të vuaj,
Si kjo lëndinë, dikur hireplotë
Që po shkrumbohet për një curril uji...

Kërkoj një dorë të hedh një hendek,
Ta braktis relievin pa bar e lule,
Sikletin ta flak në tjetër breg,
T'ia shkul rrëmbyeshëm këmbët një ure...

Ajo urë nuk u hodh për njerëzit,
Ajo ishte pjellë e Qoftëlargut,
Që t'i nxirrnim sytë njëri-tjetrit,
Nën qiellin e zymtë të fatit...

FUND VJESHTE NË LËKUNDË

Një fllad i letë
Lëkund një fletë:
Nga kumbulla piket e bie
Në tub të kazanit

Dhe pikon vjeshtë...

Dikush me gotë, të tjerë me filxhan
I mbushin e i kthejnë hareshëm
Me turshi, djathë e ndonjë hudhër,
Derisa hana vjen, e ulet mbi kumbull...
Fundstina derdh dyll mbi pjergull;
Faqeskuqur fshatarët e mi
Natën vjeshtore e mbajnë ndezur
Me hoka e gota plot me mirësi...

PODRIMJES

O atë i Lum Lumit,
O kangë e gjakut që nuk falet!
Lumi i fatit papritun u ndal...
Vargjet e kangës,
Me qiellin e dhimbjes,
Stoikë e madhështorë,
Si vargmalet.
Dhe lumi ecën vrulltas,
Nuk mundet të ndalet...

22 korrik 2012

QËNDRESA E FAJIT

Dhe zjarri ra në kullën me myshk,
Gjuhët e flakës u grindën në erë -
U dogjën stolitë në sëndyq
Dhe krejt reliket me vlerë.

Në pìrgun e lartë me hi,
Ku gjithçka u kall me rrëmbim,
Kishte shpëtuar për çudi
Fleta ku shkruhej "faji im" ...

Maj 1998

SHIRA DHE YLBERE

Paradite shiu ra pa prà,
Konopin s'di sa herë ma lidhi në fyt,
Lumi më mbet pa va...
Varkë askund, askund...

Pasдите,
Mbi shkulma,
Ylberi nguli njërin skaj.
Pastaj,
Harkoi mbi shkrepë e pyje,
Mbi fate lidhur nyje
E te Shpella e Fatmirave
U thye...
(Bujtina ishte bosh,
Fatmirat nguteshin për t'u kthye.)

Nesër,
Paradite do të bjerë shi
E unë pres ylberin
Të shfaqet përsëri...

Në mëngjes u ngjitëm në mal me Gojonë e Tobar Tolibës. Pasdite e gjetëm grurin e breshkës, që rritet dendur në djerrinat e sipërme. Ajo bimë nuk rritet te ne, se tokat janë pjellore, të dysta dhe me lagështirë, ndaj u detyruam ta kërkonim aq larg.

– Kjo është? – i thashë Gojosë me habi dhe mora në duar njërin nga bimët.

– Kjo ore, kjo! – tha Gojoja qejfprishur. – Pse, si mendove ti se është?!

U zhgënjeva pak me thënë të drejtën, se prisja të qe ndonjë bimë me pamje më të bukur, ndërsa ajo që po më tregonte Gojoja, që një bimë e shkurtër, me hala të dendura, që po të mos dije gjë për të, nuk të ngjallte ndonjë interes. Ngjante me grurin, veçse qe shumë më e vogël.

– Edhe dëgjo, – tha Gojoja, – asnjë fjalë me njeri, asnjë fjalë po deshe ta kesh punën mirë me ata “të bekuarit”!

– Mirë, o mirë, – thashë, – po ma rrëfe marifetin si bëhet!

– Ja, – tha Gojoja, – kur të perëndojë dielli, do të marrësh një nga këto dhe do t'i zhveshësh halat, gjersa të mbeten tri në majë. Vetëm tri, more vesh!

– Po pse vetëm tri? – pyeta unë mosbesues.

– Ahuuuu, – i ra me dorë ballit Gojoja, – po di unë pse tri! Tri duhen edhe pikë! Edhe hap sytë! Po u trembe, të mori lumi!

– Nuk trembem, jo, – thashë i vendosur. Vonë, në të ngrysur, morëm udhën e kthimit, por ecnim shpejt.

– Sonte do ta provosh? – më pyeti Gojoja.

– S'e di a kam më kohë, – i thashë, – por nesër e sigurt që po, – dhe kontrollova me dorë xhepat që i kisha plot me grurë breshke.

Te gardhi i Dalip Sejkos u ndamë. Ai mori udhën drejt shtëpisë, ndërsa unë drejt sime. Kur hyra në oborr, nënën e gjeta duke qëruar ca fasule. Ajo sa më pa sikur u çlirua dhe më foli:

– Po nga humbe gjithë ditën, o bir?

Që pas vdekjes së babait, ajo merakosej shumë për mua. Dhe kërkonte të më kishte përherë para syve.

Nuk fola, se mendjen e kisha gjetiu. U futa në odën e vjetër të miqve dhe nxora njërin nga fijet e barit dhe nisa ta pastroj nga halat, ashtu siç më këshilloi Gojoja. Fillova nga fundi dhe i hiqja çiftet e halave një e nga një. I hiqja me kujdes, se bima qe e brishtë dhe këputej lehtë.

Kur më kishin mbetur vetëm pak për të hequr, kërcelli i bimës u këput.

Më erdhi inat, se më vajti gjithë munda kot. U nervozova. Pastaj mora një bimë tjetër, por u këput edhe ajo. Pastaj mora dhe një tjetër, por edhe ajo më iku kot. Pastaj edhe një tjetër, derisa kuptova se njëri xhep më qe zbrazur.

“E po kjo nuk qenka punë!” – thashë me vete. Fillova të dyshoj se ky marifet nuk do të funksiononte dhe ndaj qe sajuar nga njerëzit e fshatit tim, sepse qe e pamundur që grurin e breshkës ta pastroje nga halat pa e këputur kërcellin. Kur gati po hiqja dorë, m'u kujtua historia që më tregoi Gojoja për Delinën e Lytifi Baçit, që qe lodhur, por ia pati arritur që, përmes marifetit, të thërriste të emën e vdekur dhe t'i tregonte vuajtjet që hiqte nga njerka. As dy ditë nuk kishte zgjatur puna dhe njerken e pati vlarë rrufeja në krua. Ndërsa Delina kishte gjetur burrë e tani rronte si zonjë.

Kështu vrava mendjen dhe e gjeta zgjidhjen. Vajta mora një brisk dhe fillova ta zhvesh bimën nga halat me kujdes. Puna tani po më ecte më mirë dhe e bëra atë që më duhej. Duhet të gjeja veç një pasqyrë. Edhe atë e gjeta kollaj, se ia hoqa llambës së vajgurit. Ajo qe një pasqyrë e rëndë në formë rrethi, me kornizë. E vendosa fijen e grurit të breshkës nën jastëk, ndërsa pasqyrën e lashë pranë shtratit. Tani prisja të binte nata.

Gojoja ma kish thënë qartë, se i vdekuri nuk vinte në shtëpi pa më zënë gjumi. Këtë duhet ta kisha të qartë. Por pasi të më



TË VDEKURIT JETOJNË NË PASQYRË

Tregim nga Ervin Nezha

zinte, do të më vinte në ëndërr. Unë do të zgjohesha dhe do të thosha: “Po pate ardhur për të keq, ik ashtu siç erdhe, po pate ardhur për të mirë, rri për nga hera”.

Atë natë nuk fjeta dot. U përpoqa të fle, por gjumi nuk më zinte dhe kjo më bëri nervoz. U ngrita dhe po lëvizja nëpër shtëpi pa qëllim të qartë. Hapa derën e odës së gjumit ku flinte ime më. Ajo gërhiste lehtë në errësirë dhe unë u tërhoqa pas, se nuk doja të më ndiente. Pastaj m'u kujtua se ajo përherë trembej nga ëndrrat. Sidomos kur në to i shfaqeshin të afërm që kishin vdekur. Nuk i tregonte kurrë ato ëndrra. Por unë e kuptoja se kur kishte parë një ëndërr të tillë. Se mëngjesin e ditës tjetër ajo punonte shumë, ngaqë nga trembja nuk ndiente as lodhje madje ia kalonte tim atë, që nuk e kishte shokun si punëtor. Si duket, përmes punës donte të humbte mendjen nga ajo që kishte parë në ëndërr. Aq shumë punonte, sa përherë e detyronte tim atë të shpikte nga një justifikim për të mbajtur të gjallë krenarinë. Për shembull, kur qenë duke korrur misër dhe ky shikonte që gruaja e mbaronte rreshtin më shpejt se ai, thoshte se nuk i priste mirë drapri; kur punonin me bel, se pjesa e tij kishte krisje që duheshin shkullur me duar, rrënjë më rrënjë.

Nëna nuk thoshte asgjë, vetëm miratonte në heshtje, se ajo nuk donte të matej me tim atë, por thjesht të harronte ëndrrën. Njëherë kur i thashë se pashë vëllanë tim binjak në ëndërr, që paskësh vdekur gjatë lindjes, ajo ma zuri gojën me dorë dhe më tha:

– Në më do, mos i trego ëndrrat me të vdekur!

Por unë qeshë fëmijë kureshtar, ndaj këmbëngula të di psenë. Dhe ajo nisi të më tregonte:

“Një javë para se të lindje ti, më doli gjyshi yt në ëndërr. Ai më thërriste në oborr, se kërkonte ndihmë për të shkarkuar mushkën me dru. Unë dola dhe zgjidha leqen. Krahu im u shkarkua, por i tiji jo, se litari ngeci. Dhe kështu, kur të linda ty dhe të vëlla, ti jetove se si duket qëllave në krahu tim, ndërsa tjetrin, pra të vëlla e mbajti ai, prandaj nuk u rrëzuan drutë nga krahu i tij. Ndërsa njëherë pashë gjyshen tënde në ëndërr, tri ditë pasi pati vdekur, që qeronte fasule. Kishte mbushur një thes të tërë dhe unë i thashë: “Mjaft ke mbushur, moj nënë!” – por ajo nuk foli dhe vazhonte të mbushte edhe më. Dhe kur hasmi ynë dogji shtëpinë, zjarri nuk mori, se konakët qenë të mbushur me fasule të njoma që nuk digjeshin dhe shtëpia shpëtoi. Pra, gjyshja jote e shpëtoi shtëpinë, se ajo i vuri fasulet

brenda, në të gjallë, që të thaheshin. Ndërsa kur vdiq yt atë, një javë përpara më doli në ëndërr prapë gjyshi i vdekur, që priste në oborr. Dhe kur e pyeta pse kishte ardhur, më tha:

– Thuaji tët shoqi të ngrihet për të lëruar tokën, se e zu dreka!

Unë ia çova fjalët e gjyshit dhe yt atë doli përjashta dhe i tha se sot nuk do punonte, se do të shkonte të blinte një ka, ndaj qe veshur me rroba të reja.

– Mirë, – i tha gjyshi, – veç të jetë ka i zi!

Pas një jave dolëm të dy të lëronim, se qe fund vjeshtë. Po njërin ka, Larushkun, e kishim të sëmure, se qe ftohur në një shpatull dhe rënkonte si njeri në parmendë. Atëherë yt atë shkoi të marrë hua njërin nga qetë e Ritai Stanës, se ara duhej pluguar. Dhe kur kaloi gardhin, i thirra:

– Pashë Zotin, merri të kuqin!

– Po nuk e dua ta çoj krushk, moj grua, – ma ktheu, – parmendën do të tërheqë, në daç i kuqi, në daç i ziu.

Dhe iku. Unë e prita me zemër të ngrirë dhe sa nuk më ra pika, kur pashë që u kthye me zijosin për dore.

– Hajde! – tha se na zu dreka!

Mua më buçiti në vesh fjala e tim vjehri, që më tha në ëndërr: “Thuaji tët shoqi të dalë përjashta, se e zu dreka.”

Dhe teksa punonim, zuri shiu... Por shiu atë ditë qe i çuditshëm. Binte i ndarë në sinorë të ngushtë, sepse ajri qe i ngrohtë, ndërsa retë lëviznin shpejt dhe të çrregullta. Edhe rrufetë shtinin më afër se zakonisht. Ndodhte që njëra arë të zbutej, ndërsa ledhi përfund saj të digjej nga dielli, njëri ka të lagej nga shiu, ndërsa tjetri ta hiqte gjer në fund brazdën në tokë të thatë...

Qemë në të mbaruar, kur kau zijos theu dallëndyshen e kularit. Yt atë ndaloi të shihte, por kafsha qe egërsuar, sikur të kishte të paudhin në bark dhe i dha një të shtyrë me birër, m'u në mes të barkut. Nuk pata kohë as të thërras njeri, se gjaku i mbuloi këmbëshin e trupit dhe vdiq shpejt dhe mua më la kërcu, ndërsa ty këthi.

Kështu, biri im, nuk është mirë të shikosh të vdekurit në ëndërr, se ata nuk janë më si të gjallët, janë tjetërsoj, i tërheqin me vete ata që i duan fort, pa e ditur se sa dhimbje u shkaktojnë të gjallëve.”

Gjumi duhej të më ketë marrë vonë, kur dita thajse po zbardhte. Dhe kur erdhi mëngjesi, u dëshpërova shumë që nata e parë më pati vajtur kot.

Sa dola në rrugë, pashë Gojonë që kishte hipur mbi manin e Ilo Stengës. Sa më pa, u kacavar poshtë.

– Hë mo, – tha, – ç'ndodhi?

– Më zuri gjumi, – thashë, – si i zënë në faj.

– Ashtu, – më tha Gojoja, – më mirë që paska ndodhur kështu!

Ky qëndrim i tij më çuditi, sepse kujtoja se do të më zbrazej me zell, duke më thirrur që, si mundej të tregohesha aq merhum dhe të më zinte gjumi para një ngjarjeje të tillë.

– Dëgjo, – më tha, – më mirë lëre fare atë punë!

– Jo, – i thashë, – dua të shoh edhe një herë tim atë. Më ka marrë malli, nuk e kupton këtë. Dua t'i tregoj sa jam rritur, t'i tregoj se kalit bardhosh që e rriti që mëz për mua, tani mund t'i hipi pa samar, ashtu siç është dhe ta kalëroj me të katra, ashtu siç kishte dëshirë ai. T'i them se këtë vjeshtë do t'i lëroj vetë tokat se krahu më është forcuar për parmendë.

– Mirë, mirë, – tha Gojoja fare indiferent, – kjo është puna jote, veç kujdes, vëllaçko!

Dhe u ndava me të. Pastaj ditën e kalova duke gjuajtur mëllenja. Dhe si rrallëherë nuk vrava asnjë. Si dukej, nuk përqendrohesh dot në shënjestër. Ndërsa mbrëmja më gjeti në oborrin e shtëpisë. Po qëndroja me nënën dhe po qëroja ca thupra shelgu me biçakun e tim atë, për të thurur një koshere të re për të mbajtur bajgat, se i vjetri që kishim, na qe prishur.

Sime ëme i vajtën lot nga sytë, pastaj më foli ngrohtë:

– U rrite, të keqen nëna, por mbete vetëm!

– Pse vetëm, – i thashë, – unë të kam ty, – por në sy nuk guxova ta shoh. Ajo nuk foli, vetëm liroi shaminë e zezë nga gusha, se nuk u ndie mirë. Desha ta ndihmoja, por nuk më la. Tha se po shkonte të shtrihej, ngaqë qe e lodhur. Unë sapo mbarova purtekat, u futa brenda. Shkova në dhomën time, kontrollova grurin e breshkës poshtë jastëkut, pastaj edhe pasqyrën, pastaj rashë të flija. Nuk di nëse fjeta ose jo, veçse ndjeva derën që u përplas fort. Qe errësirë dhe nuk pashë gjë, dëgjoheshin vetëm nja dy angullima qensh, që i ngjanin një ankthi të gjatë. U kujtova. Ngrita pasqyrën dhe në të pashë fytyrën e tim atë. Ktheva kokën pas dhe ai qëndronte në këmbë m'u në mes të odës.

– Qenke bërë vërtet burrë, – më tha, – shiko sa qenke rritur!

U hutova, lëshova pasqyrën dhe desha ta përqafoja, por nuk më la.

– Dale, – më tha, – thirre nënën dhe pastaj më ke këtu!

Dhe unë u sula drejt dhomës ku flinte nëna, kalova në korridorin e errët të shtëpisë, duke thirrur:

– Nënë... nënë... erdhi babai!

Hapa derën e odës së saj dhe i vendosa duart mbi trup për ta zgjuar. Por ajo nuk lëvizti. Largova batanijen dhe pashë që kishte vdekur. Kur u ktheva në dhomën time, as babai nuk ishte më aty. Thirra me sa fuqi kisha dhe për pak kohë fqinjët erdhën aty.

Sytë m'u mbushën me lot, kur pashë që gratë po rregullonin trupin e nënës sime. Ndaj dola jashtë të merrja ajër, sepse m'u zu fryma. Në errësirë dëgjova hapa që po afroreshin. Dëgjova edhe kollitjen e Tobar Tolibës, dhe nga pas e ndiqte e shoqja, Dada Zurka. Më pas vinte shpërfillës edhe Gojoja, i biri. Tobar më përkëdheli kokën në shenjë ngushëllimi, ndërsa Zurka u fut brenda te gratë që vajtonin. Në oborr kishim mbetur vetëm unë dhe Gojoja. Ky më hodhi një vështrim të rreptë dhe qortues kur më pa pasqyrën, që për çudi më kishte mbetur në duar dhe nuk munda ta fsheh dot. Ma tërhoqi nga dora kërcënueshëm, e flaku në tokë dhe i vuri këmbën sipër. Pastaj u fut në shtëpinë time, duke më lënë fill të vetëm në oborr.

KA MOT QI S'JEM PA

Ka mot qi s'jem pa
Plot trimijë
E shtatëqind vjet!

Asht krijue bot' e re.
Gratë veshin pantallona,
Ka burra qi veshin funde,
Fëmijët mësojnë turra vrap,
Pleqtë marrohen shpejt,
Koha e letrave ka ik,
E trenat janë modern,
Nuk m'frymzojnë me shkruie.

U ba mot qi s'jem pa,
Plot tri mijë e shtatëqind vjet
shkuen!
Ç'ka s'ka ndodh qysh at'herë,
Por asgja e re,
Pa marak.

Kanë lind shumë fe,
Parti,
Lidera,
Shejten,
Moda,
Por veç dashnia jet' e njajtë.
E dhimshme deri n'bukuni,
E bukur deri ndhim'.

Homeri ka shkruie "Iliadën",
Asht shkruie "Shkrimi Shenjtë",
Agustini "Rrëfimet",
Dante ka shkruie
"T'Hyjnore Komedi",
Dostojevski "Idjotin"
Tolstoi "Ana Kareninën",
Hygoi «Të Mjerët»,
Neruda "Poezi"
Pushkini Perlat e tij
Buzuku "Mesharin"
Bogdani "Çetën e Profetëve".

Martini Shpirtvargjet e Pavdekshme,
At' Gjergji Lahutën e Patretshme.

Por gjana pa randësi,
E njajt ka mbet'
Dashnia,
Deka,
Lindja,
Dhimta,
Andrra.

Ka mot qi s'jem pa,
Aq sa ja kam harrue ftyren vedit,
Plot trimijë e shtatëqind vjet!

Kurrja s'asht koha,
E koha asht gjithshka!

STRABIKE

Ai qe syni i majtë i
Fëtyrës së majtë
Afër me faqen po të njajtë
Te po e njajta anë e gushës
Teme.

Ma poshtë ish' krahi i majtë
Dhe e majta kambë.

Për fat, kish' zemnen prej anës tij.

Kur e kuptoi qi kish' një sy të shtremt,
Ajo qau me ngashnjim për herë të parë
Prej mendimin e se s'kish me mujt
Me pa vjedhtas anash
ndokand qi mujte me i pëlqye
Apo me hetue çdo detaj
Tipike kjo e natyrës së saj...

E vogël ndëgjoi mbas perdet një grue
Qi synin e saj të majtë e quente "gan".

Kjo fjalë nuk ish' aspak e pëlqyshme
As për kukullën e saj me sy kauçuku.

Synin e saj njihëre ja mbuluen me fashë
Mandej me syze prej Harry Potter-i
Ma vonë e zbuloi krejt
E la me kenë i lirë, siç ish' dhe ajo vetë.



GABRIELA MUJAJ ËSHTË MARTIN CAMAJ ME FUSTAN

Nga Visar Zhiti

Ajo thotë për vete se: ka(m) lindur në Malësi të Madhe, bano(j) në Vjenë, Austri, ku puno(j)n dhe studio(j)n, (jam) është diplomuar në degën Infermieri të Përgjithshme dhe Mastër Shkëncor, (jam) është botuar në disa antologji, pasionet (e mia) e saja të mëdha janë Arti, Letërsia dhe Psikologjia, shkrua(j)n prozë dhe poezi në gjuhën gegnishte.

Gegërishtja, njëri nga dy dialektet e gjuhës shqipe, është pasuri e mrekullueshme e saj, kaq bukur kumbuese, që kulmon plot dritë në poezi, me klasikët tanë panteonikë, e rigjallëruar nga më te rinjtë. Europa dhe bota e kulturuar dialektet i mbron me ligj. Gjuha mbron vetveten me poezi

Poetja e re Gabriela Mujaj ka kultin e të folurit amë, aty është dhe poezia e saj, prandaj dhe gjuha i shkon natyrshëm të thotë "në gjuhën gegnishte".

Poezia e saj ndjehet ashtu siç ndjen dhe vetë poetja. Është në fillimet e saj të bukura, deri më tani është shfaqur në ndonjë antologji, siç e thotë dhe vetë, ka lexuar në takime poetike në Shqipëri dhe në vende të tjera, por më së shumti e kemi parë në rrjetet sociale, në murin e fb të saj, duke tërhequr vëmendjen, po kështu dhe unë e lexoj me ëndje.

Ka një sinqeritet të thellë si prej shpelle, por dhe dhome studentore dhe mbërrin një gjendje të epërme, që ia jep peizazhi malor i vendlindjes, me atë rrjedhën rrëmyese të Drinit si të vargjeve dhe me dritnajtën vjeneze mbi Danub, nga që Gabriela tani jeton dhe studion në Austri.

Poeti gjithmonë duhet të jetë si në fillimet veta, ia uroj ta mbajë këtë mahnitje dhe tronditje të dhembshur ndaj botës përballë, pjesë e së cilës guxon të jetë duke krijuar vetë një botë të saj.

Po sjell diçka nga poezia e Gabriela Mujaj në ExLibris, pa e ditur ajo, si befasi jo vetëm për poeten, por dhe për lexuesin. Duket që Gabriela ka si ikonë poetin Martin Camaj, e ka nga anët e gjuhës së saj, tekta të dy në kohë të ndryshme kanë zbritur nga malet dhe mallet në metropolet gjermanike, aq sa më pëlqen të them diçka që njihet si thënie, por për herë të parë i drejtohet asaj: Gabriela Mujaj është Martin Camaj me fustan.

Poezia zgjedh vetë si të vishet...
Zoti krijoi në mue
nji vajzë me të gjitha kto.

Në të tetëmdhetat vendosi me e qit
haptas në pah,
Mbasi ansji ndërhyrje kirurgjike
Nuk bante ma punë.

Tash,
Syni i majtë asht ma i bukuri sy i saj
Se asht i vetmi qi s'e len me pa
Shëmtitë e botës përreth.

I DASHTUNI JEM ZDRUKHTAR

Vet' kam mendue përherë
ma shumë se ç'duhet,
E për kyt
Zoti më dënoi me ndjeshmëni,
I bindun qi po m'pshton.

Për hakmarrje,
i dashtuni jem zdrukhtar
Më gdhendi një zemër drunit,
Por të nesërmen më gjeti dekun,
varun mbi parvaz,
tekta kundrojsha drandofille
E libra për Shen Gjergj.

Vet' kam dasht përherë ma shumë
se ç'duhet,
E Zoti më dënoi me dashuni,
I bindun qi po m'pshton prej vetmisë.
Atëbotë, Nana jeme m'qafi fort,
E nisa prapë me pi gji.

Vet' kam ndie gjithnji
Ma shumë se ç'duhet,
Prandaj Zoti më dënoi me poezi.
E tash, sa herë që desin pllumbat
M'i lan' pendët si trashëgim.

LULEKUMBULLA NUK FLET

Në Vjenë,
Pemët çelen!

Dje i fola lulekumbullës,
Për ty.
Asnji njeri deri m'sot nuk qëlloi aq i zgjuet,
Sa me e zgjedh misterin e pritjedashunisë.

Unë nuk jam aq e varfën sa me lyp zemna,
Por as aq e pasun, sa mos me kërkue
dashninë.

Kam mbet bash si lulja e kumbullës,

E para në Prendverë.
Me shpres' se g'zimi i jetës së re,
Po të sjellë Ty për ardhmëni.

Aty matanë,
Dy fëmijë qeshin me shpirt.
Dhe pves pemën,
A thue qeshin se,
pernjimend veç k'ta e dijn'
Ç'ka asht dashnia,
Apo se ala s'janë plague prej saj.

Lulekumbulla, nuk flet!

Ajo veç çel,
Si zemna e njerit, qi gjen në jetë dashurinë.

U VETMUEN HARABELAT

U vetmuen harabelat
E mali mban vedin n'krahë,
Asgja s'i dhemb ma shumë lules
Se sa mos me pas për kë me çel.

Zoti vetë i krijoi drandofillet
Mandej dashuritë.
At'her' profeti u ba poet
E linden muzat.

Unë,
Njiher' kam pas dasht' me u ba flutur,
Por kurrë nuk deshta me i shkue kujt
mrapan.
Dy her' pata dasht' me u ba zog,
Por nuk deshta me pëlçit ngazmin të
kangës.
Tri herë vendosa me u ba dallandysh',
Letra me dërgue gjithandej.

Në fund, Zoti krijoi në mue
nji vajzë me të gjitha kto.

SHERMASHEKËT

Asht një vrag'
Varun në lëkurën
E kohës,
Brenda të cillës
Rrin e kuqja e dashnisë sonë.

Mbas do vjet've,
u ktheva në qytetin e
biçikletave.

Në rinjalljen e kujtimeve të mia
Studentore,
Shermashekët qi më prekën
supet,
Të prun' në kujtesën teme.

Ku je?
- ktheva kryet e dveta
avullinë e një porte të madhe
shkodrane.

M'u gjegjen vetëm karajfilat,
Ata që ti, tue u përviedh mbi mur,
I pate k'put me m'i dhurue atë zheg.

...asht një vragë pra,
E vizatueme në lëkurën e kohës,
E cilla vazhdimisht
çel luleborën e qytetit tonë.

KRYEMSHEFTAS

Kur luejshim lojën
Hajde m'gjej,
Mshefeshe ti
E t'gjejshe vetë.
Mshehesha vetë,
E m'gjejshe ti.

Te dy,
N'gaz përgj.

Tash,
Loja po luen me ne.

Ti je msheh,
E ma nuk t'gjej.
Unë,
shuk jam mbledh
E ti nuk m'sheh.

A thue,
Lojnat kanë ndryshue,
A na?

Hajde, shpirt
Se tash kam m'sue
Nji lojë të re...

I HUEJI

Ti tash je i huej,
Si tan' dynjaja!
Letrat zverdhën si fëtyra t'ligshta,

prej vetmisë pa ngjyra.

Jam nisë nja dy tri herë me të harrue,
E m'ka dal një punë me randsi, qi s'ka prit
Me të dasht Ty, urgjent, me zemër e shpirt
Pa koh'
Pa nat'
Pa dit'...

Ti tash je i huej...
Si tan' njerzit e tjerë!
Dikund, mes turmës
frymon një gojë zabukur.
Me të pa në rrugë s'të flas,
Me me pa në rrugë s'më flet.

E thellë sa Qiella, heshtja
Qi të vras, e më vret!

Ti tash je i huej,
Si tan dynjaja.
E pra, dikur bashk'
Kem' luejt yzash nëpër syna!

KUKULLA

Tan' ditën e lumbë
Ra borë në Vjenë.

Pemët u veshën nuse
Dhe e k'qyri dega degën
Në dritë të synit.

Ato janë si gratë e barabarta,
Tradicionale,
Ndryshe prej reve të lira
qi qajnë fatin e tyne
Të mbetun pezull nëpër qiellë.

Në fundin e shpirtit të burrit
Lindi dëshira e zjermit të trupit.
N'at çast, ai lypit të dashtunën e tij
Të përshtetun në divan pran'
kaminit,
Dhe i ledhi gjokset e saja
Të globta.

Ajo fjeti e qetë, pa e trazue andrrën
E një kohe të hershme,
Me të dashtunin e saj të parë.

Burri ndjeu se u ngri për s'gjallit
Pranë dritarës,
Dhe pyeti një zog te pragu,
Se si muj me durue shpirti
Kaq vetmi.

I akullt
Kje trupi i asaj grueje të
përhumbun
në dish'rimë t'pamujtuna.

At'herë
burri pyeti kukullën e saj
Te rafti,
Në dinte ajo me ba
Dashni...

LAJMËRIM

Lajmëroj se ka dek' një dashuni!
Sëmundje nuk pat',
As atak,
I erdh' sahati
Kaq!

Vesh e mbath e kam,
Lisi qindron te vorri
Në kamb' tue prit,
Tan' burri.

Lajmëroj se ka dek',
Një dashuni!
Pres vizita pa shpërblime,
Askush s'muj me e shpague
Zemnen e përhime!

Vesh e mbath jam,
buzët kuq jalli,
Le të thonë Shen kurvat
Kalo në çmenduni.

Shtatin ja lava, me flok' ja thava



E futa në dhe t'zi, tue lan' gjallnue.
Prifti kur erdh' më pveti për emen,
Judë, - i thashë,
Trathtar't kan' t'ânë shpirtin e tij!

Ndërsa burrat banë gjamë për të,
E një grusht gra hoqen rubat me oj-he
Vet, nan lis bana dashni me diellin.

Më mallkuen? Më shkishnuen?
Ani, mëkatet e dashnisë janë të vetmet
Qi të falun kanë në qiell.
Por dhe nëse në ferr çojnë,
Mana shkoj me dëshirë.

Lajmëroj,
se mbramë ka dek' një dashuni!
Varrimi bahet në shpirt
Diten e tettë të javës, të Yjten!

Kujtesa ia dhashtë pushimin e pasosun,
Kështu kjoftë!

TI LUTESH PARA KANDILIT

Po shuhet dhe Hylli i fundit i Qiellës sonë,
Dhe ti lutesh para një qiri të fikun
Për Stinë e pestë pa emën.

Ah, si digjet dikund kandili
Me vajdhimtet
Mbas dritarëve ku dy supe të bardha
Rrin zbuluet.
Bri pishtarit ndrijnë dy syna t'zi.
Sa andrues asht syni i lules,
E sa i paku tuem...

Po shuhet drita e kësaj ditë,
Mbramja erdh' si exheli
Në Schönbrunn avionët shigjetojn
njat Qiell
E uji i trazuem i shatrivanit
E di, e ruen thellë një të pathanun.

Se duhet me rrok' bash fundin
Për me ja nis prej s'parit.

Por, ka me u shue terri i natës,
E kur Vjen Drita, vjen Dashnia!

PARTUM

Ka kohë qi due me lind një fmi
Prej barkut tem.

Rruga ka aj vjen
Asht epiqendra e jetës
Për të cilën akush s'flet.

Ka kohë që due me më lind
Fmia jem mue
Prej rrugës së shpirtit,
Qi asht fryma e jetës
Për të cilën askush ma s'dvet.

NAT'

Nata lindi vetminë,
Mbramë.

Ndërsa duer hijesh
Zgateshin me prit ardhjen e lotit tem,
unë qesha me të madhe.

Asht llahtari, - më tha një dreq i vjetër,
S'e di në kje Judë a Pjetër.
Dhe qesha prapë.

Mandej në gjumë,
Pashë anderr tue lind vedin.

E tmerrshme!
Isha mirë në placentën e gjumit të thellë.

Tash qi jam zgjue,
Po vuej.

Sa e bukur ish' jeta në prehnin e Babës
Dikur,
Por at'her' s'e kam dijt.

O Shpirt i Martinit,
Zbrit mbie mue!

A thue më ka pushtue,
Migjeni?

Jo Çik, - m'tha At' Fishta,
Thjesht je rrit!

PUTHJA E ZOGJVE ASHT NË FORMËN E KANGËS

Na folme për çamët atë mbramje.

Ty të shkrepit në krye
me kujtue dhe arbëreshët.
Mandej,
mue më erdhën ndërmend
Romët,
qi mësojshin shpejt
me ba dashni,
Qysh në moshë të njomë.

Ti qeshe si i marrë,
Kur të thashë
se puthja e zogjve
Asht' në formën e kangës
Dhe se humbja e kukullës
të mënisë
Ishte për mue një kujtim
i dhimbshëm,
Se ajo për mue kish' pas
dhe shikim.

N'at çast u ndëgjue zhurma
e një avioni
afër Belvederes dhe
ra heshtje.

Parandieja më theri zemrën,
Si gjilpanat gishtat e bardhë

e të bukur të nanës teme
rrobaqepëse dikur.

Dhe të thashë,
Çohu, banu gati dhe ik,
Para se mos të mundem ma
Me jetue pa ty.

Ish' muaji i trembëdhjet
I vjetit, si tash e kujtoj.
Aj' që e pata pag'zue
"I ligshti"
Kur na folëm për shumëçka
Dhe madej s'u pamë ma kurrë.

MULLAG' TË THAME

Erth' dimni

I veshme teshat e trasha
Batanija e jorgana i shtruem,
Lulet na u thanë në ballkon
para syve tanë.

Mbas darket fika driten
Dhe ndeza qirin e mbetun
prej natës Shen 'Kollit.

Në terr,
Njeriu mendon gjana që
S'i mendon zakonisht.

E ndiej shijen e venës së bardhë
Në buzët e mija
Kur me njana tjetrën i puqi
Dhe them me vedin,
në mbramje dimnit si k'to
A thue më kujton Ai,
Apo veç puthet me tjera kand...

Në mendimet e mija sillen
e p'shtillen dy flut'ra të verdha,
Të trishtueme për dekje
Se i gjetën mullagët e thame.

Edhe vet' kjava për lulet,
Simjet

Por edhe se një burri të vetmuem
e të pashem me të cilin takoheshim
Në rrugë vazhdimisht,
Shalli ia zuni frymën pardje
Dhe kishte dit'
Që një korb sillej rreth shtëpisë tij.

Mesha e dritës u çue në
Heshtje të plotë.

Kur të vijë Kallnueri,
Kurrkush s'ka me kja
Te vorri i burrit

Se sot,
Secili kjan' vetminë e vet',
E rr'non me frikën e ardhjes
Së korbit rreth shpisë.

MURGU
(Largësia)

Ç'ka asht ndamja, Murg?
Do hapa ma tutje e dy zemna ma afër.
Ç'ka asht largësia, Murg?
Dy tri rrug' mandej
e një shpirt ma k'ndej.
Ç'ka asht ikja, o Murg, n'kyt jetë?
Asht prania, bash prania e vërtetë!


Murg, ç'ka asht qielli?
Një qytet ku s'prendon dielli.
Po atje, ndahen njerzia?
Jo, n'parriz i mbledh krejt shpia.

Murg, ç'ka asht shpirti?
Asht dashnia!
Ç'ka asht malli?
Vetë prania!

O Murg, ç'ka janë vitet?
Shpirti qi rritet.

Murg,
Naten e mirë!
Nata ndodh me kenë e v'shtirë,
por mbas saj del ditë e mirë!

Karikaturë nga Arben Mexsi





KAFE "ADULTER"

(The Spy)

Nga Ylli Pango

Moderatori i njohur Bit Mjalta, ay i TV të Madh Kombëtar-TMK, rrsi më thellë kasketën për të mos u njohur nga fansat e panumert. Eshtë bezdi tek ecën me të shpejtë, jogging rrotull e rrotull liqenit, të rrisë e të përshëndesësh një e dy admiruesit, tu kthesh buzeqeshjet, ndonjë batutë pak më të njohurve... "Ohuuu"

E rrsi kasketën vërtet, por jo aq shpejt sa për të mos e kapur në atë moment fluturuar, syri vigjilent i spiunit të lashtë P. Prasi... Kryente edhe ai në sens të kundërt xhiron e freskët të mengjesit krahe për krahe së shoqes, G.Grenxa....

...Por ja tek vinte kundruall nja 100 m më pas, edhe moderatorja aq e dashur për publikun e ngeshëm, Bi Bleta e Televizionit Gjigand Kombëtar-TGJK...Kish vënë syze të mëdha, kasketë lepurushi rrasur thellë dhe xhogonte edhe ajo me shpresën se nuk do njihet nga fansat pa numër. Duhet thënë se nuk pati aq "fat". E njohën nja dy goca, (e kujt do ja hidhte ajo. Ato mbanin vetë nga ato syzet e mëdha e kasketë të butë lepurushi). E ndaluan, i kërkuan selfie së bashku...u a plotësoi dëshirën shpejt..., rrsi më thellë kasketën e rendi të kapte kohën e humbur...

...Por nuk mendoi kështu për kohën e saj "të humbur" spiuni i hershëm P. Prasi, tashmë analist e kritik i njohur në disa media offit e online... "Pa shih, pa shih" mendoi, mos ka lënë takim me moderatorin Mjalta që xhogonte pak para saj...kjo Bi Bleta punëtore e Televizionit Gjigand Kombëtar?"

Edhe titulli i asaj çka do shkruante ju shkrua vetëtimthi në krye: "Kasketat e fshehta (buta) të moderatorëve"...Ecën edhe ca me gruan dhe pastaj Prasi nuk mundi të përmbante më instinktet...

"Vazhdo ti" po i thotë Grenxës, ik e më prit te kafja...ose pije vetë se më doli diçka..." dhe u kthye e ja mbathi në krahe të kundërt duke e lënë Grenxën pilaf.

"Ku shkon idiot..." i zukati e xhindosur nga pas, gruaja idhnake..."si do e pi kafen vetëm...pastaj e kemi lënë me orar të shkojmë edhe te ai mjeku, të më vizitojë pak thumbin, ..." (cilin thumb syresh, renditi ndër mend nja katër ai...).

...Por sakaq e harroi gruan xanaxare e gezeshem fluturoi. Në vrap e sipër tek i frushullnin gjethet e vjeshtës ndër këmbë e në veshë...sikur iu rikthye tërë jeta e shkuar, e bukur para syve...kujtoi vitet e vegjëlisë kur vinte e përgjonte çiftet që bënin dashni nga liqeni, rininë kur mori pagesën e parë për një spiunllik të vogël...Pastaj atë burrin që e kish ndjekur nga liqeni me të dashurën e që edhe tek rënkonin e bënin dashuri, lëshonin parulla kundër partisë. I spiunoi

dyfish: agjitacion e propagandë dhe adulter, e e kallën në burg atë burrin e atë gruan, që në hetuesi kallxuan njeri tjetrin, e menduan spiunë shoshoqin...pa e marrë vesh nga u pat ardhur si fillim...

...Spiuni i regjur P.Prasi ngadalësoi hapat dhe mbeti në vend me sy të çakarritur: Ç'po shihthe...!!

...Mu tek ajo kafja platformë që sheh mbi liqen e ka poshtë një fushë tenisi, përjetësisht të pa inaguruar, ja mu në mes të asaj terace verore, quajtur ndryshe edhe Kafe "Adulter", na ishin ulur e po pinin kafe, moderatori Bit Mjalta, moderatorja Bi Bleta dhe...o sy të regjur përgjimesh prej vitesh...kjo ishte e pabesueshme...të ishte ajo...po, po, Matka, vetë Matka, gruaja e rreptë me biografi qelbar aso kohe, bashkëshortja e moderatorit fatlum Bit Mjalta...

...Ja me atë rast, edhe monologu-dual, i sëkëlldisur, i P. Prasi:

"Të kishin lënë takim që më parë,këta të tre për kafe? Jo ore...po ç'lidhje kanë...gruaja e Mjaltës me Bletën...pastaj pse nuk ishte që në fillim me gruan Mjalta? Po ato kasketat e rrasura, vërtet për fansat ishin? Pastaj ca si shumë seriozë duken...të tre...as gaz e as gallasë si mes moderatorësh...duhet t'i ketë kapur në flagrancë gruaja e Mjaltit...sapo janë ulur...dhe tani po flasin qetë gjoja...për të mos bërë ndonjë skandal...se të tërë i njohin...he he...po kujt ja hedhin se...mua...hidhjani ndonjë tjetri ato...apo ka ndonjë miqësi familjare...jo ore jo... nuk ma hedhin dot..."

...gjithsesi nuk e botoj dot pa ndonjë foto Bi Bleta- Bit Mjalta, në flagrancë...qoftë edhe një krahe qafe...U pa puna...rikthim në femini...ndofta do më duhet të dal ca herë andej nga Gjiri i Kurvave...andej nga strehoeshin dashnorët dikur...sot e mot... nuk kanë ku përplasen tjetër këta...nëpër hotel kush nuk i njeh..."

...Analisti P.Prasi i telefonon së fundmi gruas-insekt: "Hej Grenxe, te Kafe Llumi je? Prit se erdha"

"Ik more qelbësirë" zukat egër nga ana tjetër e liqenit Grenxa. "Pije me atë kurvën...helm tu bëhet...Me kë u takove plehrë...Mua do ma hedhësh ti?..."

...Gjithmonë e pat akuzuar për tradhëti të shoqin. Dhe nuk arriti kurrë t'ja njohë as me emër e as me fytyrë...dashnoren, dashurinë e tij të vërtetë. Atë pasion, extra-femër, "femër" mbi femër, që atij nuk ju shterr shpirtit, që femijë, në ato kohra të bukura kur ajo lulëzonte e në këto kohra...kinse të reja...e me gjasë si dhe ai... lodhun, fyshkun a dalë jashtë mode edhe "ajo"...assesi...gjithmonë e freskët, e re, intriguese për të...

Botim special i Qendrës për Studime Albanologjike në Universitetin e Gjuhëve të Huajta në Pekin

Shtypi kinez për nominimin e Kadaresë për çmimin "The Booker International"

Përktheu Iljaz Spahiu

Vepra më e re e Kadaresë, "Kur sunduesit grinden", është nominuar për çmimin ndërkombëtar "The Booker" për letërsinë. Botimi në anglisht i kësaj vepre doli në qarkullim në vitin 2023, me përkthim të John Hodgson, i cili është gjithashtu përkthyes në anglisht i shumë romaneve të Kadaresë. Kjo vepër u botua për herë të parë në gjuhën shqipe në vitin 2018, me titullin "Kur sunduesit grinden". Në Ditën Botërore të Librit, e pamë të dobishme ta shfletojmë së bashku librin për të kuptuar mes rreshtave sharmin e pafund të letërsisë shqipe.

Vepra më e re e Kadaresë përbëhet nga tri pjesë relativisht të pavarura. Në pjesën e parë, personazhi kryesor "Unë" udhëton në kohë dhe hapësira të ndryshme, fillimisht në Moskën e viteve '50 të shekullit XX, kohë kur romancieri sovjetik Pastërnak u përball me "valën polemizuese të Çmimit Nobel", ndërsa "Uni" duket sikur ka humbur në këtë qytet tashmë të njohur. Në të njëjtën kohë, në një hapësirë dhe kohë të ndryshme, në Tiranën e viteve '70 të shekullit XX, "Uni" po përgatit në akth e shqetësim botimin e romanit. Një telefonatë e Stalinit me Pastërnakun, pavarësisht nëse është reale apo e rreme, herë pas here kthehet në makt të zgjatur që "Uni" nuk e largon dot. Madje "Uni" merr një telefonatë të papritur nga udhëheqësi Enver Hoxha, e cila gjithashtu kthehet në fikusin e një tjetër "stuhie letrare". Pa dyshim, vepra përdor teknika të ngjashme me sekuencat filmike, për të krijuar lidhjen mes Tiranës dhe Moskës, mes dy epokave, mes "Unit" dhe Pastërnakut, si dhe gjithçka rreth meje.

Në pjesën e dytë, ngjarja zhvendoset në Francën e vitit 2015. Vajza e së dashurës së Pastërnakut, Irina, vjen në Francë, ku takohet me "Ne" bashkëshortët. Në këtë moment, kurioziteti i "Unit" bëhet gjithnjë e më i fortë, duke bluar vazhdimisht në mendje trajektoren e jetës së Pastërnakut dhe në këtë mënyrë, fillon të shkruajë historinë e kësaj telefonate misterioze.


Ndërkohë, në pjesën e tretë, "Ngjizja dhe lindja", mendimet e "Unit" shpërthejnë vullshëm dhe të kombinuara me materiale arkivore dhe kujtime, fantazojnë trembëdhjetë versione të ndryshme, në përpjekje për të zbuluar të vërtetën e atyre tri minutave të bisedës telefonike. Megjithëse biseda treminutëshe ishte fare e shkurtër, ankthi dhe shqetësimet që ajo shkaktoi në atë kohë si dhe ngatërresat e përplasjet e pafundme që lindën nga interpretimet e vazhdueshme, u shndërruan në një përfytyrim interesant.

Gazetat *The Sunday Times*, *Los Angeles Review of Books* dhe gazeta të tjera amerikane e angleze botuan shkrime rreth kësaj vepre përpara se Kadareja të nominohet për çmimin "The Booker", ndërkohë dy artikuj kritikë të tyre kohët e fundit ka botuar edhe gazeta letrare në Shqipëri, *ExLibris*.

Redaktorja letrare e gazetës *The Sunday Times*, Laura Hackett, fokusohet te veçoritë e zhanrit jofikshën të kësaj vepre dhe metafora e thellë e brendësisë së tekstit, duke u shprehur se mjedisi i krijimtarisë së Kadaresë, në mënyrë të natyrshme, do ta shtynte atë drejt hamendësimeve mbi marrëdhëniet e shkrimtarit me sunduesit. "Ky libër nuk është roman i vërtetë. Është më shumë një kryqëzim mes kujtimeve, ditar ëndrrash dhe investigimeve historike, në të cilat Kadareja lundron përmes versioneve të raportuara se çfarë ishte thënë gjatë telefonatës, me meditime mbi të vërtetën, kreativitetin dhe tiraninë".

Ndërsa kritiku letrar Cory Oldweiler shkruan në gazetën *Los Angeles Review of Books* se theksi i kësaj vepre vihet në përplasjen, betejën mes pushtetit dhe artit si dhe në dallimet e vogla enigmatike mes tyre, pasi, siç thotë Kadareja: "Arti, ndryshe nga një tiran, nuk kërkon mëshirë, përkundrazi, duhet të solidarizohet me tjetrin." Sipas Oldweiler, beteja mes pushtetit dhe artit përbën jo vetëm subjektin e romanit, por edhe trajektoren e karrierës së Kadaresë, e cila përmban edhe qëllimin final të krijimtarisë letrare artistike.

Në vitin 2005 Kadareja ishte fituesi i parë i çmimit ndërkombëtar "The Booker". Megjithëse ai nuk përfshihet në listën e ngushtë të fituesve të këtij çmimi, mund të thuhet pa mëdyshje se vepra e tij më e re iu jep mundësi lexuesve që përmes një interpretimi kompleks të një telefonate treminutëshe të kuptojnë mendimin e shkrimtarit për diktaturën dhe lirinë, për thelbin e letërsisë dhe artit, duke shtuar kështu një tjetër kryevepër në thesarin e letërsisë shqiptare.



Asgjë nuk e ilustron më mirë brishtësinë e qenies njerëzore sesa epoka në të cilën po jetojmë, njerëzit me të cilët ndodh shpesh të jemi të rrethuar, paaftësia që kanë për të përballuar emocionet e mëdha, frikërat e brendshme, trysninë e kohës, sfidat që shpeshherë duhet t'u bëjnë ballë e nuk munden. Ngjan sikur njeriu jeton brenda "katër mureve" të mendjes së tij dhe e ka mjaft të vështirë t'i shohë gjërat në përmasën e tyre reale, sikur jeton pa jetuar dhe lumturia i zgjat vetëm një grimëçast. Kësisoj "Gjithçka kërkon shpëtim".

Daniele Mencarelli me romanin e tij autobiografik "Gjithçka kërkon shpëtim", iu qaset pikërisht këtyre njerëzve, i jep lexuesit një interpretim të jashtëzakonshëm, na thërret secilin të përballet me një realitet që mund të ngjajë i largët, por që në fakt është shumë pranë nesh dhe na rrethon çdo ditë. Cilido prej nesh i ndodh që të ketë përballë dikë, i cili në një lloj mënyre, qoftë edhe në subkoshencën e vet kërkon "shpëtim" dhe ne duhet ta dëgjojmë, të jemi aty dhe të përpiqemi ta ndihmojmë të zgjidhë "fijet e ngatërruara" të mospërputhjes me realitetin dhe vuajtjeve të brendshme që shpesh i ngjajnë të pakapërcyeshme.

Tani më shumë se kurrë, në këtë botë në dukje pa ekuilibër, pas Covid-it që ka nxjerrë në dritë psikodrama tipike të skenarëve "postapokaliptikë", ky libër është mjaft aktual dhe duhet lexuar si i tillë, me zemër dhe mendje të hapur.

Romani i vendosur gjatë verës së vitit 1994, tregon historinë e Danieles, një djali i cili, pas një sulmi zemërimi, i nënshtrohet një trajtimi të detyrueshëm mjekësor në një pavijon psikiatrie. Rrëfimi është i ndarë në shtatë kapituj, numri i ditëve

Mbi romanin e Daniele Mencarelli-t "Gjithçka kërkon shpëtim" - Botimet Toena, 2024

NJË "UDHËTIM" NË ERRËSIRËN E MENDJES NJERËZORE

Nga Edona Marku Huqi

Kryeredaktore e Botimeve Toena

që Daniele qëndron në spital. Jo më kot autori ka përzgjedhur pikërisht numrin shtatë. Simbolika e këtij numri është tejet e interpretuar sipas kulturave dhe religjioneve të ndryshme, por në rastin e Danieles, mendojmë se numri shtatë tregon bashkimin e treshit (që përfaqëson Shpirtin) me katrën (që përfaqëson materien). Ndaj dhe përgjatë gjithë tekstit përsëritet e ripërsëritet si një refren, si një lloj lutje e përshpirtshme, thirrja e njerit prej personazheve "Shën Mëri, kam humbur shpirtin! Më ndihmo, Shën Mëria ime!"

A është Daniele viktimë e ndjeshmërisë dhe brishtësisë së tij? Dhe sa e shqetëson atë një realitet që duket se nuk i përket? Këto janë disa prej pyetjeve ekzistenciale të romanit. Daniele është një djalë i përkulur nga pesha e një ekzistence tepër komplekse për të, i cili përpiqet të reagojë,

por humbet kontrollin, përpiqet të kuptojë dhe humbet mes përgjigjeve që nuk arrin t'i marrë as nga vetja dhe as nga të tjerët, nuk është në gjendje të menaxhojë zemërimin, dhimbjen e të jetuarit dhe dhunën që sikur lëshojnë vetë mendimet e tij. Daniele vuan, ndihet i mbingarkuar, acarohet me këdo dhe gjithçka, ndien dhimbje dhe është i brishtë. Por në ato shtatë ditë shtrimit në spital ai shfaqet i plotë, nuk shtretet, përçon çdo ndjenjë të tij që prej thellësive, ndihet i mirëpritur dhe i pagjykuar nga shoqëruarit e tjerë të pavijonit dhe kërkon "shpëtim" për veten dhe shokët e tij, për të gjithë ata kudo nëpër botë që ndodhen aty ku është ai dhe ndihen si ai.


Personazhet e librit, që jetojnë në këtë mikrokozmos që është spitali psikiatrik, secili prej tyre jashtëzakonisht i ndryshëm nga tjetri, kanë të gjithë histori tragjike, të dhimbshme, një arsye që i ka shtyrë në atë gjendje. Janë të gjithë pacientë, njerëz që Daniele i njeht aty, miqësohet me ta, mundohet t'i kuptojë dhe herë-herë të futet në nëndërgjegjen e gjithsecilit dhe na mëson t'i njohim për të gjitha aspektet e tyre njerëzore dhe të bukura, të cilat shumë shpesh janë nën hijen e një patologjie që i

përcakton. Kësisoj mësohet fort, ndër të tjera, e vërteta se pacienti ndihet dhe është vetëm, se sa të braktisur janë të sëmurët dhe nevoja e madhe që ata kanë për t'u kapur pas një dore që t'i përkrahë dhe t'i bëjë ta duan jetën e mbi të gjitha veten.

Personazhet që shpalosen përgjatë këtij afati kohor, pra gjatë shtatë ditëve, marrin më shumë rëndësi në varësi të ditës së analizuar. Mencarelli udhëzon, por vetëm sipërfaqësisht, bën një lloj karakterizimi patologjik të këtyre individëve: bipolariteti, gjendjet depresive, katatonia, ankthi, skizofrenia. Lexuesi heton personazhet së bashku me protagonistin kryesor, patologjia e të cilit është edhe më e vështirë për t'u identifikuar, e megjullt dhe jokonsistente. Megjithatë tema themelore nuk janë sëmundjet mendore. Spitali, "të çmendurit", atmosfera e ngujimit dhe e tjetërsimit që ndien i riu Daniele, prezantojnë kontekstin dhe falë këtyre elementeve vizuale dhe hapësinore lexuesi hyn në analizën që protagonistin i bën vetes, e më pas vetë qenies njerëzore. Sepse vetë qenia njerëzore është nyja lidhëse e të gjithë romanit.

Rrëfimi është linear, rrëfyeti është i njëjti protagonist, i cili shënon dita-ditës ngjarjet dhe ndjesitë që ka gjatë shtrimit në spital. Si një lloj ditari, romani rrëfëhet në vetë të parë, me një gjuhë të thjeshtë, por me shumë peshë, ku jo ngjarja, por ndjesia është epiqendra e tij. Përdorimi i dialektit përzier me standardin i referohet ndjenjave më intime, mbrojtjes nga bota e jashtme, nevojës për të përfaqësuar një realitet tjetër, të papërpunuar, atë brenda mureve të një spitali.

Fitues i çmimit "Strega Giovani" 2020, një libër autentik, i sinqertë, një "udhëtim" në errësirën e mendjes njerëzore; një udhërrëfyes për të gjithë ata që në një moment të caktuar të jetës thyhen, ndihen sikur kanë humbur, nuk e pranojnë realitetin që i rrethon, për të gjithë ata që pyesin dhe nuk marrin përgjigje, që kërkojnë sikurse Daniele "shpëtim".




Gjithçka kërkon shpëtim

Fitues i Çmimit "Strega Giovani"

Daniele Mencarelli

BOTIMET
TOENA
TOENA



Për miqtë e mi më të vjetër,
përfshirë edhe ata që na kanë lënë
por që jetojnë në mendimet tona.

Foto grupi
1 janar 1995

Është një foto me ngjyra, e stilit të vjetër, me një letër me shkëlqim, e mbledh lehtësisht në dorë, përthyeret e grisit fare lehtë, relike e epokës para telefonave inteligjentë.

Do të ishte hera e fundit që bëheshin të gjithë bashkë, në fermën e vogël të Adrianit dhe Ivetës në dalje të Stellenbosch-it. Hareja e natës së mëparshme, festimi i natës së Vitit të Ri kishte lënë gjurmë në fytyrat e tyre, bashkë me disa shenja më të gjata në kohë, shenja që lë pas inati apo emocionet e tjera të ndrydhura, rrudhat e para, flokët e rëna. Moshë kishte filluar të bënte të vetën, por ata ishin akoma të rinj, aq sa të bënin sikur nuk e ndjenin ftohtësinë e saj.

Iveta qëndronte e ulur në mes të divanit të kuq. Kishte veshur këpucë prej sateni me të njëjtën nuancë ngjyre si tapiceria. Rastësi. Ajo nuk është nga ato gra që zgjedh rrobat e saj bohemiane për t'i kombinuar me mobilet e përdorura që ka në shtëpi. Liana dhe Maksi i ulen në krah, secili në njërin anë dhe të tre mbajnë nga një foshnje. Liana dhe Maksi mbajnë djemtë e tyre binjakë, Aleksandri në prehrin e së ëmës dhe Nelsoni në gjunjë të atit, edhe pse asnjë nuk arrin të bëjë dallimin mes dy foshnjëve zeshkane. Dyponti dhe Dyponti i Tintinit, të veshur mirë, me këmbisha me jakë marinari të kombinuara, flokët e zinj të krehur mirë e fytyrat e pastra që shkëlqenin. E kundërta e tyre ishte Frida, e tëra lakuriq, vetëm pelenat kishte në trup, rrinte mbi prehrin e Ivetës, me tufën e flokëve kaçurrela lëmsh. Në fytyrë i dallohen njolla kafe në njërin faqe, ndoshta çokollatë, baltë, ose edhe bojë nga studioja e babait të vet.

Poli është ulur në krahun e divanit, ngjitur me Lianën, me të cilën ka qenë dikur i martuar. Në ato vite ishin çifti magjepsës i rrethit të miqve, Getsbi dhe Dejzi i tij. Pas ndarjes, ata vazhdojnë të jenë tërheqës, secili më vete, por nuk e kanë më atë shkëlqimin që të bënë të pulitësh sytë kur i shikon.

Ishin si pasqyra që reflektonin vazhdimisht tek njëri-tjetri dhe më pas ky pasqyrim u venit. Sytë e tij duken të trishtuar, goja e saj duket e lodhur. Dihet arsyeja. Ai akoma nuk e ka marrë veten nga vdekja e njeriut të dashur, kurse ajo ndjen ndonjëherë se lindja e binjakëve e ka lënë si të shushatur.

Në krahun tjetër të divanit, ngjitur me Maksin, është Mila, mban veshur një fustan të kuq, ka vënë buzëkuq të kuq me një nuancë më të hapur se divani dhe këpucët e Ivetës. Pas saj, është i dashuri i ri flamand, Hermani, që ka vënë dorën në qafën e saj të gjatë. Ai është më i madh në moshë, më i madhi i të gjithë grupit. Ka flokë argjendi, ka veshur një këmbishë klasike me vija blu dhe të bardha me kopsa të vogla. Elegant, ky kishte qenë vendimi i Lianës kur e kishte takuar një ditë më parë dhe ata e kishin besuar. Të gjithë ia vinin veshin gjykimeve të saj për modën.

Adriani ishte ulur në shesh, mbi tapetin shumëngjyrësh përballë divanit, veshur me pantallona të shkurtra dhe kapele prej kashte. Ai nuk ua vinte veshin shumë rregullave të Lianës. Rrinte me këmbë të kryqëzuara dhe zbatuar, njësoj si vajza e tij nëntë vjeçare e cila qëndronte përballë tij. Mona është vërtetë bija e të atit të vet, me pamjen e shkujdesur sikur po vjen nga rruga, me të njëjtin qëndrim të sertë. Ajo nuk është e kënaqur me qëndrimin në foto, ulur përballë të atit, sikur e kanë marrë

ENDE GJALLË

Nga Marita van der Vyver

Përktheu nga origjinali: Sidita Hoxhiq- Dano

Marita van der Vyver, [1958], shkrimtare afrikane, autore e shumë romaneve, është diplomuar në vitin 1978 në degën e gazetarisë dhe ka punuar në disa revista dhe gazeta të ndryshme.

Është fituese e shumë çmimeve të rëndësishme dhe ka qenë e ftuar të marrë pjesë në programin e shkrimtarëve të njohur të Universitetit të Iowa-s në SHBA. Librat e saj janë përkthyer në shumë gjuhë të botës.

vetëm për pozë, kur në fakt mund të ishte e ulur së bashku me dy fëmijët e tjerë në fund të rreshtit, përballë divanit.

Dilani vështron i vrenjtur në boshllëk, krahët i ka të mbështjellë rreth gjunjëve tërë gunga. Motra e tij e vogël, Kejtina, një bukuroshe bionde vocërrake, përdridhet para kamerës sikur po bën prova për t'u bërë yll kinemaje.

Kjo ishte pikërisht dita kur filloi historia e Monës dhe Dilanit, megjithëse ata vetë do ta kuptonin këtë gjë vetëm disa vite më vonë.

Bobi dhe Zelda ishin ulur në të dy krahët e Adrianit, secila me nga një qen në prehrin.

- Shiko, - kishte thënë Zelda, - nëse do të jenë edhe fëmijët e të ftuarëve në foto, atëherë do të ishin edhe qentë dhe këlyshët e tyre. Përfaqësimi ishte i rëndësishëm. Ajo e

dinte mirë. Fytyra e saj ishte e vetmja ngjyrë kafe në grup.

Mona ishte përpjekur ta bënte të merrte poza edhe qenin e saj labrador, por u mërziu dhe u largua në minutën e fundit. I duket vetëm bishti në këndin e poshtëm majtas pranë Dilanit, i cili duket sikur do të donte të bënte ashtu si qeni dhe të largohej. Ai është njëmbëdhjetë vjeç, i sëmurë, por i mësuar me trupin e tij dhe nuk ka fare qejf të buzëqeshë para një aparati fotografik.

Ralfi qëndron pas divanit, i gjatë dhe i ngrirë si një kolonë, thjeshtri i tij pesëvjeçar në njërin krah dhe krahun tjetër ia ka hedhur mbi sup Leslit. Ajo ka zënë vend aq mirë nën shpatullat e tij, trupi i mbledhur ka zënë rehat pas kolonës dhe sytë i ka fshehur pas syzeve të rënda. Nana Muskuri, ky ishte emri i tyre me përkëdheli për këtë grua me flokë

të zinj, që mban syze me skelet të zi, e cila kishte arritur të zbuste zemrën e Ralfit. Ajo e kishte zbutur, e kishte shpërblyer me fëmijë dhe me një shtëpi në periferi, atëherë kur miqtë e tij kishin filluar të besonin se nuk do të ndodhte kurrë më një gjë e tillë.

Oskari, djali i vogël në krahun e Ralfit, i ka zgjatur diçka vogëlulshes në radhën e pasme, ka diçka që do t'ia japë në dorë, mbase një biskotë ose ndonjë copë ëmbëlsire. Sasha qëndronte e qetë mbi ijën e Emës, e pavarësisht për uverturën e Oskarit, ndërsa gishtat topolake i ka të ngatërruar në kaçurrelat e egra që rriten rreth fytyrës së nënës së saj si një kaçubë e rrëmuishme. Ema është një kokë më e gjatë se Lesli, ndoshta edhe pak më e gjatë se burri që buzëqesh mes tyre. Ai duket aq i çuditshëm, sa një vizitor i rastësishëm që ka përfunduar rastësisht në një foto familjare.

Kur e panë fotografinë vite më vonë, disa prej tyre e kishin vërtetë të vështirë t'i mbanin mend emrin. Ai është Çarli, me të cilin Ema kishte kaluar natën e Vitit të Ri, një aventurë seksuale që i kishte habitur të gjithë, më së shumti Emën se këdo tjetër.

"Shiu i parë pas një thatësire të gjatë" e kishte ngacmuar Adriani. Por thatësira do të kthehej shumë shpejt.

Ema e kishte ngritur deri në ijë engjëllin e vogël bjond, fëmijën e saj dhe të burrit të ndjerë. Ishte e vështirë të besohej se Filipi me cinizmin e tij të zymtë mund të kishte ngjizur një fytyrë të tillë të pafajshme. Ajo thoshte se ishte e vetmja gjë e mirë e marrëdhënies së befasishme që kishin pasur.

Ajo e ngjiti foton e grupit në mur mbi tavolinën e shkrimit, më mirë të themi, mbi disa tavolina shkrimi gjatë atyre viteve dhe ndonjëherë ia ngulte sytë për disa minuta deri kur gishtat e saj ndalonin mbi tastierën e kompjuterit.

Liana e kishte vënë fotografinë në një album fotografik të stilit të vjetër me faqe të zeza të forta, të mbajtura me katër qoshe fotografish ngjyrë floriri.

Vetëm ajo e dinte se ku mund të gjeje ende albume kaq elegante e të vjetra. Ndonjëherë e shfletonte, me Maksin ose binjakët.

Poli dhe Mila e ruajtën foton në një re digjitale sepse fotografitë e printuara dhe albumet prej letre zinin shumë hapësirë në kontejnerët e transportit në të cilat pasuritë e tyre transportoheshin në shtëpi të reja në kontinente të tjera.

Zelda e ngjiti foton mbi derën e frigoriferit në kuzhinën e saj dhe të Bobit në Cape Town pasi i kishin zëvendësuar qentë me fëmijë të vërtetë, e kështu u tregonin pasardhësve një fotografi të jetës së prindërve të tyre. "Ne para se të vinit ju". Diçka e tillë.

Ralfit i kishte dalë nga mendja fotoja. E kishte hedhur në një sirtar diku, derisa e gjeti kur iu desh të paketonte plaçkat e shtëpisë pas zhdukjes së Leslit. Papritur i rrëshqiti nga një parg letrash, një dhuratë e papritur që i solli ngushëllim papritur.

Iveta e vendosi foton në studion e Adrianit, që ishte bërë lëmsh kohët e fundit. Thjesht e ngjiti në mur me një thumb kancelarie, mes qindra fotove të tjera, fotove të miqve dhe të panjohurve, prerje gazetash me ndërtesa të famshme dhe vepra arti, kartolinave, skicave dhe ilustrimeve. Me gjithë atë lëmsh që kishte para syve, vështirë se mund ta dallonte. Ajo shpresonte të paktën që një ditë do ta vinte re, edhe pas disa muajsh.

Një foto grupi krejtësisht e zakonshme që rrëfente një histori prej mijëra fjalësh. Ose, më mirë le të themi, një mozaik historish. "Ishte thjesht çështje këndvështrimi", do t'i thoshte vetes Ema, "sigurisht varej me sytë e cilit prej tyre po e vështroje".



Sipas Orson Welles-it, nëse një histori Smbaron bukur apo jo, varet nga pika në të cilën ne e ndalojmë rrëfimin. Një natë janari po haja peshk me oriz të gatuar me arra kokosi, në një bar që ndodhej pranë bregut të Detit të Karaibeve në Kolumbi. Një amerikan, me lëkurën të nxirë nga dielli dhe të mbuluar me tatuazhe, qëndronte ulur në një tavolinë pranë meje. Duhej të ishte dyzetë e shtatë – dyzetë e tetë vjeç, krahët i kishte gjithë muskuj, ndërsa flokët ngjyrë gri, të mbledhur kulaç. Ai po bisedonte me një vashë angleze, rreth të nëntëmbëdhjetave, e cila, përpara se të hynte në bisedë me të, ishte duke lexuar një libër. Pas një ngurrimi, ajo e pranoi ftesën e tij për t'u ulur në të njëjtën tavolinë me të. Fillimisht foli vetëm ai. Pas njëfarë kohe, ajo e ndërpreu.

Biseda e saj ishte interesante, e gjallë dhe e pazakontë. Ajo tregoi një ndodhi të papritur që i kishte bërë vaki gjatë një zhytjeje nën ujë, në Meksikë; gjithashtu rrëfeu se kishte qëndruar e zhytur për njëzetë minuta dhe se, kur kishte dalë në sipërfaqe, ishte gjendur në mes të një stuhie. Deti ishte kthyer në një vorbull dhe, e kapluar nga angështia, ajo ishte trembur se nuk do t'ia dilte mbanë të notonte deri te barka. Ndonëse historia e saj kishte të bënte me daljen në sipërfaqen e detit pas një zhytjeje, si dhe me përbalimin me një mot tejet të ndryshuar papritur, në thelb, rrëfimi i saj kishte të bënte me një lëndim që ajo e mbante të fshehur. Vasha i dha të kuptojë se në barkë ndodhej dikush (që ajo kishte menduar se do t'i vinte në ndihmë), dhe menjëherë më pas, e rroku atë me sy, për të parë nëse ai e kishte kuptuar se përmendja e stuhisë në rrëfimin e saj, nuk kishte kuptim të drejtpërdrejtë. Ai nuk tregoi ndonjë interes të veçantë dhe e vetmja gjë që bëri, ishte lëvizja e gjunjëve në një mënyrë të tillë që shkaktoi lëkundjen e tavolinës. Për pasojë, libri që ndodhej mbi të, përfundoi në dysheme.

"Ti flet shumë, apo e kam gabim?" u shpreh ai.

Ajo i bloi fjalët e tij në mëndje dhe, duke krehur fundin e flokëve me gishtërinjtë e saj, e hodhi vështrimin nga dy adoleshentë, të cilët po u shisnin turistëve puro dhe bluza futbollit në sheshin me kalldrëm. Për të nuk ishte aspak e lehtë t'ia bënte të qartë, një njeriu shumë më të vjetër në moshë, se bota ishte e saja gjithashtu. Në çastin që amerikanin e ftoi vashën në tavolinën e tij, ai kishte marrë përsipër një rrezik. Në fund të fundit, ajo mbartte në vetvete gjithë përvojën e jetës bashkë me energjinë e epshit. Atij as që i kishte shkuar ndërmend se ajo, për asnjë çast, nuk do ta shilte veten si një *personazh dytësor*, ndërsa atë si kryesor. Në këtë kuptim, ajo kishte shkelur një kufi, kishte përmbysur një shoqëri hierarkike dhe kishte trazuar ritualet e përditshme.

Vajza e re e pyeti se çfarë po nxirrte nga tasi bashkë me patatet e fërguara. Ai tha se pjata që kishte marrë quhej *ceviche*, ose ndryshe një peshk i gjallë i përgatitur me lëng qitroje jeshile, e cila në meny figuronte me emërtimin *sexvice*¹ - "Shërbehet me prezervativ," shtoi ai. Në çastin që ajo buzëqeshi, unë e kuptova se ajo po përpiquej të dukej më e guximshme sesa ndihej, dhe se po hiqej



ARGJEND

Nga Deborah Levy

Përktheu nga origjinali: Aristidh Shqevi

si dikush që mundej, vetëm dhe lirshëm, të udhëtonte, të lexonte një libër dhe të rrufiste birrë natën në një bar, e pashoqëruar dhe madje e gatshme për të rrezikuar një bisedë tejet të koklavitur me një të panjohur. Ajo e pranoi ofertën e tij për ta provuar shijen e ceviche-s,

por në vijim, i bëri bisht propozimit të tij për të notuar me të në një zonë të vetmuar të plazhit lokal, i cili, e siguroi ai, ishte "larg shkëmbinjëve"².

Pak më vonë, ai tha, "Zhytja nuk më pëlqen. Gjithsesi, nëse do të më duhej të zhytesha thellë, do ta bëja vetëm për

diçka të florinjte ose diçka me vlerë."

"Oh," tha ajo. "Çudi që u shprehe kështu. Po mendoja se emri më i përshtatshëm për ty do të ishte Argjendi i Madh."

"Përse Argjendi i Madh?"

"Sepse ky ishte emri i barkës nga e cila u hodha për zhytje."

Ai tundi kokën në shenjë mohimi dhe, disi i hutuar, zhvendosi shikimin nga gjoksi i saj në drejtim të tabelës së vendosur mbi derë, ku ishte shkruar fjala Dalje, e cila ndriçohej nga një dritë neoni. Ajo vuri sërish buzën në gaz, por këtë nuk e bëri enkas. Besoj se ishte e vetëdijshme, se do t'i duhej ta qetësonte turbullirën që kishte sjellë me vete nga Meksika në Kolumbi. Gjithsesi, ajo vendosi t'i tërhiqte mbrapsht fjalët që sapo kishte nxjerrë nga goja.

"Jo, do të quaja Argjend i Madh për shkak të ngjyrës së flokëve dhe unazës që mban në njërën vetull."

"Jam thjesht një tip që nuk mund të ngujohem në asnjë vend," tha ai. "Shpërngulem sa andej këtej, pa pasur ndonjë pikësynim të caktuar."

Pasi pagoi llogarinë e saj, ajo i kërkoi bashkëbiseduesit ta ngrinte librin që ndodhej në dysheme që nga çasti që ai i kishte dhënë tavolinës një goditje me gjunjë, që do të thoshte, se duhej të përkulej dhe të futej poshtë saj, për ta tërhequr librin me këmbë drejt vetes. Kjo zgjati disa sekonda dhe në çastin që ai u rishfaq me librin në dorë, ajo nuk u tregua as mirënjohëse dhe as e pasjellshme. Vasha thjesht belbëzoi, "Faleminderit."

Kur kamerierja mblodhi pjatat me mbeturinat, kthetrat e gaforres dhe halat e peshkut, mua më erdhi ndër mend thënia e Oscar Wilde "Tregohu ai që je; të tjerët janë të gjithë të zënë." Në të vërtetë, kjo thënie nuk vlente për të. Ajo gjithnjë ishte përpjekur që t'i siguronte vetes lirinë, të cilën Argjendi i Madh e merrte si të mirëqenë. Tekefundit, ai nuk e kishte problem të ishte vetvetja.

Ti flet shumë, apo e kam gabim?

Të flasim për jetën, ashtu siç e ndiejmë, është një lloj lirie që shumica prej nesh zgjedh të mos e marrë parasysh. Gjithsesi, mua m'u duk sikur fjalët e saj dilnin të gjalla nga brendësia e saj, se ato ishin të mistershme për atë vetë, dhe po aq për këdo tjetër.

Më vonë, teksa po shkruaja në ballkonin e hotelit, solla ndër mend mënyrën se si ajo e kishte ftuar Argjendin e Madh ikanak që të lexonte midis rreshtave të lëndimit të saj të fshehtë. Ajo mund ta kishte ndalur rrëfimin, duke përkthyer mrekullitë që kishte parë në detin e thellë e të qetë, përpara ngritjes së stuhisë. Ashtu, fundi do të kishte qenë i lumtur, megjithatë ajo nuk u ndal aty. Në fakt, ajo i drejtoi një pyetje si atij (ashtu edhe vetes): A je i mendimit se personi që ishte në barkë më braktisi? Jo, Argjendi i Madh nuk ishte lexuesi i duhur për të, por duke marrë parasysh gjithçka, arrita në përfundimin se ajo mund të ishte lexuesja ime më e mirë.

BLLAGA DIMITROVA

MËSIM NGA HISTORIA

Kronisti bizantin Prokopi i Cezaresë
Ditën shkarraviste kronikat zyrtare:
Fitore të lavdishme, progres i paparë etj.

Natën në fshehtësi shkruante të vërtetën
Mbi shthurjen e oborrit, plakçën, paligjshmërinë,
Që popullin dhe shtetin e shpienin në greminë.

Ndryshe, si do të bënte prokopi Prokopi?
E vërteta e ditës vlente deri në drekë
Ndërsa ajo e natës për ditët në vazhdim.

Me dy pupla gusash u ngrit Prokopi
Veçse për këtë të shkretë urtësi
Duhet të jesh patjetër bizantin

Po, për besë.
Dhe t'i dalësh zot llagapit i Cezaresë.


(Shqipëroi: Agim Vinca)



Shënime të përkthyesit:

¹ sexvice – sex and service (seks dhe shërbim).

² shkëmbinjte – në origjinal "the rocks" – në zhargon = dy kokrrat në organet gjenitale të mashkullit

Yves Klein, *Anthropometry pa titull* (ANT 106), 1960, Nga Yves Klein Archives

28 prill 1928 - 6 qershor 1962

SI E NDRYSHOI GJUHËN E ARTIT

YVES KLEIN

By Joe Townend

Gjashtëdhjetë vjet më parë, në Paris, 3000 njerëz mbajtën radhë për të parë veprën e fundit nga Yves Klein, artistin e ri më të famshëm prej një ekspozite personale tejet të lavdëruar në Milano. Por nuk e dinin se po prisnin për të shkuar në një dhomë bosh. “Ishte tërësisht gjuhë e re”, tha Danial Moquay, koordinator te Yves Klein Archives, mbi ekspozitën e Klein-it, The Void, te Iris Clert Gallery. “Vepra e tij i habiti njerëzit, por aty zbuluan një eksperiencë krejt ndryshe”.

Karriera tejet ndikuese e Klein-it zgjati vetëm shtatë vjet, para se të vdiste në moshën tridhjetekatër-vjeçare në 1962. Kujtohet mbi të gjitha prej një ngjyre të vetme, një ultramarine të pasur të cilën e patentoi me emrin e tij: International

Klein Blue (IKB). E përdori këtë ngjyrë në pjesën më të madhe të veprave të tij, nga performancat dhe instalacionet të skulpturat e pikturat, duke përfshirë seritë kontraversiale Anthropometry nga fillimi i viteve '60, ku gra të zhveshura lye veten me bojën IKB, dhe stampuan trupin e tyre mbi kanavaca gjigante. Por ndikimi i tij shkon shumë përtej një ngjyre të vetme.

Filloi të pikturonte që adoleshent, por shumë herët kuptoi se ishte po aq i interesuar në idetë dhe eksperiencat sa ishte në vetë veprën e artit. “Është një rrëfim shumë i bukur mbi atë si e bëri ‘veprën’ e tij të parë të artit”, tha Kerry Brougher, drejtorja e Academy Museum of Motion Pictures në Los Angeles, e cila ishte bashkë-kuratore në

një retrospektivë të madhe të Klein-it në Hirshborn Museum në Washington DC në 2010. “Në moshën nëntëmbëdhjetë vjeçare, ishte shtrirë në një plazh në Nice dhe e imagjinoi veten duke u ngritur lart drejt qiellit blu, duke u kthyer në anën tjetër e duke kënduar si një artist. Që prej fillimit, edhe para se ta quante veten artist, ai po e përdorte tokën dhe qiellin si materialet e tij.”

Për një artist kaq të mahnitur nga mundësitë konceptuale të artit, Klein nuk i injoroi kurrë aspektet shpirtërore të veprave të tij. “Klein e përdorte ngjyrën si një instrument i zbulimit dhe një portë drejt shpirtit”, thotë Klaus Ottmann, drejtor i Phillips Collection në Washington DC. “Shikuesit e tij marrin pjesë

në veprë duke u përfshirë në një boshllëk ngjyre të pastër”. Bluja pati një rezonancë të veçantë për Klein-in, si katolik i devotshëm. “Që në kohët e lashta, ngjyra blu është lidhur me mençurinë, filozofinë morale dhe të vërtetën”.

Ai përdorte koncepte të thjeshta për të krijuar takime unike për shikuesin, një proces që pati ndikim të thellë në artin bashkëkohor. “Klein i hapi rrugën praktikave të reja konceptuale, performative dhe përfshirëse, të cilat vijnë të formojnë e përcaktojnë eksperiencat e sotshme të artit”, thotë Ottmann. “Ai e shkëputi veten nga traditat që ekzistonin. Vizioni i tij ishte një e ardhme me liri absolute artistike e shoqërore.”


Përktheu Enxhi Hudhri

Performanca e Yves Klein-it *Anthropometries* e periudhës blu, 1960, Galerie Internationale d'art contemporain, Paris, FrancëYves Klein dhe *le Globe terrestre bleu* (RP 7), 1961

XHEVAIR LLESHI

endem nëpër re me tim bir

Përsiatje – si një roman



Onufri